Komisioni Europian

Këshilli i Qarkut
Lezhë

Këshilli i Qarkut
Shkodër







# Plani Rajonal i Veprimit në Mjedis

## *Delta e lumit Drin, Shkodër - Lezhë*

QENDRA RAJONALE E MJEDISIT
Shqipëri

JACOBS

LOUIS BERGER S.A.

Komisioni Europian

Këshilli i Qarkut
Lezhë

Këshilli i Qarkut
Shkodër

# Plani Rajonal i Veprimit në Mjedis

*Delta e lumit Drin, Shkodër - Lezhë*

QENDRA RAJONALE E MJEDISIT
Shqipëri

JACOBS

LOUIS BERGER S.A.

**Përgatitur në kuadër të projektit CARDS "Legjislacioni dhe Planifikimi Mjedisor në Shqipëri - ELPA" Financuar nga Komisioni i Delegacionit European, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave. Zbatuar nga Jacobs, Louis Berger S.A dhe Qendra Rajonale e Mjedisit (REC), Shqipëri**

**Ky dokument është përgatitur me ndihmesën e:**

QENDRA RAJONALE E MJEDISIT
Shqipëri

http://albania.rec.org

Në bashkëpunim të ngushtë me:
Këshillin e Qarkut të Lezhës dhe Këshillin e Qarkut të Shkodrës, Bashkitë dhe Komunat e zonës në projekt, Drejtoritë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Kujdesit ndaj Konsumatorit të Lezhës dhe Shkodrës, Agjencitë Rajonale të Mjedisit të Lezhës dhe Shkodrës, Drejtoritë e Baseneve ujore të Shkodrës dhe Matit, Inspektoriatin e Peshkimit në Shkodër, Drejtorinë e Gjeologjisë në Shkodër, Univesitetin e Shkodrës, projektin "Plani Rajonal për Shkodër-Lezhë", stafin e projektit ELPA;

dhe me kontributin e:

Linda Maçi, Alken Myftiu, Bardhok Ndreca, Daniela Tola, Djana Bejko, Edlira Tukaj, Eduart Cani, Ilir Zaja, Jak Gjini, Jashar Cejku, Jonathan Wager, Llesh Hila, Lynda Thorn, Merita Kazazi, Mihallaq Qirjo, Myzafer Kraja, Ndrece Gjini, Osman Deltina, Stakë Vukaj, Zef Gjoni, Sajmir Beqiraj.

**Viti i botimit 2006**
**Shtypur pranë shtypshkronjës**
**Gent Grafik, Tiranë**

# Përshëndetje

**Bardh RICA**
*Kryetar*
*Këshilli i Qarkut Lezhë*

Qarku i Lezhës për vetë prozicionin gjeografik ka qenë që në lashtësi dhe mbetet një nga rajonet me rëndësi të madhe strategjike dhe natyrore. I vendosur në mes mrekullive tokësore dhe ujore, ai përshkohet nga lumenj dhe përrenj, ujëmbledhës, kodra dhe male dhe një larmi e madhe biologjike. Lezha njihet për tradita të veçanta njerëzore të punës me dorë dhe përdorimit të burimeve natyrore.

Që me zhvillimet e reja pas viteve 90, Lezha si dhe të gjithë rajonet e tjera të Shqipërisë u përfshi në lëvizje të mëdha demografike, të nxitura nga nevoja për zhvillim dhe përmirësimin e kushteve të jetesës. Zona më e ndikuar nga ky vrull lëvizjesh, ishte ajo bregdetare, ku hapësira të tëra bujqësore u kthyen në zona të banuara.

Të gjitha këto ndryshime, të cilat nuk mund të përballoheshin nga një qeverisje vendore e re akoma në zhvillim e sipër, sollën për pasojë ndikime negative në të gjithë sekorët e jetës. Pasuritë natyrore të zonës, pësuan dëme të mëdha dhe për pasojë filluan të tjetërsoheshin. Humbja dhe keqpërdorimi i tokës bujqësore u kthye ne një problem shume madhor për rajonin. Dëmtimi i sistemit kullues, solli për pasojë një nga fenomenet, tashmë vjetore në zonën perëndimore të rajonit, që është ai përmbytjeve.

Nxitur nga nevoja për zhvillim dhe për t'iu përgjigjur nevojës së madhe për shërbime, Këshilli i Qarkut të Lezhës, si një institucion i nivelit të parë, ka punuar në ngritjen dhe forcimin e strukturave menaxhuese në të gjithë sektorët, duke u bërë promotor i zhvillimeve rajonale në përmirësim e situatës.

Vlerat mjedisore të zonës, të para si mundësi atraksioni dhe zhvillimi, kanë qenë në vëmendjen e këtij institucioni në një sërë nismash zhvillimi me rëndësi kombetare dhe rajonale. Këtë ë dëshmon qartë fluksi gjithnjë e në rritje i projekteve madhore në fushën e menaxhimit urban, menaxhimit të ujrave dhe menaxhimit të natyrës.

Angazhimi në hartimin e Planit Rajonal të Veprimit në Mjedis, vjen natyrshëm në vazhdën e angazhimeve dhe politikave të qarta të këtij institucioni në zhvillimin e qëndrueshëm të zonës dhe rritjene vlerave turistike, bazuar në vlerat natyrore.

Këshilli i Qarkut Lezhë, do vazhdojë punën e tij në gjenerimin e mundësive financiare dhe forcimin e politikave për vënien në zbatim të këtyre nismave që ë bëjnë këtë rajon model në të gjithë vendin.

**Lorenc LUKA**
*Kryetar*
*Këshilli i Qarkut Shkodër*

Qarku Shkodër pozicionohet ne veriperëndim te Shqipërisë dhe përfshin rrethet Shkodër, Malësi e Madhe dhe Pukë. Ai dallohet për burime te shumta natyrore e njerëzore. Ai është një rajon kufitar, shtrihet përgjatë brigjeve te liqenit te Shkodrës, ka dalje ne det, ka burime te shumta ujore dhe ne malësinë e tij ka me shume pyje se ne çdo rajon tjetër te vendit.

Këto avantazhe kane kushtëzuar zhvillimin e hershem te kësaj treve dhe historikisht janë shfrytëzuar me zgjuarsi për ta kthyer atë ne një qendër te përparuar ekonomiko-shoqërore te spikatur ne te githë rajonin.

Si e gjithë Shqipëria, Qarku i Shkodrës është përfshire, mbas viteve 90` në një proces të shpejtë transformimi që mbart ne vetvete pasoja pozitive e negative.

Ne kuadër te përballimit te sfidave te integrimit ne rajon, por dhe me gjere, Këshilli i Qarkut Shkodër punon vazhdimisht për zhvillimin e qëndrueshëm.

Kjo presupozon nxitjen e iniciativave, përkrahjen dhe mbështetjen e projekteve dhe investimeve ambicioze me vizionin strategjik te zhvillimit te qëndrueshëm te burimeve natyrore, i përcaktuar nga konventat ndërkombëtare dhe mbështetur ne parimet e qendrueshmerise mjedisore.

Përfshirja e Institucionit tone ne hartimin e disa dokumenteve te rëndësishme për zhvillimin e Rajonit, bashkëpunimi konkret me projektet dhe ndërhyrjet e ndryshme për zhvillim ekonomik-social,etj, është tregues i qarte për rolin qe ai kryen si nxitës dhe koordinues, gjithnjë ne përputhje me ritmet e zhvillimit dhe mundësitë ligjore qe ekzistojnë ne kushtet e një decentralizimi ne proces e sipër.

Kështu mbështetja nga Këshilli i Qarkut Shkodër, për hartimin e Planit Rajonal te Veprimit ne Mjedis për Deltën e Lumit Drin (Shkodër dhe Lezhe) është produkt i filozofisë se punës qe ka institucioni ynë ne kuadër te koordinimit te projekteve për zhvillimin e Rajonit tone.

Vlerësojmë bërjen e këtij plani si te rendesishem duke i dhëne prioritet zonës se marre ne konsiderate, mbasi është një zonë me tendenca të zhvillimit të turizmit. Zhvillimi i vrullshëm aktual, pa një plan te tille "mbrojtës për natyrën" do te sillte një shkatërrim te këtyre burimeve natyrore turistike dhe jetësore.

Nga ana jone nuk do te mungoje angazhimi dhe bashkëpunimi për gjetjen e mundësive njerëzore dhe financiare për bërjen te mundur te zbatimit konkret te një plani te tille aq me tepër qe ai është pjese integrale e Planit te Zhvillimit te Rajonit Shkodër – Lezhe te aprovuar pak kohe me pare.

# Lista e shkurtimeve

AFADA ------------------------- Shoqata Shqiptare e Agrobiznesit dhe Plehrave bujqësore
ARM ------------------------------------------------------------------ Agjencia Rajonale e Mjedisit
BB ----------------------------------------------------------------------------------- Banka Botërore
BOD ------------------------------------------------------------ Kërkesa Biologjike për Oksigjen
BRBU ------------------------------------------- Drejtoria Rajonale e Bujqësisë dhe Ushqimit
Cd ------------------------------------------------------------------------------------------- Cadmimum
COD ------------------------------------------------------------------ Kërkesa Kimike për Oksigjen
ELPA ----------------------------------------- Projekti Planfikimi dhe Legjislacioni në Shqipëri
EPTISA -------------------------------------------------------------------- Organizatë Konsulence
FAO ---------------------------------------------------------------- Organizata Botëtore e Ushqimit
GTZ --------------------------------------------------------------------- Agjencia Gjermane për Zhvillim
KUZ ---------------------------------------------------------------------- Kanalizimet e Ujrave të Zeza
MMPAU --------------------------- Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave
MW/h ---------------------------------------------------------------------------------- Megavat për orë
N ------------------------------------------------------------------------------------------------ Natrium
OJF ---------------------------------------------------------------------- Organizatë Jofitimpruprëse
OXFAM ---------------------------------- Organizata Ndërkombëtare për Zbutjen e Varfërisë
P -------------------------------------------------------------------------------------------------- Fosfor
PAH ------------------------------------------------------------------- Hidrokarbure Ciklike Aromatike
Pb ------------------------------------------------------------------------------------------------- Plumb
PMU ------------------------------------------------------------------------ Njësi Menaxhimi Projektesh
PRVM --------------------------------------------------------------- Plani Rajonal i Veprimit në Mjedis
REC ------------------------------------------------------------------------ Qendra Rajonale e Mjedisit
SHPU -------------------------------------------------------------- Shoqata e Përdoruesve të Ujit

# Përmbajtja


| | |
|---|---|
| **Përshëndetje** | **5** |
| **II. Paraqitje e përgjitshme** | **9** |
| **III. Hyrje** | **10** |
| **IV. Procesi dhe metodologjia** | **11** |
| | |
| **V. Vlerësimi i gjendjes** | **13** |
| V.1. Gjeografia, gjeologjia dhe energjia | |
| V.2 Hidrologjia e rajonit | |
| V.3. Bujqësia dhe peshkimi | |
| V.4. Biodiversiteti | |
| V.5. Dinamika njerëzore dhe përdorimi i territorit | |
| V.6. Turizmi | |
| | |
| **VI. Rekomandime** | **59** |
| VI. 1. Gjeografia, gjeologjia dhe energjia | |
| VI.2 Hidrologjia e rajonit | |
| VI.3. Bujqësia dhe peshkimi | |
| VI.4. Biodiversiteti | |
| VI.5. Dinamika njerëzore dhe përdorimi i territorit | |
| VI.6. Turizmi | |
| | |
| **VII. Plani i Veprimeve** | **69** |
| VII.1. Gjeografia, gjeologjia dhe energjia | |
| VII.2 Hidrologjia e rajonit | |
| VII.3. Bujqësia dhe peshkimi | |
| VII.4. Biodiversiteti | |
| VII.5. Dinamika njerëzore dhe përdorimi i territorit | |
| VII.6. Turizmi | |
| | |
| **Ndikimi ndërmjet baseneve** | **79** |
| 1. Analizë e përgjithshme e gjendjes | |
| 2. Baseni i Fushë Kuqes dhe Patokut | |
| 3. Vlerat natyrore dhe larmia biologjike | |
| 4. Rekomandime | |
| **Harta** | **89** |

## II. Paraqitje e përgjithshme

Ky dokument është përgatitur ne kuadër të projekti CARDS "Legjislacioni dhe Planifikimi Mjedisor në Shqipëri (komponenti i planfikimit mjedisor)". Qëllimi kryesor i ELPA është të mbështesë objektivat e Qeverisë shqiptare në përmbushjen e principeve të zhvillimit të qëndrueshëm në përputhje me bisedimet për futjen në BE. Kjo përfshin forcimin e kapaciteteve teknike dhe administrative të qeverisjes vendore dhe ngritjen e kapaciteteve në proceset e hartimit të Planeve Mjedisore në nivel rajonal dhe vendor.

REAP është i lidhur ngushtësisht me komponentët e tjerë te projektit ELPA:

- Strategjia Kombetare e Mjedisit përcakton politikat për të gjithë sektorët e zhvillimit duke përfshirë menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve mjedisore të përdorura për zhvillim si dhe mbrojtjen e larmisë biologjike.
- Ngritjen e ndërgjegjes mjedisore në nivelet rajonale dhe vendore. Procesi i konsultimeve publike të ndërmarra në kuadër të REAP është në një linjë me legjislacionin e BE për planet e zhvillimit.

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis është në linjë me përpjekjet e qeverisë shqiptare për forcimin e mëtejshëm të proceseve të planifikimit mjedisor në të gjitha nivelet ashtu si kërkohet dhe nga Procesi i Asocim-Stabilizimit dhe Brenda projektit ELPA, si një ndihmesë në hartimin e Strategjisë Kombëtare të Mjedisit.

Qëllimi i këtij dokumenti është të adresojë the zhvillimin e paplanifikuar të qyteteve, zhvillimin e shpejtë të nismës private e shoqëruar me ndërhyrje të pakontrolluara në infrastrukturën ekzistuese, e cila ka ndikuar negativisht në natyrë dhe në shëndetin e popullatës. Në shtesë të kësaj, krijimi i qendrave të reja të banuara, ka rritur presionin mbi infrastrukturën e pazhvilluar të zonës. Zbritja e popullsisë nga zonat malore ka gjendur të paërgatitur autoritetet vendore dhe ka cuar në zhvillime kaotike në të gjithë zonën, si dhe rritje të problemeve të turizmit në zonën bregdetare.

Duke marrë në konsideratë mungesën e sistemeve të kontrollit dhe ndërgjegjësimin e ulët të fushës së biznesit, insitucioneve dhe komunitetit për cështjet e mjedisit, projekti ka punuar në përfshirjen e mjedisit në axhendën e përditëshme të autoriteteve vendore dhe ka forcuar mënyrat dhe metodat e komunikimit me publikun në dobi të pjesmarrjes dhe vendimmarrjes për cështjet mjedisore

Grumbullimi i të dhënave të disiplinave të ndryshme në rajonin Shkodër - Lezhë, duke filluar nga veçoritë fiziko - gjeografike, trualli (gjeologjia), pasuritë natyrore dhe nëntokësore, uji, bujqësia, biodiversiteti, pyjet, peshkimi, hidro - gjeologjia të dhëna demografike, përdorimi i terreneve, energjia, mbetjet urbane, edukimi etj., pasi kaluan në disa stade diskutimi dhe përmirësimi, janë konceptuar në një dokument të integruar me një fokus të qartë të mbrojtjes së natyrës.

Dokumenti sjell një analizë të të dhënave të 50 viteve të fundit në disiplina të ndryshme sipas kushteve të ndryshme të relievit të kësaj zone (rrafshina detare, liqenore, ultësira pranë - adriatike, lugina e kanione të ndryshme, laguna, etj). Plani Rajonal Mjedisor i zonës që mbulon rrjedhën e poshtme të Drinit me një vijë bregdetare 34 km me liqenin e Shkodrës me sipërfaqe 360 km2, me arterie të shumta të lumenjve, ishte një ndërmarrje e vështirë, por me interes të madh. I zbërthyer në kapitujt bazë të analizës së gjendjes, rekomandimeve dhe planit të veprimeve, ai sjell një vizion të ri zhvillimit ndërdisplinor në Shqipëri, fushat e ndryshme me ndikim të ndërsjelltë, janë sjellë në mënyrë të harmonizuar dhe në respekt të natyrës dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Dokumenti pritet ti shërbejë autoriteteve qendrore dhe vendore, biznesit, organizatave të ndryshme, specialistëve dhe grupeve të tjera të interesuara, për të zhvilluar më tej vizionet e tij për një zhvillim me bazë përdorimin e pasurive natyrore në mënyrë të qëndrueshme në rajonin e Lezhës dhe Shkodrës.

# III. Hyrje

## III. 1 Zona e marrë në studim

Plani adreson problemet në basenin e lumit Drin që nga Hidrocentrali i Vaut të Dejës dhe në vazhdim me të dy degët e tij përgjatë Shkodrës dhe Lezhës. Në të përfshihen dy njësi të mëdha administrative, Qarku Shkodrës dhe ai i Lezhës.

Kufiri verior është dega e sipërme e Drinit duke përfshirë dhe liqenin e Shkodrës dhe lumin e Kirit; kufiri jugor - është lumi i Matit në Lezhë; kufiri perëndimor - deti Adriatik; kufiri lindor - është pjesa ujëmbledhesë e Drinit.

Zgjatja në lindje ka patur si qëllim përfshirjen në studim edhe të pellgut të lumit Gjadër, problematik në vitet e fundit, si tërësi ujore të ujrave të lumenjve Drin, Kir. Bunë, liqeni i Shkodrës.




*Hartë nr.1: Paraqitje e kufinjve (të konsideruar si zonë bufer) të zonës të marrë në studim*

## IV. Procesi dhe metodologjia

Plani Rajonal i Veprimit në Mjedis për basenin e Drinit (Shkodër – Lezhë), është hartuar nga specialistë vendorë të dy Qarqeve: Shkodër dhe Lezhë, ekspertëve kombetarë nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave, si dhe me ndihmën e ekspertëve të Qendrës Rajonale të Mjedisit (REC) dhe atyre ndërkombëtarë nga projekti ELPA.

Dokumenti trajton 6 fusha madhore, të cilat janë Gjeologjia dhe Energjia, Hidrologjia, Bujqësia dhe Peshkimi, Biodiversiteti dhe Zonat e Mbrojtura, Zhvillimi i Territorit dhe Dinamika Njerëzore, si dhe Turizmi.

I zhvilluar në tre pjesë kryesore, PRVM është konceptuar në kapitujt kryesorë: Analiza e situatës, Rekomandime dhe strategjia për zhvillim, dhe Plani i Veprimit. Duke u kujdesur në mënyrë të vecantë në ndërveprimet ndërmjet cështjeve të ndryshme, për secilën cështje paraqitet problematika, rekomandimet dhe ndërhyrjet konkrete. Kështu, dokumenti trajtohet në një rrjedhjë logjike, ku së pari përcaktohet dhe analizohet problemi, dhe më pas jepen rrugët e mundëshme të zgjidhjes.

Një nga hallkat më të rëndësishme të procesit ka qenë diskutimi i gjetjeve dhe përfundimeve të dokumentit me një numër të konsiderueshëm specialistësh vendorë dhe përfaqësues të komunitetit në të dy rajonet. Me qëllimin e përgatitjes së një dokumenti gjithëpërfshirës, janë ndërmarrë një sërë veprimtarish për konsultimin publik, nëpërmjet takimeve publike, tavolinave të diskutimit dhe thirrjes për bashkëpunim.

Ekipi i projektit ELPA dhe REC Shqipëri dëshirojnë të falenderojnë aktorët lokalë dhe rajonalë të përfshirë në këtë proces për mbështetjen dhe angazhimin e tyre në hartimin e PRVM, si modeli dhe prototipi i parë në Shqipëri.

# V. Vlerësimi i gjendjes



# V. 1. Gjeografia, gjeologjia dhe energjia

## V.1.1. Analiza e përgjithshme e situatës

Zona e Shkodrës dhe Lezhës karakterizohet në ato me sizmicitet të lartë. Lëvizjet e tokës janë të përqendruara kryesisht në segmentin Merqija – Kallmet, ku dhe rrezikshmëria është më e lartë dhe vjen si pasojë e lëvizjeve aktive të kores sipërfaqësore në aksin Merqije - Kallmet.

Urbanizimi me shpejtësi ka sjellë dëmtim të regjimit të ujërave nëntokësore, të cilat mund të paraqesin rrezik për të ardhmen si rezultat i ndotjes së tyre.

Ndërtime të ndryshme janë bërë në zonat të cilat paraqesin rrezikshmëri të lartë erozioni. Këto lloj ndërtimesh paraqesin rrezikshmëri të lartë si për vetë ndërtimin ashtu dhe për ato që do të vendosen pranë tyre gjatë procesit të mëtejshëm të urbanizimit.

Një ndikim negativ në koren e tokës pritet të ketë, në ardhmen (bazuar në ritmet e tanishme), ndryshimi i temperaturës, i cili nga shekulli i kaluar deri më tani ka pësuar një rritje prej 0.5 $^0$C. Për momentin nuk paraqet rrezikshmëri të lartë, por duhet marrë në konsideratë duke qenë se kemi të bëjmë me zonë të ndjeshme nga të gjitha drejtimet.

Parë nga ky vështrim, kërkohet një menaxhim ndryshe i hapësirës ujore, tokësore, infrastrukturës, duke analizuar gjithë burimet natyrore të zonës, që merret për studim (investim), duke shfrytëzuar të dhënat e institucioneve që veprojnë në ato vende ku pritet të investohet (efektet e tyre), duke siguruar përfshirjen e të gjithë fushave të ekspertizës (gjeologjisë, gjeografisë, agronomi pyjesh, infrastrukturës inxhinierike, mjedisit, turizmit, arkitekturës, etj). Kjo do të bënte që ky rajon të marrë zhvillimin e duhur dhe të shpejtë .

*V.1.1.1 Energjia*

Gjendja energjetike e vendit, si dhe e rretheve të Shkodrës dhe Lezhës, është e përkeqësuar. Kjo për pasojë se në këto 15 vitet e fundit, nuk është shtuar asnjë burim i ri energjetik dhe kërkesat e konsumatorëve kanë ardhur në rritje, janë rritur humbjet në rrjet dhe ato të shpërfillura.

Burimet hidroenergjetike

Potenciali hidroenergjetik i mundshëm, për dy rrethet Shkodër dhe Malësi e Madhe, vlerësohet në rreth 5 milionë MWh/vit. Nga këto, 3 milionë MWh/vit, prodhohen në hidrocentralin e Komanit dhe Vaut të Dejës.

Përveç këtyre dy hidrocentraleve, në rrethet Shkodër dhe Malësi e Madhe, prodhohen 25.000 MWh në vit nga hidrocentralet e Selcës, Vermoshit, Vuklit, Benës, Ndërlysës, Moslit). Nisur nga potenciali hidrik i llogaritur, mbeten edhe dy milionë MWh për t'u shfrytëzuar. Në zonën e projektit, burimet hidroenergjetike kryesore janë të përqendruar kryesisht në pellgjet ujëmbledhëse të lumenjve Kir, Gjadër, Drin dhe Bunë.

Energjia e erërave

Me shumë sukses, mund të përdoret energjia e erës. Këtë e favorizojnë kushtet e relievit me kodra të buta, afër zonave me popullim të madh si: Suka e Mjedës, kodrat e Plezhës, kodrat e Paçramit, kodrat e Mabes, kodrat e Dajçit, kurrizorja e Pentarit etj., dhe ekzistenca e erërave lokale të bollshme, deri në 120 ditë në vit.

Vënia në punë e disa turbinave me erë në rajonin Shkodër – Lezhë, do të lehtësonte shumë sistemin energjetik dhe shlyerja do të ishte shumë e shpejtë. Një turbinë me erë, kushton 1 milion dollarë dhe mban rreth 35.000 banorë. Me një llogaritje të thjeshtë ajo do ta shlyente veten për 2 - 3 vjet.

Energjia diellore

Duke qenë se rajoni Shkodër – Lezhë (bën pjesë në klimë mesdhetare) dhe kemi rreth 226 ditë diell në vit, mund të themi se energjia diellore (nëpërmjet paneleve diellore), ka një potencial të lartë shfrytëzimi.

Aktualisht, për sigurimin e energjisë për gatim e ngrohje, makineri e pajisje, 60 % e popullsisë së zonës përdor gazin natyror, 30% përdor lëndë drusore, 10% energjinë elektrike, ndërsa sigurimi i energjisë nga panelet diellore ndodh vetëm në raste shumë të rralla.

*V.1.1.2 Dinamika e brigjeve detare dhe erozioni*

Këto dukuri janë të zakonshme për gjithë vendet mesdhetare. Në rajonin e Shkodër- Lezhës kemi erozion detar, erozion lumor në rrjedhën e mesme dhe të sipërme të lumenjve, erozion sipërfaqësor të përrenjve, brigjeve etj.

Erozioni detar

Kjo dukuri është më aktive përgjatë bregut detar të lagunave Kune dhe Vain si dhe në derdhjen e lumit Buna. Përgjatë bregdetit të përfshirë në zonën e Lezhës, avancimi i detit llogaritet mesatarisht deri në 2,5 m në vit. Që nga viti 1936, bregu i detit ka përparuar me 400 m në drejtim të tokës, ndërkohë që në zonën e Bunës deti ka përparuar 500 m në brendësi të tokës. Sipas disa vrojtimeve të specialistëve, një ndër shkaqet kryesore për përparimin e bregdetit në zonën e Lezhës është bllokimi i aluvioneve që vinin nga lumi Drin, që llogariten 13 herë më pak krahasuar me ato të vitit 1854, kur lumi u nda në dy degë (njëra u bashkua me Lumin Buna, 1,5 km poshtë Liqenit të Shkodrës dhe dega tjetër që vinte poshtë në Lezhë tashmë është kthyer në kanal). Një ndikim të madh në këtë fenomen kanë luajtur dhe veprat e mëdha hidroteknike mbi lumin Drin, të ndërtuara pas vitit 1963.

Gjithashtu, fenomeni është nën vëzhgim, sepse mund të bëhet fjalë dhe për ndryshime dhe lëvizje të mëdha të brigjeve të deteve në të gjithë Mesdheun dhe më gjerë. Kjo do të shërbejë për të kuptuar më mirë tendencën afatgjatë të këtij procesi. Për momentin, nuk ka masa konkrete për mbrojtje, madje, po dëmtohet një nga mbrojtësit natyror të bregut, pylli me pisha, sidomos përgjatë bregut të Lezhës.

Erozioni i tokës

Nga përllogaritjet e bëra është arritur në përfundimin se rreth 30 ton/ha/vit me një thellësi prej 2 cm është erozioni sipërfaqësor i tokës në zonë, e barabartë kjo me vlerën mesatare në shkallë vendi.

Degradimi i tokës së punueshme për shkak të erozionit dhe përmbytjeve vazhdon të jetë një nga problemet më të mëdha në zonën e Zadrimës.

Rënia e vegjetacionit, mospërdorimi i tokës për qëllime bujqësore, metodat e papërshtatshme të ujitjes janë disa nga faktorët, të cilat e përshpejtojnë fenomenin e erozionit në zonë. Zona të veçanta përdoren për kullotje, në kundërshtim me çdo lloj kriteri, duke stimuluar mbipërdorimin e bimësisë dhe për pasojë rritjen e erozionit dhe dëmtimin e pejsazhit.

Shumë problematike paraqitet gjendja përgjatë lumenjve Drin, Buna dhe Kir. Vetë lumenjtë dhe aktiviteti njerëzor (nxjerrja e zhavorreve, dëmtimi i pritave malore, etj) kanë shkaktuar probleme shumë të rënda përgjatë brigjeve të lumenjve.

### V.1.2 Analiza e faktorëve kyç të çështjes

Rreziku gjeologjik dhe pasojat mjedisore në rajon

Rreziku gjeologjik lidhet me dukuritë fiziko- gjeografike që zhvillohen në rajon. Vlerësimi i rrezikut gjeologjik ka rëndësi të veçantë në studimet gjeo – inxhinierike, në evidentimin e proceseve gjeodinamike që zhvillohen në rajon, për të zvogëluar në minimum efektin negativ të tij në qëndrueshmërinë e objekteve të ndryshme inxhinierike.

Neoteknika e rajonit

Neotektonika në përgjithësi, për albanitet është pranuar Pliokuaternari (që i korrespondon ngritjes së gjithë Shqipërisë, (sipas Sh. Aliaj)

Në fillim të pliocenit (periudhës neotektonike), u krijuan strukturat horst - graben në kuadër të të cilave u formuan një sërë pellgjesh liqenore, midis të cilëve edhe pellgu i Zadrimës. Rajoni fushor përfshihet në ultësirën e nën Shkodrës (ultësira perëndimore e kapur fuqimisht nga zhytja në pliokuaternar dhe e deformuar nga rrudha, lartë- rrëshqitje, kundërhedhje të mbulesës së zonës së Krastë – Cukalit.

Grabeni i fushës së Zadrimës është formuar në kuaternar dhe ka një fundosje të vogël, që tregohet nga trashësia e vogël e depozitimeve të kuaternarit (50 - 60 ml), mungesa e tarracave lumore.

Sizmiciteti i rajonit

Rajoni nga studimet bën pjesë nga zonat me intensitet 7 – 8 ballë.

Sizmiciteti i rajonit lidhet me zonën sizmogjene me potencial të dobët të Shkodër - Mat – Mokër, që ndërpritet në veri me vijën sizmogjene tërthore Shkodër – Pejë. Zona shkëputëse Shkodër - Mat - Mokër, shtrihet VP – JL dhe pret diagonalisht strukturat (ultësirën e nën Shkodrës, grabenin e Zadrimës)

Ky faktor, duhet të merret parasysh në studimet e truallit (në antisizmikë).

Në trojet e forta, ndikimet sizmike janë të vogla, ndërsa në trojet e buta kemi lëngëzim të trojeve, për pasojë edhe çedime të ndërtesave. Reagimi i trojeve ndaj valëve sizmike ndahet në 3 kategori: 1) Formacione të shkëmbinjve magmatikë dhe sedimentarë kompakt dhe të çimentuar të paprekur nga tektonika; 2) Shkëmbinj të fortë me çarshmëri të zhvilluar dhe të tjetërsuar dhe shkëmbinj të ngjeshur me ujëmbajtje të lartë; 3) Shkëmbinjtë e shkrifët (rërat me nivel të ujërave afër sipërfaqes së tokës.

Karsti

Kjo dukuri, zhvillohet në gëlqerorët nga triasiku deri në paleogjen. Në zonën në fjalë kemi karst sipërfaqësor dhe nëntokësor.

Format më tipike janë: brazdat, vrimat, shpellat, hinkat, kanalet karstike.

Ky fenomen, duhet marrë parasysh në sigurimin e ujit të pijshëm nga gëlqerorët karstike ujëmbajtës nëntokësorë.

Qëndrueshmëria e shpateve

Si rezultat i proceseve të vazhdueshme tektonike e denuduese, prishet gjendja e sforcimeve të masiveve shkëmbore, shkëputen masa shkëmbore, kemi rrëzime për efekt të forcës se gravitetit.

Relievi ka copëtim horizontal, kjo e lidhur edhe me përhapjen e flishit, por ndikim kanë edhe kushtet meteorologjike, erërat, mbulesa bimore, ndryshimet e gjendjes së sforcimeve të shkëmbinjve, lodhja e shkëmbinjve, që janë më të theksuara në kalanë e Lezhës, Gurrat e Begut.

Rrëshqitjet

Rrëshqitjet i kemi të theksuara në ballin e mbihypjes, të shoqëruara me planin rrëshqitës me rrëshqitje aktive Merqi – Kallmet.

Rrjedhjet

Këto janë fenomene të përhershme në rajon, por duhen parandaluar me pyllëzime e vepra gjeo - inxhinierike.

Krahas këtyre që përshkruam më lart, duhen patur parasysh edhe rreziqe të tjera në mjedis si: rreziku i daljes së ujit nga gërmimet, rreziku i ortekëve, rreziku i futjes së ujit të kripur nga deti, përmbytjet e mundshme, rreziku nga ujërat e ndotura, rreziku nga dekompozimi i mbetjeve urbane, rreziku i ndërtimeve jo të studiuara mirë, rreziku i radonit në afërsi të Liqenit të Shkodrës, Koplik, rreziku i dampave të minierave, apo fabrikave për burimet e ujit të pijshëm, etj.

## V.1.3. Tendenca e faktorëve kryesorë.

Rreziku natyror është në përkeqësim (erozioni, rrëshqitjet e shpateve, etj), duke u paraqitur si shumë problematike për natyrën dhe popullatën në zonë.

### V.1.4. Lista e problemeve

| Problemi | Shkaqet | Ndikimi | Popullsia që preket | Shkalla e ndikimit | Prioritarizmi |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. Lëvizje e pakontrolluar e popullsisë, e cila për pasojë ka sjellë dëme të rënda në strukturën gjeologjike të zonës. | - Varfëria e thellë në zonat malore<br>- Mungesa e planeve rregulluese<br>- Mungesë kapacitetesh të pushtetit vendor për përballimin e situatës | - Dëmtim i natyrës dhe pejsazhit<br>- Ndërtime të paqendrueshme dhe në rrezik nga lëvizjet tektonike<br>- Shkallë e lartë ndotje e tokës dhe ujrave | E gjithë zona në studim | E lartë. | * * *<br><br>Shume i rëndësishëm (kërkon zgjidhje të menjëhershme. |
| 2. Shkallë e lartë erozioni detar, tokësor dhe lumor | - Presion i lartë i detit ndaj brigjeve<br>- Dëmtim i brezit mbrojtës përgjatë vijës bregdetare<br>- Shkallë e lartë e lëvizjes së faqeve të maleve dhe ndërhyrje të pastudiuara për gurore dhe rrugë përgjatë tyre<br>- Shkallë e lartë sizmiciteti i zonës<br>- Lumenjtë jashtë kontrollit dhe përmbytje e përvitshme e tokave | - Rrezik i humbjes së bregut të detit-<br>- Rritje e kripshmërisë së tokave<br>- Humbje e tokës bujqësore<br>- Ritja e rrezikut të përmbytjeve nga dëmtimi i shpateve të lumenjve<br>- Ndërtime të rrezikuara nga erozioni | E gjithë zona<br>Më në rrezik zona përgjatë bregdetit | E lartë | * * *<br><br>Shume i rëndësishëm (kërkon zgjidhje të menjëhersh |
| 3. Burimet energjetike në rrezik minimizimi | - Mbushja e vazhdueshme liqenit të Vaut të Dejës nga përrenjtë përreth | - Mbushja e liqenit dhe për pasojë rritja e nivelit të tij deri në derdhje<br>- Rrezikim i digës dhe i vetë veprës hidroenergjetike | E gjithë zona fushore dhe ndikim negativ në ekonominë e vendit | E mesme | * *<br><br>E nevjoshme të merren masa pë studimin e jetëgjatësisë të liqenit |

### V.1.5. Ndërveprimet në çështjet e tjera të marra në shqyrtim.

Të dhënat gjeologjike për truallin kushtëzojnë në një masë të madhe investimet e ndryshme në fushën e turizmit, bujqësisë, pyjeve, zhvillimeve urbane, energjetike, ujë. Këto të dhëna përcaktojnë kushtet gjeo - teknike në ndërtim, zonat me erozion, zonat me rrëshqitje, gjeodiversitetin, gamën e mineraleve, aspektet pedologjike, venddepozitimet e mbetjeve, indikatorët e dëmshëm në ujë e ajër (gazi radon), evoluimet paleo - gjeografike të vijës së bregut të detit, liqeneve, lumenjve, reagimin e shkëmbinjve ndaj valës sizmike (tërmetet), monitorimin mjedisor, etj.

Problematika mjedisore (mbetjet urbane, përmbytjet) ka kthyer vemendjen e institucioneve përgjegjëse drejt bashkëpunimit me institucionet shkencore, që veprojnë në rajonin Shkodër - Lezhë. Akademia e Shkencave ka përgatitur tashmë një studim për përmbytjet në zonën e Lezhës dhe po punon për pjesën e Shkodrës.

Pritet të përfundojnë projekti i studimit të mundshmërisë për menaxhimin e mbetjeve urbane dhe riciklimin e ujërave të zeza të qytetit të Shkodrës dhe zonën e nënShkodrës deri në Lezhë. Ka projekte në zbatim për përmirësim në infrastrukturën Velipojë, në disa zona malore. Gjithashtu po bëhen investime në pritën e Naraçit, për të kontrolluar prurjet e ujit të Gjadrit.

## V.2 Hidrologjia e rajonit

### V.2.1. Analiza e përgjithshme e situatës:

Sistemi hidrografik "Liqeni i Shkodrës - Lumi Drin – Lumi Buna", grumbullon ujërat e një pellgu me sipërfaqe të përgjithshme prej 19.582 $km^2$. Kjo sipërfaqe e këtij pellgu të konsiderueshëm ujëmbledhës, me reliev të lartë dhe të thyer malor e me reshje të bollshme intensive, me një ndërtim të posaçëm litologjik të terrenit, në praninë e formacioneve të përshkueshme gëlqerore bëjnë të mundur që rrjeti hidrografik i këtij pellgu të shquhet për një potencial të lartë dhe mjaft të larmishëm hidrik.

Në këtë rrjet përfshihen: Liqeni i Shkodrës, lumenjtë Drin, Bunë, Kir e Gjadër, pellgu hidrologjik rreth liqenit, nga ku dalin një numër i madh burimesh me ujëra karstikë, ku ndër më të mëdhenjtë përmendim syrin e Sheganit, etj. Veçanti në këtë aspekt përbën delta e lumit Bunë me ishujt e saj karakteristikë aluvionalë.

Të para në aspektin e biodiversitetit e produktivitetit natyror, rrjeti hidrik, e sidomos ai hidrografik i Shkodrës, ka vlera të veçanta e pothuajse unikale. Shkalla e lartë e ujshmërisë dhe regjimi i komplikuar hidraulik është tipar dallues i saj. Vlerësimi i veçorive të përgjithshme natyrore dhe ekologjike të këtij ekosistemi me vlera ndërkombëtare kërkon një vlerësim global të veçorive të përgjithshme natyrore dhe ekologjike të këtij sistemi, trajtimin e dëmtimeve nga veprimtaria e pakontrolluar antropogjene si dhe marrja e masave përkatëse për studimin në kompleks të këtij ekosistemi.

Kështu kompleksi ujor "Liqeni i Shkodrës – Lumi Buna - Lumi Drin" përfaqëson një nga sistemet më të mëdha e më të komplikuara hidrografike të Shqipërisë, si dhe të krejt gadishullit ballkanik. Ndërtimi i posaçëm natyror i pellgut ujëmbledhës bën të mundur që ky kompleks hidrografik të dallohet për një potencial të lartë hidrik. Në këto kushte, Buna, pas bashkimit me Drinin, ka një prurje mesatare vjetore të lartë, rreth 680 $m^3$/sek, duke u renditur kështu ndër lumenjtë me prurje më të madhe e më të rëndësishëm të pellgut hidrografik të detit Mesdhe. Duke parë se prurja mesatare shumëvjeçare e rrjedhës së përgjithshme të lumenjve tanë është rreth 1.245 $m^3$/sek, e ngjashme me lumenjtë e njohur të Evropës, që derdhen në detin Mesdhe, si lumi Ren me prurje 1.350 $m^3$/sek, lumi Po me 1.275 $m^3$/sek, si dhe krahasuar me lumenjtë më të rëndësishëm të Shqipërisë, si Drini me 352 $m^3$/se; Vjosa me 210 $m^3$/sek; Semani me 101 $m^3$/sek; Mati me 74 $m^3$/sek; dhe Shkumbini me 60 $m^3$/sek. Lumi Buna është më i madhi më i rëndësishmi në rrjetin hidrik shqiptar.

Regjimi hidrologjik i kompleksit hidrografik të Shkodrës është i lidhur ngushtë dhe përcaktohet nga ndikimi i kushteve klimatike. Zona dallohet për një klimë tipike subtropikale mesdhetare, që karakterizohet nga verë e thatë dhe zgjatur dhe dimër i ngrohtë e me lagështi. Numri i ditëve me temperaturë të lartë ($T_{max} \geq 25^0C$) ndryshon nga 110 në 130 ditë në vit. Për të gjithë sipërfaqen e pellgut të Liqenit të Shkodrës, shtresa mesatare e reshjeve atmosferike është 2170 mm, duke patur ndryshime të theksuara në shpërndarjen gjeografike, përkatësisht nga 1600 deri 4000 mm. Ky është pellgu me reshje më të mëdha në kontinentin evropian.

Megjithëse lumi Drin (me gjatësi 285 km) dhe përbëhet nga dy degë kryesore, ajo e Drinit të Zi, që buron nga liqeni i Ohrit dhe Drini i Bardhë, që buron nga Bjeshkët e Namuna të Kosovës, në këtë material do të ndalemi vetëm në rrjedhën e poshtme të tij në 34 km e fundit të tij, e pikërisht nga dalja e H/C të Vaut të Dejës, deri në derdhjen e lumit Buna dhe në bashkimin me lumin e Gjadrit e derdhjen e tyre në det.

Rrjedha mesatare shumëvjeçare e Drinit në Bunë është 352 $m^3$/sek, me një vëllim mesatar vjetor prej 11 miliard $m^3$ ujë. Rrjedha mesatare e aluvioneve pezull në lumin Drin ka qenë 438 kg/sek, ndërsa turbullira 1250 gr/$m^3$. Mineralizimi i ujërave të Drinit është i ulët, ai luhatet rreth vlerës 257 mg/l.

Në shtratin e vjetër të Drinit, i cili kalon pranë Lezhës, megjithëse është bërë prita për t'u derdhur në Bunë (që në vitin 1956), përsëri kemi ujë, i ardhur nga ujërat nëntokësore të zhavorreve të fushës së Gjadrit. Kështu çdo rritje e nivelit në shtratin kryesor të Drinit, rrit sasinë e ujit në shtratin e Drinit të Lezhës, duke mbushur këtë të fundit me surëra e suargjila, të cilat, në kohë reshjesh, shkaktojnë daljen nga shtrati të lumit dhe përmbytjen e fushave të Barbullushit dhe Kakarriqit. Kjo përmbytje ndihmohet dhe nga prurjet e shumta të lumit Gjadër, i cili bashkohet me Drinin në afërsi të fshatit Balldre.

Lumi i Drinit të vjetër kalon në afërsi të qytetit të Lezhës, në perëndim të tij dhe derdhet në detin Adriatik në jug të Shëngjinit, duke krijuar laguna piktoreske në zonën e Lezhës: lagunat e Kënellës, Merxhanit, Kunes dhe Vainit, etj. të cilat komunikojnë me detin nëpërmjet kanaleve natyrale dhe artificiale.

Në sistemin hidrografik, liqeni i Shkodrës dhe lumi Buna grumbullojnë ujërat e një pellgu me sipërfaqe

të përgjithshme prej 5221 km$^2$. Liqeni i Shkodrës, me sipërfaqe rreth 365 km$^2$ dhe thellësi mesatare rreth 7 m, luan rolin e një rregullatori natyror të fuqishëm të rrjedhës ujore të lumit Buna, duke qenë një dekantues gjigant i prurjeve të ngurta që rrjedhjet ujore sjellin në liqen. Kjo bën që ujërat e lumit Buna deri në bashkim me Drinin të jenë të pastra, e papastërtitë e vogla lehtësisht të transportueshme. Por gjendja ndryshon rrënjësisht pas bashkimit të lumit Drin me Bunën. Megjithëse prurjet e ngurta të lumit Drin me ndërtimin e H/C të Vaut të Dejës, Komanit dhe Fierzës janë pakësuar në një masë të madhe, përsëri nga bashkimi i Drinit me Gjadrin dhe lumin Kir, këto të fundit mbeten mjaft problematike, pasi këto përgjatë rrjedhës së tyre marrin mjaft mbetje të ngurta me vete, duke i transportuar ato përgjatë shtratit të tyre dhe derdhur në lumin Buna. Këto kanë bërë që lumi Buna të mbushet gradualisht me prurje të ngurta, e të humbasë aftësinë për të qenë i lundrueshëm, pasi shtrati i tij është zvogëluar në thellësi, është zgjeruar akoma më shumë duke rritur përmbytjet, pasi tabani i lumit Buna ka vazhduar të ngrihet. Kjo vjen pasi lumi Buna është lumë tipik fushor. Menjëherë sapo del nga liqeni i Shkodrës në një largësi prej rreth 1,5 km poshtë, Buna bashkohet me ujërat e lumit Drin. Gjatësia e lumit Buna është rreth 44 km, ndërsa rënia vetëm 1,2 m/km. Pikërisht kjo rrënie e vogël ka bërë të mundur që Buna të ketë dredhime të shumta dhe harkime të mëdha. Delta e lumit Buna është e përbërë prej degëzimesh të veçanta, që janë pasojë e pranisë së ishujve siç është ai i Adës, Franc Jozefit, Ishulli pa Emër etj. Nga pikëpamja gjeomorfologjike, delta e lumit Buna është tepër dinamike.

*V.2.1.1 Përmbytjet*

Zonat fushore të Shkodrës dhe Lezhës, prej dekadash kanë qenë të kërcënuara nga problemi i përmbytjeve. Sot, ky mbetet faktori kryesor që është bërë pengesë në zhvillimin e bujqësisë dhe kërcënon seriozisht vlerat e tokës dhe jetën e popullsisë në këtë rajon.

Në zonën e Shkodrës (të marrë në studim), komunat më të ndikuara nga problemi përmbytjeve janë Guri i Zi, me 600 ha të përmbytura, Ana e Malit, me 1200 ha, Dajçi, me 800 ha, Bushati, me 800ha, dhe Velipoja me 1200 ha tokë të përmbytur. Këto zona përmbyten kryesisht gjatë reshjeve të mëdha dhe kur hidrovoret nuk punojnë.

Lumenjtë Kir dhe Gjadër paraqesin një burim të rrezikshëm përmbytjeje për shkak të sedimenteve të mëdha që ata përcjellin me vete. Prita në Malin e Rrëzuar është prishur dhe lumi Gjadër paraqet rrezik serioz për fushën e Zadrimës. Lumi Kir ka dëmtuar shumë argjinaturën e tij dhe, gjatë reshjeve të mëdha, ai paraqet rrezik serioz për fshatrat përreth, por edhe për vetë qytetin e Shkodrës.

Në zonën e Lezhës, kuota kritike e lumit Drin është +2,2 metra. Në këtë kuotë, uji përmbyt komunën Blinisht, fshatin Bacel dhe 200 ha tokë bujqësore. Me rritjen e kuotës, siç ishte rasti i shtatorit 2002, kur kuota shkoi +3,04 metra, u përmbytën mbi 5000 ha toke, pra sipërfaqja e përmbytur është e lidhur me rritjen e kuotës së lumit Drin.

Në zonën e Torovicës, me një sipërfaqe 2200 ha, kuota kritike është +1,7 deri 1,8 metra dhe me këtë kuotë përmbyten 600 ha, me rritjen e kuotave sipërfaqja e përmbytjeve shtohet.

Për kullimin e ujërave në zonën e Lezhës funksionojnë 5 hidrovore

Mbushja e lumit Drin influencon negativisht në kullim dhe prurjet e ngurta, të cilat zvogëlojnë kapacitetin kullues 40 cm në vit.

Kapaciteti përcjellës i lumit Drin sot është 300 m$^3$/sek, nga 500 m$^3$/sek që duhet për kullimin e gjithë sipërfaqes së Lezhës së marrë në studim.

Përmbytjet e ndodhura kanë një sërë shkaqesh:

- Hidrovoret nuk kanë qenë në gatishmëri të plotë për arsye të mungesës së energjisë elektrike për 24 orë;
- Mospastrimi i kanaleve kulluese të para, të dyta e të treta. Për këtë, vazhdon pastrimi i kanaleve të para dhe të dyta me fonde nga buxheti i shtetit;
- Prurje të shumta të lëndëve të ngurta për arsye të prishjeve të pritave malore;
- Ndërtimet e paligjshme në veprat kulluese.

### V.2.2 Analiza e faktorëve më kyç të çështjes

Lumi Drin, në pjesën që është marrë në shqyrtim, e ka ndryshuar shtratin e tij. Nga gryka e Vaut të Dejës, rrjedha e tij, duke marrë drejtimin jugperëndimor dhe duke u bashkuar me ujërat e Gjadrit, gjarpëronte nëpër fushën e Zadrimës, kalonte përbri qytetit të Lezhës dhe derdhej në detin Adriatik, në gjirin e Drinit. Gjatë një plote të jashtëzakonshme në vitin 1846, lumi Drin shkaktoi përmbytje të mëdha dhe u nda në dy degë, duke formuar një shtrat tjetër të ri, që kalonte nga ana e Shkodrës, duke u bashkuar me lumin Buna, i vetmi lumë që del nga liqeni. Kështu, mbas këtij viti (1846), rreth 1,5 km poshtë grykës së Vaut të Dejës, ujërat e lumit Drin rrjedhin në dy drejtime, një pjesë në shtratin e vjetër në drejtim të Lezhës, kurse pjesa tjetër, në shtratin e ri, në drejtim të Shkodrës, duke u bashkuar me lumin Buna, që deri në atë kohë dhe disa dekada më pas ishte lumë i lundrueshëm dhe nëpërmjet tij zhvillohej dhe tregëtia me vendet e tjera të rajonit. Kjo ngjarje e shënuar hidrologjike shkaktoi një kaos të madh hidraulik në Liqenin e Shkodrës dhe në zonën fushore ndërmjet lumenjve Buna dhe Drinit të Lezhës.

Një nga problemet më të mëdha që haset në zonë është dhe ajo e pronësisë mbi tokën. Toka u është dhënë në përdorim fermerëve në kundërshtim me ligjin e baseneve ujore, që ndalon ndërtimin në një zonë rreth 200m përgjatë zonave ujore dhe, në rastet kur kjo bëhet, mund të jepet leje nga autoriteti i ujërave duke marrë në konsideratë shumë faktorë. Kjo pritet të krijojë një problem shumë të madh për sa i përket faktit të kthimit të lumit në gjendjen e mëparshme apo menaxhimit korrekt të brigjeve të tij nga ana mjedisore, ujore dhe njerëzore. Ndërtimi pranë këtyre zonave ka rënë ndesh me ligjet në fuqi, të cilat, në vetvete, kërkojnë reflektime më të qarta dhe mendime, duke parë të gjithë kuadrin në harmoni, pa krijuar konflikte ligjore.

### V.2.3. Tendenca e faktorëve kryesorë.

Për sa i përket situatës hidrologjike, tendenca e faktorëve është në përkeqësim, në qoftë se nuk vihet dorë me investime, sipas studimeve inxhinierike.

### V.2.4. Çfarë po bëhet?

Janë bërë dhe po bëhen mjaft studime për përmirësimin e situatës hidrike në deltën e Drinit si nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar "Mbi ndikimet në mjedis nga zhvillimi i veprimtarisë së shfrytëzimit të rërës dhe zhavorreve në lumin Drin e Bunë", me grup autorësh, studim që është miratuar në Këshillin Kombëtar të Ujit dhe aktualisht punohet mbi bazën e tij.

Nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit[1], Institutit të Studimit të Tokave është hartuar dhe përfunduar në Korrik 2004, Raporti i "Studimit dhe Vlerësimi të Pasojave, Ndikimit Mjedisor, Problemeve Hidrodinamike dhe Rehabilitimi i Gjendjes në Shtretërit e Lumenjve" për pellgun Drin – Bunë (lumenjtë Drin e Bunë) etj.

1 Sot kjo ministri është Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

### V.2.5. Lista e problemeve

| Problemi | Shkaqet | Ndikimi | Popullsia që preket | Shkalla e ndikimit | Prioritarizmi |
|---|---|---|---|---|---|
| Kaos hidraulik në nyjen hidraulike Drin – Bunë – Liqeni i Shkodrës | Përmbytja e vitit 1846, që solli formimin e një shtrati të ri, që kalon nga ana e Shkodrës dhe bashkohet me lumin Buna. | Është prishur rrënjësisht regjimi ujor në Liqenin e Shkodrës. Nga depozitimi i lëndës së ngurtë të Drinit, gradualisht, tabani i shtratit të Bunës filloi të ngrihet. Ujërat e Drinit bllokojnë daljen e ujit nga liqeni nëpërmjet lumit Buna. Ngritja e ujit në liqen krijon përmbytje, përkeqësim të kullimit. | Rrethi i Shkodrës Sipërfaqja 1973 km$^2$. Popullsia: 185.395 banorë. | Shkalla e ndikimit është e mesme. Kjo varet dhe nga intensiteti i reshjeve. Arsyet janë pasi prishet jo vetëm ekuilibri i ujërave në Liqen, por ndikon në prishjen e ndotjen edhe të ujërave nëntokësorë. | * * * Shumë i rëndësishëm |
| Humbja e ekuilibrit ekologjik e natyror nën ndikimin e ndërhyrjeve njerëzore. | Ngjarja hidrologjike shkaktoi më pas e deri në ditët tona një kaos të madh hidraulik në liqenin e Shkodrës e në zonën e lumenjve Drin, Lezhë e Bunë. | Në fushën e nënShkodrës ndodhin përmbytjet nga vërshimet e Drinit të Lezhës dhe Bunës. | Vetë qyteti i Shkodrës; Popullsia 85.798 banorë | | |
| Pamundësia e shfrytëzimit të plotë, të gjithanshëm e racional të pasurisë që ofron kjo tërësi ujore. | Devijimi në vitin 1956 i gjithë lumit të Drinit dhe ndërprerja e rrjedhës së tij të natyrshme. | Lumi i Bunës, i mbushur tashmë me prurjet e ngurta të Drinit, e humbi aftësinë për të qenë i lundrueshëm, sepse thellësia e tij është zvogëluar shumë. | Rrethi i Lezhës Sipërfaqja 479 km$^2$ Popullsia: 67.734 banorë. | | |

## V.3. Bujqësia dhe peshkimi

### V.3.1. Analizë e përgjithshme e situatës

Bujqësia është kontribuesi kryesor i ekonomisë së rajonit në studim. Rreth 60% e popullsisë jeton në zonën rurale dhe kanë bujqësinë si burimin kryesor i të ardhurave të tyre. Toka bujqësore, në të gjithë zonën, është shumë pjellore, me veçori të larta prodhuese. Por, me gjithë rëndësinë që ka në ekonominë e rajonit, sektori i bujqësisë mbetet akoma i pazhvilluar dhe shumë keq i menaxhuar edhe nga vetë fermerët.

Për vetë zonën në të cilën ndodhet, rajoni në studim është shumë i pasur me ujëra nëntokësore dhe sipërfaqësore, çka e bën të domosdoshme mbajtjen mekanike të lagështirës së tokës. Para vitit 1990, sistemet e kullimit dhe ujitjes ishin në efiçiencë të plotë, të organizuara me kanale drenazhimi, ujitje dhe hidrovore. Në ditët tona, sistemi është në një gjendje të mjeruar dhe çfarë është më problematike, gjendja e sistemit të kullimit paraqitet më kritike. Edhe mundësia për të investuar duket e pamundur (para viteve '90 puna për mirëmbajtjen e këtij sistemi bëhej me krahë punë dhe jo me mjete të mekanizuara). Dëmtimi i këtij sistemi ka sjellë probleme të mëdha në prodhimet bujqësore në të gjithë zonën dhe paraqet rrezik për investime të vogla dhe të mëdha.

Tabela më poshtë tregon në shifra pjesën e tokës së përdorur për bujqësi në zonën në studim. Siç del dhe nga tabela, toka bujqësore gjendet në zonat fushore, kodrinore dhe malore. Bazuar në ligjin 7501, toka bujqësore iu dha fermerëve në "copa" (i njëjti fermer ka një pjesë të tokës në fushë, një pjesë në kodër dhe mundësisht një pjesë në mal) për t'i kënaqur të gjithë. Kjo lloj ndarjeje e tokës ka nxjerrë në pah të gjitha problemet që lidhen me sistemin e ujitjes, kullimit të tokës e mekanizimit të bujqësisë dhe pritet të ketë pasoja edhe më të mëdha në nevojën për zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë (shumë fermerë nuk dëshirojnë të krijojnë kooperativa apo të bëhen pjesë e zhvillimeve strategjike si një e mirë e përbashkët për të gjithë).

*Tabela 1. Ndarja e tokës bujqësore për komunë në zonën në studim*

| Nr. | Komuna | Toka bujqësore në total (ha) | Pjesa e tokës bujqësore që shtrihet në fushë (ha) | Toka për përdorim bujqësor që gjendet në kodër dhe në mal (ha) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bushat | 6.663 | 6.495 | 168 |
| 2 | Bërdicë | 2.396 | 2.153 | 243 |
| 3 | Guri i Zi | 2.112 | 1.654 | 458 |
| 4 | Ana e Malit | 2.579 | 1.354 | 1.225 |
| 5 | Dajç (Shkodër) | 2.709 | 2.633 | 76 |
| 6 | Velipojë | 3.050 | 2.761 | 289 |
| 7 | Kolsh | 705 | 350 | 355 |
| 8 | Shëngjin | 1.020 | 1.020 | 0 |
| 9 | Balldre | 2.767 | 2.767 | 0 |
| 10 | Kallmet | 1.808 | 773 | 1.035 |
| 11 | Dajç (Lezhë) | 2.618 | 2.468 | 150 |
| 12 | Blinisht | 2.383 | 1.027 | 1.356 |
| 13 | Ungrej | 470 | 0 | 470 |

Megjithë pjellorinë e madhe të tokës dhe kushtet klimatike të shkëlqyera, zona po përballet me probleme të mëdha lidhur me përmbytjet, të cilat ndodhin rregullisht çdo vit. Si rezultat i këtyre përmbytjeve, prodhimi bujqësor është ulur ndjeshëm dhe, për më tepër, është gjithmonë në rrezik. Gjithashtu, problematike paraqitet dhe "larja" e tokave gjatë përmbytjeve duke i bërë ato më pak pjellore, që ka shkaktuar dhe uljen e dëshirës së fermerëve për të investuar në bujqësi.

*V.3.1.1 Prodhimi vjetor në zonë:*

Në zonën e Lezhës (përfshirë në studim) prodhohen rreth 13.000 ton perime, në një zonë prej 900 ha; 675 ton fruta, në një zonë prej 172 ha; 970 ton patate, në një zonë prej 107 ha; 9824 ton drithëra, në një zonë prej 2994 ha; si dhe 115700 ton ushqim për kafshët, në një zonë prej 4632 ha, 15551 ton qumësht dhe 990 ton mish. Në disa zona fermerët mbjellin dhe duhan. Megjithatë, kultivimi i duhanit ka rënë në mënyrë të ndjeshme.

Fusha e Nënshkodrës është mjaft pjellore dhe aty arrihen rendimente të larta. Kështu nga kultura e grurit merren 40 - 50 kv/ha, misër 70 - 90 kv/ha; perime 250 - 300 kv/ha, foragjere (kryesisht jonxhë) merren 400 - 500 kv/ha masë e njomë etj. Pra, siç shihet, kjo zonë ka prodhim mjaft intensiv për prodhimet bujqësore dhe blegtorale.

Struktura e kulturave bujqësore që kultivohen është: drithëra buke 28% e sipërfaqes; perime - patate 16%; foragjere 51%; pemë frutore, ullinj, vreshta 3%; të tjera (fasule, duhane etj) 2%.

Prodhimi i përgjithshëm në të gjithë zonën, mjafton vetëm për të kënaqur nevojat e vetë fermerëve për rreth 6 muaj të vitit.

Tregu i produkteve bujqësore është i pakontrolluar dhe në gjendje vërtet kritike. Prodhimet shiten në kushte shumë të ulëta sanitare, përgjithësisht përgjatë rrugëve. Për shkak të disa faktorëve, si problemi i pronësisë së tokës, mungesa e bashkëpunimit ndërmjet fermerëve, etj., tregu i këtyre prodhimeve mbetet i pazhvilluar. Në zonë mungojnë teknologjitë për paketimin dhe standardizimin e prodhimeve, si për shitje brenda vendit ashtu dhe jashtë.

Megjithëse, qeveria shqiptare ka nënshkruar disa marrëveshje për tregtinë e lirë me vendet e Ballkanit, përsëri fermerët shqiptarë nuk janë konkurrues në treg, duke krijuar efekte negative për ekonominë (në përgjithësi prodhimet që vijnë nga vendet fqinje janë me çmim të ulët, në cilësi më të mirë dhe ambalazhim bashkëkohor) dhe për prodhimin vendas.

### V.3.2 Peshkimi

Në Drinin e Lezhës rriten disa lloje peshqish si qefull, levrek, ngjalë etj. Aktualisht, peshkohen rreth 30 kv/vit. Zyrtarisht janë dhënë dy liçenca për peshkim në Drinin e Lezhës. Aty janë të vendosura dhe dhjete bilangje, në të cilat peshkohet sipas periudhave të caktuara. Në rrjedhjen fundore të tij është e zhvilluar zënia e peshkut, në të cilën, aktualisht, janë të punësuar rreth 85 vetë të organizuar në shoqata. Lidhja e lumit me lagunat Kune-Vain bëhet në Zaje, duke i furnizuar lagunat me ujë dhe me peshk.

Përveç lagunave, që janë të lidhura me lumin Drin, në zonën e basenit të tij (pjesa e Lezhës) janë edhe tre rezervuarë të mëdhenj që kanë mundësinë e rritjes së peshkut, megjithëse për këtë nuk është bërë asnjë studim.

Në zonën e Lezhës ushtrojnë aktivitetin e tyre dy kompani për përpunimin e peshkut (Poseidon në Shëngjin dhe Eurofish në hyrje të qytetit Lezhë). Të dyja kompanitë derdhin ujërat e ndotura në kanalet pranë tyre, të cilët më pas derdhen në trupat ujorë, si Kënalla dhe lumi Drin, duke u bërë kështu burime të rrezikshme ndotjeje për faunën dhe florën përreth, për tokën dhe vetë shëndetin e banorëve.

Influencë negative për rritjen e peshkut në lumin Drin kanë derdhja e ujërave të zeza të qytetit Lezhe, të cilat derdhen të papërpunuara, si dhe mbetjet që hidhen përgjatë ose në rrjedhën e tij.

Rezervuari i Shkodrës formohet nga liqeni i Vaut të Dejës, baseni i lumit Gjadër, lumenjtë Drin, Kir dhe Bunë, si dhe bregdeti i Velipojës, duke paraqitur një sistem hidrologjik të rëndësishëm për zhvillimin e sektorit të peshkimit.

Llojet autoktone të peshqve në zonë janë: Njila (Condrostoma); Gjuca (Alburnus alborela); Mlyshi (Leuciscus cephalus cabeta); Krapi (Cyprinus carpia); Barburiqi (Barbus meridionalis petenyi); Trofta (Salmo trutta)

Nga viti 1990 e në vazhdim, prodhimtaria e peshkimit është në rënie, si rezultat i shfrytëzimit pa kriter dhe keqmenaxhimit të burimeve peshkore. Mjaft lloje janë në zhdukje, lloje të tjera të padëshiruara janë futur duke bërë të mundur ndryshimin e strukturave peshkore në drejtim të padëshiruar. Mungojnë subjekte peshkimi që aplikojnë peshkim të qëndrueshëm, duke u lënë hapësira përdorimit të mjeteve të dëmtimit në masë. Kjo rënie e prodhimtarisë ushtron ndikimin e vet në thellimin e varfërisë së komunitetit përreth.

Në aspektin ihtiologjik, ujërat e vazhdueshëm dhe të bollshëm të lumit Buna shërbejnë për lëvizjen e llojeve migratore me rëndësi ekonomike dhe biodiversitetin për liqenin e Shkodrës. Lëvizjet janë masive, individuale dhe bëhen kryesisht në sezone të veçanta, më së shumti në pranverë dhe vjeshtë. Në varësi të migrimeve, peshqit ndahen në dy grupe: anadrom dhe katadrom.

Problemet sociale, moszbatimi i ligjeve, injoranca ihtiologjike bën që peshkimi të bëhet pre e gjuetisë shfarosëse me lëndë plasëse, madje dhe me energji elektrike. Pas trazirave të vitit '97, gjuetia vijoi me tritol dhe granata, me pasoja shkatërruese mjaft të mëdha.

Burimet peshkore të të gjithë zonës janë administruar nga ndërmarrja e peshkimit me qendër në Shkodër. Shfrytëzimi i kryer nga kjo ndërmarrje (gjuetia) ka qenë e bazuar në ligje që rrespektonin ruajtjen e llojeve dhe afate kohore të përcaktuara. Kjo gjueti nuk ka qënë intensive dhe zinte rreth 30-40 % të biomasave migratore.

Pasojat e dëmtimeve të ihtiofaunës në sistemin Liqen-Bunë po i vuan dhe pala malazeze, që ka shprehur shqetësime dhe njëkohësisht ofrojnë bashkëpunim.

### V.3.3. Vlerësimi i çështjeve kryesore

Prodhimtaria

Prodhimtaria pritet të rritet edhe më tej me masat që janë marrë dhe do të merren edhe në të ardhmen, në drejtim sistemimit të tokës, përmirësimit të sistemit të kullimit dhe ujitjes, mekanizimit, përdorimit të farave, racave, burimeve cilësore, futjes së teknologjive bashkëkohore si dhe organizimit të fermerëve në shoqata apo grupe prodhuese.

Faktorë kryesorë kufizues për marrjen e rendimenteve të larta e të qëndrueshme në bujqësi e blegtori, qe, pa dyshim, kërkojnë vëmendje të veçantë janë: kullimi, ujitja, organizimi dhe bashkimi i fermerëve.

Ujitja

Sipërfaqja nën ujë, para ndërrimit të sistemeve, ka qenë në masën 75 %, kurse sot ajo është në masën 46 %. Kjo ka ardhur si pasojë e shkatërrimeve të këtij sistemi gjatë periudhës së tranzicionit. Gjatë viteve të fundit janë bërë investime të konsiderushme, mbi 223 milion lekë, duke rehabilituar sipërfaqen e ujitur me mbi 920 ha, por kjo është pak në krahasim me atë që duhet arritur dhe që kushton mbi 400 milion leke .

Kullimi

Kullimi i tokave është problem kryesor. Kjo vështirësohet më tepër edhe nga copëzimi i tokave gjatë zbatimit të reformes. Gjithashtu, dhe kontributi i komunitetit nuk ka qenë në nivelin e kërkuar për pastrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit kullues.

Në këtë drejtim, gjatë kësaj periudhe janë bërë mjaft investime për rehabilitimin e këtij sistemi. Një projekti Bankës Botërore po ep kontribut për rehabilitimin e keëtij sistemi, por në këtë drejtim mbetet shumë për të bërë.

Dëmtimi i bazës ushqimore dhe prodhimeve foragjere do të shkaktonte probleme të pariparueshme në mbarështrimin e blegtorisë në ferma.

Fragmentizimi i tokave

Fragmentizimi i tokave erdhi si rezultat i reformës për tokën, në zbatim të ligjit 7501 - Për tokën ". Ndarja e tokës u bë sipas relievit fushor e kodrinor, sipas kategorisë e pjellorisë së ngastrave, sipërfaqeve nën e mbi ujë dhe largësisë nga qendrat e banuara etj. Kështu një familje fermere e ka tokën në 3-4 vende me nga 1-4 dynym. Një ndarje e tillë është negative sepse pengon sistemimin, kullimin, ujitjen, mekanizimin, zbatimin e teknologjive bashkëkohore etj. dhe si pasojë rendimentet janë të ulëta, kostoja e prodhimit e larte dhe të ardhurat e fermerëve janë të ulëta dhe efektiviteti ekonomik është tepër i vogël. Në këtë drejtim kërkohet që

- të përfundojë plotësisht ndarja e tokës dhe plotësimi i dokumentacionit përkatës që fermeri ta ndjejë veten pronar të ligjshëm;
- të punohet me komunitetin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, konflikteve dhe pengesave të hasura;
- të përfundojë regjistrimi fillestar i tokës në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe

fermeri të pajiset me certifikaten perkatese, kjo do t'i hapë rrugë tregut të tokës, dmth shitblerjes së saj dhe ngritjen e një tregu funksional për tokën.

Gjendja e tanishme është e pafavorshme për zhvillimin e bujqësisë, prandaj kërkohen që të krijohen grupime, shoqata apo ferma prodhimi private me madhësi sipërfaqe jo më të vogla se 10- 50 ha me qëllim që të rritet prodhimi nëpërmjet zbatimit të teknologjive të reja dhe të përballohet konkurenca e tregut.

Për sektorin e zënies së peshkut

Për këtë sektor ekzistojnë mundësi mjaft të mëdha, sidomos në zonën e Vaut të Dejës, e parë kjo në aspektin e aftësive ushqyese të këtij baseni dhe sipërfaqen e madhe të tij, mjafton të përdoren praktikat e viteve 1980-1990, ku me një shfrytëzim mesatar është arritur të kapet një sasi deri në 50 ton/viti.

Peshkim sezonal mund të aplikohet dhe në lumin e Bunës duke përdorur peshkimin selektiv.

Për sektorin e rritjes së peshkut (akuakulturën)

Në Laç-Vau i Dejës ekziston një ekonomi rritje peshku, e cila vite më parë ka prodhuar rasat peshku për popullimin e ujërave të liqeneve si dhe peshk për konsum. Me pak investime kjo ekonomi mund të vihet në punë.

Në ujërat e ftohta të lumit Drin është mundësia të aplikohet rritja e troftës “ylber”.

Ka mjaft zona përgjatë lumenjve Drin dhe Buna, ku mund të aplikohet rritja e peshkut; ekonomi të vogla familjare dhe rritje intensive.

Në rezervuarët në të gjithë zonën fushore të Lezhës mund të aplikohen metodat e rritjes së rasatit dhe përfitimit ekonomik dhe biologjik nga këto burime. Mbrojtja e llojeve autoktone dhe sidomos i blinit paraqet një rëndësi të veçantë për vetë shkallën e madhe të dëmtimit deri në zhdukje që ka pësuar ky lloj, por dhe lloje të tjera në zonë.

### V.3.4. Tendenca e faktorëve kryesorë

Për kullimin dhe ujitjen, gjendja është në përmirësim si rezultat i investimeve të bëra për rehabilitimin e këtij sistemi nga Banka Botërore në bashkëpunim me komunitetin.
Fragmentarizimi i tokave është i qëndrueshëm.
Për sektorin e zënies së peshkut, gjendja është në përkeqësim
Për sektorin e rritjes së peshkut, gjendja është në përkeqësim

### V.3.5. Lista e problemeve

| Problemi | Shkaku/qet | Ndikimi | Popullsia qe preket | Shkalla e ndikimit | Prioritarizimi |
|---|---|---|---|---|---|
| Mungesa e sistemit të kullimit të tokave bujqësore. | Shkatërrimi gjatë periudëhs së tranzicionit dhe mungesa e mirëmbajtjes të rrjetit kullues. | Ndikon negativisht në prodhimet bujqësore. Prish strukturën e tokes. Mbjelljet e kulturave bëhen me vonesë. Dëmtohet prodhimi Ulje e nivelit të jetesës dhe shëndetit të banorëve të zonës | Kryesisht zona e Nënshkodrës, komunat Bushat, Bërdicë, Ana Malit, Dajç, Velipojë, Guri i Zi etj . Banorët që preken janë afro 60%. | Është e lartë, sepse çdo vit kemi përmbytje sidomos në periudhën vjeshtë - dimër, por edhe në pranverë. Kjo dëmton si kulturat e pranverës ashtu edhe ato të mbjella në vjeshtë | * * * Është e rëndësishme dhe kërkon zgjidhje të shpejtë rehabilitimi i sistemit kullues |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Funksionimi jo i mire i sistemit te ujitjes | Prishja dhe shkatërrimi gjatë periudhës së tranzicionit dhe mospastrimi i kanaleve të para, të dyta dhe të treta . | Ndikon shumë për marrjen e rendimenteve të larta tek bimët. Uljen e prodhimit dhe rritjen e kostos Uljen e të ardhurave të fermerëve Dëmton shëndetin e kafshëve Uljen e mirëqenies së banorëve | Popullsia që preket më tepër gjendet në komunat e zonës së Nënshkodrës dhe të Mbishkodrës | Është e lartë sidomos gjatë periudhës së verës sepse mungesa e ujitjes dëmton prodhimet deri në 50%. | * * * Është shumë i rëndësishëm dhe duhet të punohet me shumë në rehabilitimin e këtij sistemi si nga investimet e Bankës Botërore ashtu edhe të vetë komunitetit. |
| Fragmentizimi i tokave bujqësore . Fermeri shkodran ka pak toke, afërsisht 1 ha për familje në pronësi, por edhe kjo në 3 - 4 vende. | Janë ndarë sipas relievit: fushë, kodër, mal, pjellorisë së tokës, sipërfaqeve nën dhe mbi ujë dhe largësia nga qendrat e banuara . | Tepër negativ sepse ndikon në rritjen e kostos të punimeve, të ujitjes, të përdorimit të inputeve, uljen e rendimentit, zbatimin e teknologjive bashkohore etj | Nga kjo preken të gjithë fermerët e Shkodrës. | Ndikimi është i lartë sepse prodhimi është i ulët dhe kostoja e lartë. Fermerët nuk përballojnë konkurencën e tregut. | * * * Shumë i rëndësishëm. Kjo kërkon të ndërgjegjësohen fermerët për rritjen e bashkëpunimit midis tyre për krijimin e grupimeve, shoqatave apo fermave private |
| Mungesa e aftësive organizuese për krijimin e shoqatave të peshkimit legal. | Dëmtim i burimeve peshkore. | Dëmtim i biodiversitetit. Ulje e nivelit ekonomik. Raste aksidentesh nga përdorimi i lëndëve plasëse për zënie peshku. | E gjithë zona në studim | Është e lartë pasi çdo vit dëmtohen sistematikisht resurset peshkore me pasoja për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm. | Është i rëndësishëm dhe kërkon ndërhyrje të menjëhershme në krijimin e shoqatave të peshkimit legal dhe monitorimin e resurseve peshkore për rikompensim. |
| Deri tani në këtë zonë nuk ekziston rritja e peshkut në kushte artficiale. | Mungesë përvoje, nivel i ulët ekonomik. | Ulja e nivelit ekonomik të zonës. | E gjithë zona në studim | E mesme, ka ndikim të ndjeshëm në nivelin ekonomiko-ekologjik. | Aplikimi i akuakulturës do të bënte të mundur rritjen e nvelit të punësimit, rritjen e nivelit ekonomik, kalimin e një pjese të peshkatarëve ilegalë në rritësa peshku; shtimin e burimeve peshkore në ujërat natyrale; përdorimin e tokave të papërshtatshme për kulturat bujqësore. |

### V.3.6. Ndërveprimi me çështjet e tjera

Mungesa e prodhimeve bujqësore e blegtorale, në sasi e cilësi, ul edhe nivelin e turizmit, si pasojë kemi rritje çmimesh, të shoqëruar me rritje të kostos së pushimeve, e, për pasojë, numri i turistëve vendas apo të huaj do të ulet ndjeshëm.

Sektori i bujqësisë është i lidhur me shumë sektorë të tjerë e, në mënyrë të veçantë, me ruajtjen e mjedisit. Në praktikën e prodhimit bujqësor, krahas të tjerave, përdoren edhe kimikate të ndryshme si plehra dhe pesticide, të cilat, krahas anëve pozitive për rritjen e prodhimit, lenë mbetje të dëmshme për shëndetin në produktet bujqësore si dhe ndotin tokën, ujin, ajrin etj. Prandaj përdorimi sa më racional i tyre dhe zëvendësimi me plehra organike për ruajtjen dhe shtimin e pjellorisë së tokës është një domosdoshmëri. Gjithashtu është e nevojshme që, për luftimin e sëmundjeve, dëmtuesve dhe barërave të këqija, të përdoren metoda të tjera si agroteknike, mekanike, fizike, biologjike etj, me qëllim minimizimin e përdorimit të kimikateve të ndryshme dhe rritjen e rendimenteve të kulturave bujqësore. Në këtë drejtim po punohet për bujqësinë e qëndrueshme, të integruar dhe me prodhime të pastra biologjikisht.

Sektori i peshkimit përfshirë dhe akuakulturën ndërvepron me: a) Turizmin sportiv, sidomos atë që lidhet me peshkimin sportiv, ku lumenjtë, me pamjet e bukura që ofrojnë, krijojnë mundësira mjaft të mëdha veprimi; b) Akuakulturën, sektor që ka kërkesa të theksuara ndaj prodhimeve bujqësore-blegtorale.

### V.3.7. Çfarë po bëhet?

Qeveria ka strategji të veçanta, programe dhe projekte për zhvillimin e bujqësisë. Kështu, nëpërmjet investimeve të Bankës Botërore, po punohet për rehabilitimin e sistemit të ujitjes dhe kullimit. Kjo kërkon që edhe fermerët të jenë bashkëpunëtorë dhe bashkëfinancues në zbatimin e këtij projekti. Ata duhet të kontribuojnë duke paguar 300 lekë/dynym për sipërfaqet nën ujë. Deri tani, në këtë projekt janë investuar 575 milionë lekë, duke rehabilituar sipërfaqen e ujitur mbi 9020 ha dhe në kullim mbi 8000 ha.

Aktualisht, po punohet në komunën Bërdicë, për rehabilitimin e sistemit të ujitjes në 1500 ha. Të gjithë këto investime kapin shifrën deri 800 milionë lekë për Shkodrën.

Projekte të tjera janë:

2KR që jep kredi për furnizimin e fermerëve me mjete mekanike. Deri tani janë shpërndarë 57 traktorë të rinj me gjithë pajisjet e tyre me një vlerë rreth 107 milionë lekë.

Projekti i Shërbimeve Bujqësore, në kuadër të të cilit janë grumbulluar shumë projekte dhe janë mbështetur 8 prej tyre me një vlerë prej 110.200 USD.

Mbështetje ka ofruar dhe projekti shqiptaro -turk (Tika) në Shkodër dhe Malësi e Madhe "Për mbarështrimin e gjedhit Xhersej", me vlerë prej 346.370 USD.

Në komunën e Dajçit dhe Ana e Malit, nga FAO, janë duke u investuar në sektorin e blegtorisë afro 222.360 USD.

Bashkëpunime të tjera ka edhe me OJF që veprojnë në qarkun e Shkodrës si: LVIA, OXFAM. TAULEDA, GTZ, AFADA, LEA, etj.

Për agropërpunimin, aktualisht, në qarkun e Shkodrës ka linja bashkëkohore që i pergjigjen standartdeve të BE. Si shembuj mund të përmendim: linja për përpunimin e mishit, të qumështit, të ullirit, të rrushit, të pijeve të ndryshme dhe deri tek linja për nxjerrjen dhe përpunimin e esencave të bimëve mjekësore dhe eterovajore.

Strategjia qeveritare e menaxhimit të ujërave synon krijimin e subjekteve fizike për gjuetinë e peshkut me mjete selektive dhe të bazuar në kuadrin ligjor në fuqi. Në këtë fushë po punohet në bashkëpunim me pushtetin vendor.

Projekte në fushën e peshkimit, për këto zona, të paktën deri tani nuk ka.

Përsa i përket akuakulturës, iniciativa e lirë ende nuk po vepron, kjo për faktorë dhe arsye të ndryshme: mungesa e shkallës së njohjes, ekzistenca e problemeve ekonomike dhe, mbi të gjitha, kapacitetet teknike e informuese janë të pakta.

# V.4. Biodiversiteti

## V.4.1. Analizë e përgjithshme e gjendjes

Për shkak të pozicionit gjeografik, karaktistikave hidrogjeologjike, klimës e mikroklimës, relievit etj. delta e Drinit të Lezhës dallohet për larmi të diversitetit biologjik dhe të pejsazhit. Habitatet e shumta ligatinore si ato detare, estuarine, riverine, liqenore, ligatinore apo dhe joligatinore si pyje, shkurreta, kullota dhe toka bujqësore i japin kësaj delte vlera të rëndësishme faunistike e pejsazhore kombëtare e rajonale.

*Dunat ranore*

Sistemi i dunave ranore të zonës së marrë në studim shtrihet përgjatë detit Adriatik, në gjirin e Drinit dhe në grykëderdhjen e lumit Buna e Drin. Në përgjithësi, ky sistem, krahasuar me atë të vendeve të tjera në Mesdhe, është i ruajtur mirë në kushtet natyrore. Por nga ana tjetër, aktiviteti njerëzor, nëpërmjet zhvillimit të infrastrukturës, urbanizimit dhe turizmit, përfaqëson një kërcënim të përhershëm dhe në rritje për ekosistemet e plazheve dhe dunave ranore.

Llojet indikatorë të brezit të parë ranor: brokeri bregdetar (*Cakile maritima*) dhe këmbëkuqja (*Salsola kali*) paraqiten të zhvilluara mirë në pjesën veriore të plazhit të Velipojës në afërsi të Rezervatit.

*Pyjet aluvionalë bregdetarë*

Pyjet natyrorë aluvionalë të bregdetit shqiptar përfaqësojnë pyje tipikë higrofilë të përhapur kryesisht në grykëderdhjen e lumenjve Mat, Drin e Bunë, mbi toka aluvionale kryesisht bazike, me nivel të lartë të ujërave nëntokësore dhe të përmbytura shpesh nga vërshimet apo shirat e rrëmbyeshëm. Deri para 10-15 vjetësh, këto pyje përfaqësonin një nga ekosistemet më të bukura të detit Adriatik, mjaft të larmishëm, gati të pakalueshëm nga ndërthurjet me lloje të ngjashme me lianat dhe me elementë bazë ato kozmopolitë evropianë higrofilë, të përfaqësuar nga lloji indikator verri i zi (*Alnus glutinosa*), me vlera të larta të sasi-mbulesës dhe të ngjashme me frashërin e ujit (*Fraxinus angustifolia*), si dhe me pjesëmarrje disi më të vogël të llojeve të tilla si rrenja (*Quercus robur*), plep i bardhë (*Populus alba*), vidhi i vogël (*Ulmus minor*).

Gjendja e tyre paraqitet mirë në zonën e Velipojës, rezervatit të Kune-Vainit. Kushtet specifike të përhapjes së këtyre pyjeve (toka aluvionale me nivel të lartë të ujërave nëntokësore dhe që përmbyten kohë pas kohe), në përgjithësi nuk lejojnë instalimin e specieve invazive apo konkurrencën e tyre ndaj llojeve autoktone. Prania e disa llojeve të tilla si plepi kanadez (*Populus canadensis*) (Patok, Velipojë,etj), Robinia pseudacacia (Velipojë, Kune, Patok) është rezultat i veprimtarisë së gabuar të njeriut në drejtim të praktikave të pyllëzimeve në këto zona.

Disa lloje të rralla dhe të rrezikuara

Është përcaktuar saktësisht areali i përhapjes së *Quercus ilex* (Ilqja) në rajonin bregdetar, dhe rrallë në pyjet aluvionalë të Velipojës dhe Kune-Vainit. Ruajtja dhe shtimi i këtij lloji mund të bëhet nëpërmjet shpalljes të disa zonave të përhapjes së saj si zona tepër të mbrojtura.

*Fauna e lagunave bregdetare*

Muzeu i Shkencave Natyrore ka monitoruar faunën e lagunave kryesore bregdetare, e cila paraqitet më poshtë, sipas grupeve kryesore.

Gjitarët

*Tabela 2. Llojet e rrezikuar të gjitarëve në zonat ligatinore bregdetare, të përfshira në monitorim për 2002.*

| Lloji | Velipoja | Kune-Vaini |
|---|---|---|
| Gjitarë bioindikatorë të rrezikuar | 4 | 7 |
| Gjitarë bioindikatorë të vrojtuar | 14 | 11 |
| Raporti lloje të rrezikuar/ lloje të vrojtuar (në %) | 28,6 | 63,6 |

Gjendja paraqitet më negative në zonat e Kune-Vainit dhe Patokut, ku llojet e rrezikuar zenë përkatësisht 63,6% dhe 61,5% të llojeve të vrojtuar në këto zona. Në zonën e Velipojës, llojet e rrezikuar në raport me llojet e vrojtuar në to, janë më të paktë në numër (përkatësisht 28,6%, 29,4% dhe 38,9%), gjë që tregon për gjendjen relativisht të mirë, të stabilizuar me tendencë të lehtë në përmirësim.

*Shpendët dimërues*

Kompleksi i Velipojës, i përbërë nga Laguna e Vilunit, Rezervati i Velipojës dhe bregu detar, ka qenë objekt i vrojtimeve dimërore të gjashtë sezoneve, gjatë periudhës 1993-2002. Mesatarja shumëvjeçare luhatet rreth shifrës së 4.340 individëve dimërues. Maksimumi i shpendëve është regjistruar në vitin 2001 (afro 7.900 individë), ndërsa shifra minimale është kapur në vitin 1996 (afro 2.300 individë). Numri i përgjithshëm i shpendëve të vrojtuar në 2002, ndonëse mjaft më i ulët se maksimumi i regjistruar në vitin 2001, nuk ndryshon shumë me mesataren shumëvjeçare. Kjo e fundit duket normale po të marrim parasysh se zona e Vilunit nuk ka kurrfarë status mbrojtjeje. Zona në fjalë është vazhdimisht e shqetësuar nga peshkimi dhe sidomos gjuetia.

Në kompleksin e Kune Vainit, në 2002, u vrojtuan 32 lloje të shpendëve të ujit me një numër të përgjithshëm prej 2.318 individësh dimërues. Kjo është shifra më e ulët e regjistruar gjatë periudhës 1995-2002. Që prej vitit 1995, vit i cili shënonte dhe maksimumin e shpendëve të regjistruar me afro 17.250 shpendë, duket qartë që kompleksi sa vjen e humbet rëndësinë e tij për shpendët e ujit dimërues. Shumica e shpendëve, afro 47%, janë të përqendruar në sipërfaqet ujore të Vainit, të ndjekura nga ato të Merxhanit. Në ndryshim nga vitet e mëparshme, numri i shpendëve në det është mjaft i ulët.

*Tabela 3. Numri i individëve dimërues në vite në kompleksin e Kune- Vainit për disa vite në periudhën 1995-2002*

| 1995 | 1996 | 1997 | 2001 | 2002 |
|---|---|---|---|---|
| 17.250 | 9.723 | 10.795 | 3.370 | 2.318 |

*Shpendët folezues*

Në kompleksin e Velipojës, numri i llojeve folezues, ashtu si dhe në ligatina të tjera shqiptare, është i ulët. Janë vrojtuar vetëm 12 lloje dhe 55-143 çifte folezues.

Mungesa e folezuesve kolonialë është shenjë e qartë e presionit të njeriut dhe mungesës së vendeve të përshtatshme për folezim.

Në të gjithë kompleksin e Kune-Vainit u vrojtuan, gjatë ekspeditave verore, mbi 45 lloje shpendësh (184 individë), ku vetëm një pakicë i takon grupimit të shpendëve të ujit. Folezuesit e rregullt kapin shifrën e 11 llojeve, ndërsa llojet e tjerë mund të jenë fare mirë individë të cilët kalojnë sezonin e verës në një territor të caktuar. Në tërësi, numri i shpendëve të vrojtuar është shumë më i ulët se vetë kapaciteti mbajtës i zonës, ndonëse flitet për dy Zona te Mbrojtura me Statusin e Rezervatit Natyror të Manaxhuar.

*Shkaqet e gjendjes së vështirë të shpendëve janë :*

- Gjuetia e paligjshme, përndjekja e kafshëve, kapja e tyre për qëllime tregtimi janë, tani për tani, faktorët që shkaktojnë dëmet më të mëdha tek shpendët.
- Gjuetia pa kriter, pa respektuar asnjë sezon të përcaktuar gjuetie, duke përdorur të gjitha mjetet e paligjshme si pushkët automatike, imituesit e zërave të shpendëve, dritat etj. Kafshet e medha janë ato më të prekurat nga kjo lloj gjuetie.
- Peshkimi i paligjshëm me mënyra ilegale të peshkimit, si ato me drita apo dinamit. Rrjetat e peshkatarëve qëndrojnë tërë kohës në ujë, duke bërë të pashfrytëzueshme pjesën më të madhe të sipërfaqes ujore. Anijet e peshkimit peshkojnë përgjatë bregut të detit, në zona të ndaluara, duke shkatërruar gjithçka në fundin e tij. Këto mënyra peshkimi zvogëlojnë rezervat ushqimore të shpendëve si dhe sjellin shqetësimin e vazhdueshëm të tyre.

*Amfibët dhe reptilët*

Në zonat lagunore janë gjetur 10 lloje amfibësh e 29 lloje reptilësh. Zona e Kunes ka numrin më të madh të llojeve të rrezikuar të amfibëve e reptilëve (14 lloje), megjithatë gjendja nuk është shumë pozi-

tive. Kështu, numri i breshkës së tokës (Testudo hermanni) ka rënë rreth 2 herë në krahasim me 10 vite më parë; numri i shigjetës së gjatë (Coluber caspius), shigjetës së shkurtër (Coluber gemonensis), bollës së shtëpisë (Elaphe longissima), ka rënë rreth 4 herë. Rëniet e popullatave për shumë lloje reptilësh vihen re më shumë në pyllin e Kunes sesa në atë të Vainit.

*Fauna në deltën e Drinit*

Shpendët e gjitarët janë elementët më tërheqës dhe më të rëndësishëm në përbërje të biodiversitetit të luginës së lumit Drin e të përrenjve që e ushqejnë. Ujërat e këtij rrjeti, veçanërisht për gjitarët, janë element mjaft jetik. Gjitarë të mëdhenj si ujku (*Canis lupus*), çakalli (*Canis aureus L.*), derri i egër (*Sus crifa L.*) janë vizitorët më të shpeshtë të lumit e përrenjve, në varësi të aktivitetit të tyre jetësor. Gjitarë të tjerë si lundërza (*Lutra lutra L.*) e kanë lidhur jetën e tyre me mjedisin ujor lumor të cilit i përkasin.

Në një farë kuptimi, faktori antropogjen nuk ka ndikuar aq shumë në luginat e thella të përrenjve malorë, të cilat kanë mbetur kështu mjedise të favorshme dhe me potenciale për riprodhimin e shpendëve dhe gjitarëve.

Në zonën në shqyrtim dallohen gjitarë e shpendë nën mbrojtje të veçantë si derri i egër (*Sus crifa L.*), thëllëza e fushës (*Perdix perdix L.*), kumuria (*Steptopelia decaocto Friv*) etj. Veç tyre, në këtë zonë, janë të përhapur dhe mjaft gjitarë me rëndësi ekonomike si dhelpra (*Vulpes vulpes L.*), kunadhja (*Martes faina Elxl.*), zardafi (*Martes martes L.*), baldosa (*Meles meles L.*) qelbësi (*Mustela putorius L.*), ketri (*Sciurus vulgaris L.*), lundërza (*Lutra lutra L.*) dhe shpendë si thëllëza e malit (*Alectoris graeca Meisner*), pëllumbi i egër (*Columba L.*), turtulli (*Streptopelia turtur L.*)

Në avifaunën e rajonit në shqyrtim bëjnë pjesë shpendë karakteristikë të shkurretave e të pyjeve, por dhe të mjedisit urban (*Athene noctua, Falco tinnunculus, Anthus campestris, Corone cornix, Corvus corax, Pica pica, Passer domesticus, Carduelis carduelis*, etj). Veçanërsisht më të njohur janë mëllenja (*Turdis merula*), gargulli i zi (*Sturnix vulgaris*), lauresha (*Aleuda arvensis*), turtulli (*Streptopelia turtur*), qukapiket, trishtilat, harabelat, gushëkuqët etj.

Nga reptilët gjenden më shumë *Lacerta viridis, Podarcis muralis, Anguis fragilis,Vipera amodytes, Natrix sp.,Coluber sp,*.e breshka e zakonshme (*Testudo hermani, Gmel*). Në Malin e Rencit dhe atë të Kakarriqit takohet edhe *Vipera amodytes*.

Habitatet me lagështirë kanë favorizuar instalimin e mjaft amfibëve, ku më të njohur janë bretkosat, si ajo e zakonshme (*Rana ridibundo Pall)*, bretkosa e pyllit (*Rana dalmatika Boul, Rana graeca*), thithlopa e zakonshme (*Bufo bufo*), thithlopa e gjelbër (*Bufo viridis Laur*), verorja (*Hyla arborea*), (*Bombina variegata*) etj.

*Flora në deltën e Drinit*

Bimësia shkurrore, gjithmonë, gjendet e përzier, por, sipas ndikimi të njërit apo tjetrit faktor ekologjik, ndodh mbizotërimi i njërit apo tjetrit lloj. Kështu, shkoza mbisundon me uljen e lartësisë.

Sipërfaqe të mëdha, të zëna më parë nga bimësia e makjeve në terrenet fushore dhe në disa zona të atyre kodrinore, janë shpyllëzuar dhe janë mbjellë me bimë bujqësore. Kjo ka sjellë ndikimet e veta në regjimet ujore të përrenjve që i përshkojnë këto zona.

Shpatet e maleve të Kakarriqit, Malit të Shëngjinit e atij të Rencit, në perëndim të deltës, si dhe ato të Molungut e Kreshtës e Shelbumit, në lindje, mbartin potenciale floristike të shumëllojshme dhe tërheqëse.

Në zonën fushore e kodrinore, faktori antropogjen ka ndikuar në tjetërsimin e vlerave natyrore të bimësisë duke i kthyer në terrene me bimësi bujqësore. Bimësia në buzë të lumit, në zonën fushore, është, përgjithësisht, e uniformizuar, e izoluar dhe e dëmtuar. Brezi mbrojtës natyror është zvogëluar nga ndërhyrjet e ndryshme. Areali i bimësisë buzë Drinit është limitizuar shumë, meqënëse lumi kalon në zonë fushore dhe ka një shtrat më të fiksuar, si dhe një debit prurjesh mesatare më të pakët. Por kjo gjendje duket pak më e përmirësuar në drejtim të deltës së tij, ku ndodhet laguna e Kune-Vainit.

Në të dy buzët e lumit Drin, pa arritur në Kune – Vain, nuk dallohen formacione të mirëfillta pyjore, por vetëm grupe drurësh, në areale të kufizuara. Kështu, drurët më të rëndësishëm janë: shelgjet, verriu, frashëri, vidhi, rrapi.

### V.4.2. Zonat e mbrojtura

*Lagunat e Kune dhe Vain*

Kompleksi ligatinor Kune – Vain, (zonë e mbrojtur sipas kategorisë IV) përbën zonën më atraktive e më të spikatur të deltës së lumit Drin për diversitet biologjik. Ky kompleks shtrihet në të dy anët e grykëderdhjes së lumit Drin, duke zënë një sipërfaqe prej 2.300 ha.

Delta e Drinit ka statusin e zonës me rëndësi për shpendët (IBA). Kompleksi ligatinor Kune Vain i kësaj delte përfaqëson një zonë që mund të shpallet zonë Ramsar, meqënëse duket se i plotëson kriteret e kërkuara. Ky kompleks është vlerësuar nga specialistët si një privilegj i natyrës shqiptare dhe perlë e saj, ndërkohë që, në Konferencën e Algjerit (1985), është vlerësuar me vendin e parë per pejsazhin.

Lagunat janë në një gjendje mjaft kritike, si rezultat i:

- Dëmtimit të florës dhe faunës, për shkak të ndërhyrjeve ilegale, peshkimit të pakontrolluar dhe gjithëvjetor;
- Ndërtimeve të paligjshme brenda zonës së mbrojtur;
- Dëmtimit të komunikimit të lagunave me detin dhe mungesës së fondeve për të mbajtur kanalin hapur

*Lumi Buna dhe Velipoja*

Lumi Buna dhe zona e Velipojës ka një florë shumë të pasur, duke përfshirë lloje të rëndësisë kombëtare dhe globale. Sipas vrojtimeve kombëtare dhe ndërkombëtare dhe të dhënave ekzistuese, në këtë zonë janë numëruar 216 lloje të faunës me rëndësi kombëtare dhe 36 lloje të faunës me rëndësi globale.

Që prej nëntorit 2005, zona e lumit Buna, së bashku me deltën dhe ishullin e Franc Jozefit, rezervatin e Velipojës, lagunën e Vilunit, plazhin e Baks-Rrjollit, kënetën e Domnit, si dhe territoret përreth tyre janë shpallur “Pejzazh ujor/tokësor i mbrojtur”.

Megjithëse prej dekadash, zona e Velipojës ka pësuar dëme, flora dhe fauna duken të jenë ruajtur në gjendje të mirë. Prerjet ilegale dhe zjarret janë shumë të rralla. Kombinimi i tipeve të ndryshme të vegjetacionit, halofileve, psamofileve dhe ujërat e ëmbla dhe të kripura e bëjnë këtë zonë një nga më tërheqëset dhe interesantet në Shqipëri. Mbrojtja e rezervatit të Velipojës duhet të jetë prioritare në të ardhmen.

*Liqeni i Shkodrës*

Liqeni i Shkodrës, bashkë me lumin Buna dhe zonën e Velipojës janë nën statusin e V të mbrojtjes, ku vetë liqeni ka nivelin e IV të mbrojtjes. Gjithashtu, ky liqen është zonë Ramsar që nga fillimi i vitit 2006, çka përbën një ndryshim thelbësor në mbrojtjen e tij dhe në mënyrën se si do të menaxhohet në të ardhmen.

Nga pikëpamja shkencore dhe njohuritë mbi liqenin, informacioni mbi biodiversitetin e tij është i pasur. Larmia biologjike e liqenit të Shkodrës është shtuar nën kushtet e jashtëzakonshme gjeomorfologjike, gjeografike, klimatike dhe ekologjike. Larmia biologjike është e lartë dhe e gjithë zona konsiderohet një rezervë biogjenetike me rëndësi evropiane. Ndëkohë që larmia e tij biologjike përdoret për ushqim, mundësitë bioteknologjike dhe bimët mjekësore nuk paraqesin një mundësi fitimi për banorët, megjithë larminë e madhe që liqeni ofron.

Nga perspektiva zoogjeografike, liqeni ndodhet në një zonë ku takohen dy zona të rëndësishme zoogjeografike: Paleoarktiku dhe Paleotropiku. Nga një këndvështrim më i hollë, Mesdheu dhe Evropa kontinentale, së bashku me disa karakterstika faunistike të gjetura në Azi, ndikojnë direkt këtë rajon. Këto lidhje tregohen më mirë nga disa shembuj të zogjve migratorë nga Afrika dhe zogj migratorë dimëronjës nga Siberia perëndimore.

Megjithatë, Liqeni i Shkodrës kërkon një mbrojtje të përshtatshme. Rregulla më të forta duhet të vihen kundrejt kontrollit të ndotjes, përmes monitorimeve të vazhdueshme për të gjetur rrugën më të përshtashme për mbrojtjen e tij.

*Disa nga faktorët që ndikojnë negativisht në liqen*

- Ndërtimet përreth liqenit. Këto lloj ndërtimesh zakonisht nuk kanë sisteme për largimin e ujërave të përdorur dhe, si rezultat, ato derdhen direkt në liqen pa trajtim paraprak. Si rezultat është vënë re një rritje e nivelit të fosforit dhe substancave që ulin nivelin e oksigjenit të tretur.
- Metoda ilegale peshkimi. Përveç dëmit që kanë pësuar popullatat e peshkut, dinamiti dhe rryma elektrike janë përdorur në liqen, duke lënë pasoja të rënda në larminë e peshqve dhe llojeve të tjera në liqen,
- Përdorimi i liqenit për banjo verore. Gjatë verës mund të vihet re një rritje e ndotjes bakteorologjike që vjen kryesisht nga larja në liqen.
- Ndotja idustriale. Ndotja industriale që vjen nga industritë përreth liqenit është një faktor shumë i dëmshëm për të.
- Ndotja nga mbetjet urbane dhe veçanërisht nga ujërat e përdorura të qytetit, të cilat derdhen direkt në liqen, krijon kushtet për shtimin e viruseve dhe përhapjen e sëmundjeve bakteorologjike.

12.1 Kuadri ligjor për administrimin, mbrojtjen e menaxhimin e zonave të mbrojtura përbëhet nga disa ligje ku më kryesorët janë : Ligji nr. 8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura" si dhe Ligji nr. 8934 datë 05.09.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit".

Këto ligje si dhe të tjerë, të cilët mbrojnë zonat e mbrojtura, po hasin probleme të mëdha me zbatimin, shkaktuar kryesisht nga mungesa e burimeve njerëzore dhe mungesa e vullnetit nga autoritetet vendore për të ndërhyrë atëhere kur ka shkelje.

### V.4.3. Pyjet

Pyjet natyrorë të bregdetit të deltës së Drinit përfaqësohen nga pyje tipikë higrofilë, mbi toka aluvionale kryesisht bazike, me nivel të lartë të ujërave nëntokësore dhe të përmbytura shpesh nga vërshimet apo shirat e rrëmbyeshëm. Deri para 10-15 vjetësh, këto pyje përfaqësonin disa nga ekosistemet më të bukura të detit Adriatik, mjaft të larmishëm, gati të pakalueshëm nga ndërthurjet me lloje të ngjashme me lianat dhe me elementë higrofilë të përfaqësuar nga lloji indikator, verri i zi (*Alnus glutinosa*). Me vlera të barabarta të sasi-mbulesës është instaluar dhe frashëri i ujit (Fraxinus angustifolia) dhe me pjesëmarrje disi më të vogël të llojeve të tilla si rrenja (*Quercus robur*), plepi i bardhë (*Populus alba*), vidhi i vogël (*Ulmus minor*).

Në kodrat e Molungut, në zonën e Velës, dallohet një formacion i pishës së zezë (Pinus nigra), duke krijuar vlera të veçanta pejsazhiste e klimatike.

Dëmtimet në këto pyje 15-vjetët e fundit janë të dukshme në brezin Shëngjin-Kune. Pyjet e dikurshëm, në këto zona, po marrin, gjithnjë e më shumë, pamjen e shkurretave, kthimi i të cilave në gjendjen e mëparshme mund të kërkojë një periudhë më shumë se 10-15 vjeçare. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre pyjeve në zonën e Kunes po degradojnë nga erozioni si dhe nga kapërderdhja e ujërave të kripura detare. Një sipërfaqe e konsiderueshme në zonën e Merxhanit (Kune) e në Matkeqe (Vain) ështe e pyllëzuar me pishë të egër (*Pinus halepensis, Pinus pinaster*), e cila është dëmtuar nga prerjet e kundërligjshme dhe erozioni i viteve të fundit. Pyllëzime të konsiderueshme me pishë jane bërë edhe në malin e Shëngjinit, në shpatin në zonën e Balldrenit, të malit të Shelbumit, por që janë dëmtuar shumë nga prerjet e kundërligjëshme.

Në zonën në studim ndodhen dhe disa objekte pyjore me vlera të veçanta natyrore të shpallura monument natyre, si Rivat e Drinit (Kune), Pylli i Shënmisë (Kallmet) Rrapi i Grykës e Rrapat e Kolshit (Kolsh) Lisi i Markatomajve (Spiten).

### V.4.4. Analiza e çështjeve kyçe:

*Degradimi i lagunave Kune – Vain, varfërimi i biodiversitetit nga:*

- Shfrytëzimi pa kriter i burimeve të florës e faunës, ndërhyrjet e kundërligjshme, përdorimi i praktikave shkatërruese në peshkim etj;

- Ndërtimet pa leje pranë ose në zonat e mbrojtura, hyrja e lirë e njerëzve dhe e automjeteve;
- Mungesa e zonës buferike për Kunë – Vainin;
- Prishjet e regjimit të komunikimit hidrik lagunë - det dhe mungesa e investimeve për ruajtjen e këtij komunikimi;
- Erozioni i lartë bregdetar nga pakësimi i aluvioneve që sjell lumi Drin.

*Humbja e vlerave natyrore të trashëguara të lumit Drin (të Lezhës) e shtratit të tij, dëmtimi i biodiversitetit nga:*
- Ulja e llojshmërisë biologjike, sidomos e peshqve, dëmtimi i habitateve në të dy anët e shtratit të lumit, shfrytëzimi pa kriter i burimeve të florës e faunës;
- Tjetërsimi e prishja e habitateve të të gjithë zonës ujëmbledhëse të Lumit Drin (të Lezhës);
- Mungesa e zonës buferike dhe fragmentimi i habitateve, prishja e korridoreve ekologjike;
- Shfrytëzimi pa kriter i burimeve natyrore (gëlqerorët) dhe dëmtimi i pejsazhit.

*Nga problematika, që ka të bëjë me administrimin e fondit pyjor, vemë në dukje:*
- Dëmtime e prerje disavjeçare të pyjeve, kryesisht për materiale drusore, që lidhe me tregtimin e paligjshëm të materialit drusor dhe të prodhimeve të tjera jodrusore;
- Dëmtimi e mungesa e një brezi pyjor mbrojtës (bufer) në të dy anët argjinaturës së lumit Drin, humbja e vlerave të pejsazhit;
- Zënia e këtij fondi nga hapja e guroreve pa një strategji apo planifikim të përshtatshëm, humbja e pejsazhit;
- Zvogëlimi i sipërfaqes pyjore, (janë krijuar tre fidanishte pyjore, me një sipërfaqe gjithsej 1,5 ha, që është mjaft minimale për të plotësuar nevojat për fidanë pyjorë);
- Erozioni mbetet aktiv në një sipërfaqe të konsiderueshme pyjore;
- Mungesa e kapaciteteve në zbatimin e ligjit nga administruesit;

## V.4.5. Tendencat e foktorëve kyç

- Degradimi i lagunave Kune – Vain, varfërimi i biodiversitetit është në përkeqësim
- Humbja e vlerave natyrore të trashëguara të lumit Drin (të Lezhës) dhe shtratit të tij, dëmtimi i biodiversitetit në përkeqësim;
- Dëmtime e prerje disavjeçare të pyjeve, kryesisht për materiale drusore, të lidhura këto me tregtimin e paligjshëm të materialit drusor dhe të prodhimeve të tjera jodrusore - në përmirësim;
- Dëmtimi dhe mungesa e nje brezi pyjor mbrojtës (bufer) në të dy anët argjinaturës së lumit Drin - e qëndrueshme
- Zënia e fondit pyjor nga hapja e guroreve pa një strategji apo planifikim të përshtatshëm - në përkeqësim;
- Zvogëlimi i sipërfaqes pyjore - në përkeqësim;
- Erozioni mbetet aktiv në një sipërfaqe të konsiderueshme pyjore - në përkeqësim;
- Mungesa e kapaciteteve në zbatimin e ligjit nga administruesit - në përmirsim.

### V.4.6. Lista e problemeve

| Problemi | Shkaku | Ndikimi | Popullsia qe preket | Shkalla e ndikimit | Prioritarizmi |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. Varfërimi i biodiversitetit, degradimi i zonave të mbrojtura Kune-Vain | a. Rritja e gjuetisë së kundërligjshme. b. Mungesa e kapaciteve të organeve përgjegjëse në zbatimin e ligjit dhe në mbrojtjen e faunës dhe administrimin e fondit të gjuetisë. c. Dëmtimet e habitateve, fragmentarizimi i tyre, dëmtimi korridoreve ekologjikë d. Ndërtimet në brendësi të zonave të mbrojtura. e. Mungesa e ndërgjegjësimit të komunitetit për mbrojtjen e pasurive faunistike e florisitike. | Rënia e theksuar e llojeve të shpendëve, veçanërisht në zonën e mbrojtur Kune-Vain, dhe pakësimi i popullatave të tyre. Përkeqësimi i gjitarëve. Dëmtimi i pejsazhit në Kune - Vain dhe në shpatet malore nga prerjet e kundërligjshme | Popullsia e komunës Shëngjin, si dhe qytetit Lezhë. Indirekt preket dhe gjithë popullsia e rajonit e më gjerë, sepse është dëmtuar një potencial i rëndësishëm i ekoturizmit. | E lartë (Në koloninë e Kunes ka rënie më shumë se 50 herë të numrit të çifteve të shpendëve folenizues, në krahasim me vitin 1951. Habitatet janë dëmtuar rëndë nga prerjet e drurëve) | ** |
| 2. Rritja e ndotjes se ujrave te lumit Drin e Liqenit te Knalles e varferimi i pasurive ihtike (peshkore) | Shkarkimi i ujërave të zeza të patrajtuara të qytetit të Lezhës, Komunave Shëngjin, Mabë, Balldre, Kallmet, Kolsh në lumin Drin, si dhe i qytetit Shëngjin në liqenin e Knallës. | Varfërimi i pasurive ihtike, rënia e numrit të llojeve dhe pakësimi i popullatave | Popullsia e komunës Shëngjin, si dhe qytetit Lezhë. Indirekt preket dhe gjithë popullsia e rajonit e më gjerë, sepse është dëmtuar një potencial i rëndësishëm i ekoturizmit. | E lartë (Lumi Drin ka një ngarkesë të lartë me mbeturina urbane, që vërehet dhe nga depozitimet e tyre në anën veriore të bregdetit të deltës së Drinit. Liqeni i Knallës më i ndoturi në vendin tonë për shkarkimin e ujërave të zeza (nga qyteti i Shëngjinit) | *** |

| Problemi | Shkaku | Ndikimi | Popullsia qe preket | Shkalla e ndikimit | Prioritarizmi |
|---|---|---|---|---|---|
| 3. Dëmtimi formacioneve e drurëve pyjor dhe përkeqësimi i habitateve. | a. Prerjet pa kriter dhe të paligjshme në pyje<br>b. Kullotja pa kriter dhe intensive, veçanërisht në shpatet në afërsi të zonave urbane.<br>c. Zhvillimi kaotik urban, zënia e tokës nga ndërtimet në ekonomitë pyjore pa kriter e pa studime<br>e. Shfrytëzimi i burimeve natyrore (guroret) pa një strategji përkatëse, duke dëmtuar vlera floristike e faunistike të rëndësishme si në malin e Kakarriqit. | a+b. Dëmtimi i vegjetacionit drunor dhe shkurror në të dy anët e lumit Drin dhe në shpatet e zonës ujëmbledhëse te Drinit; i pishës në Velë, si dhe i pjesës më të madhe të shkurretave të shpateve malore të zonës në studim Varfërimi i vegjetacionit nga kullotja intensive, veçanërisht në afërsi të zonave urbane.<br>d. Dëmtimi i pyllit me pishë të mbjellë nga ndërtimet në malin e Shëngjinit etj.<br>e. Dëmtimet e shkurretave e drurëve në malin e Kakarriqit nga guroret. | Popullsia e qytetit Lezhë, si dhe e komunave Mabë, Kallmet, Balldre e Shëngjin | E lartë | *** |
| 4. Erozioni, Erozioni bregdetar | a. Rritja e erozionit, veçanërisht në shpatet e taracuara<br>b. Dëmtimi dhe amortizimi i veprave mbrojtëse në ekonomitë pyjore, pendave e digave<br>c. Mungesa e investimeve për rehabilitimin e veprave pyjore mbrojtëse ekzistuese dhe për ndërtimin e atyre të rejave.<br>d. Mungea e pyllëzimeve mbrojtese për erozionin.<br>e. Intensiteti i lartë dhe agresiviteti i erozionit bregdetar e mungesa e investimeve për ketë qëllim për mbrojtjen e bregdetit. | Erodimi i tokave të shpateve (të zonës në projekt).<br>Gryka e Matkeqes që lidh detin Adriatik me lagunën Vain mbetet pjesën më të madhe të kohës e bllokuar.<br>Jane dëmtuar pjesa më e madhe e veprave pyjore mbrojtëse ekzistuese e janë krijuar dëmtime e shkarje që kanë nevojë për vepra të reja.<br>Humbet mesatarisht në vit 2,5 m tokë me formacion pyjor në një gjatësi 3-4 km vijë bregdetare në Kune-Vain nga erozioni bregdetar. | | E lartë (sepse erozioni është 10 herë më e lartë se mesatarja e Republikës, influencon fuqishëm dhe në përmbytje nga rritja e sedimenteve në sistemin kullues e lumin Drin që nuk përfundojnë në det. | *** |

### V.4.7. Ndërveprimi më çeshtjet e tjera të marra në shqyrtim

Çështja e biodiversitetit është e lidhur me çështjen e pyjeve dhe vlerësohet dhe me indikatorin e këtij të fundit "humbja e habitateve". Dëmtimi i pyjeve dhe shkurretave është dëmtim habitati dhe shkakton varfërim të biodiversitetit e anasjelltas.

Kjo çështje lidhet dhe direkt me problemin e mbetjeve dhe ujërave të zeza, sepse ndotjet e ujërave varfërojnë biodiversitetin. Larmia biologjike lidhet drejtpërdrejt me çështjen e turizmit. Lezha është një rreth me destinacion turistik dhe arsyeja është pikërisht larmia natyrore dhe biologjike. Humbja apo varfërimi i tyre do të sillte rënien e tërheqjes turistike.

Përsa i përket problemeve të erozionit në pyje, mund themi se janë shkaku kryesor i përmbytjeve në zonën e Lezhës, pasi kjo ka çuar në mbushjen e shtratit të lumit Drin me inertet nga erodimi e favorizimin e përmbytjes. Po kështu, mungesa e brezave pyjor mbrojtës, në të dy anët e lumit, rrit fuqinë përmbytëse të këtij të fundit.

### V.4.8. Çfarë po bëhet

Ka filluar realizimi i komponentit të monitorimit e menaxhimit mjedisor, i mbështetur nga Banka Botërore, për Kune-Vainin, në kuadrin e projektit "Menaxhimi i integruar i ujërave dhe ekosistemit", i cili synon realizimin e zbatimin e një plani menaxhimi për Kune-Vainin, për një zhvillim të qëndrueshëm në favor të mbrojtjes e zhvillimit të vlerave natyrore të kësaj zone.

Pritet të fillojë një projekt, i cili synon trajtimin e ujërave të zeza të qytetit të Lezhës e Shëngjinit, nëpërmjet krijimit të ligatinave artificiale në afërsi të liqenit të Knallës, mbështetur nga Banka Botërore.

Mbi 80 % e sipërfaqes së zonës së mbrojtur Kune Vain, në mënyrë të kundërligjshme, u është njohur e kthyer si pronë personave të ndryshëm, gjë që vështirëson dhe e bën pothuajse të pamundur realizimin e një plani menaxhimi të përshtatshëm për një zhvillim të qëndrueshëm.

Në brendësi të zonave të mbrojtura janë ndërtuar, në mënyrë të kundërligjshme, mjaft lokale, motele, banesa e vila, duke i degraduar në mënyrë ekstreme vlerat natyrore të trashëguara të zonës.

Janë realizuar vetëm projekte që kanë të bëjnë me thellime në aksin e lumit veçanërisht në grykëderdhje, që i konsiderojmë të pasuksesshme.

## V.5. Dinamika njerëzore dhe përdorimi i territorit

### V.5.1. Analizë e përgjithshme e gjendjes

Zona në studim përfshin 20 njësi administrative (megjithëse jo në terma absolute), siç tregohen dhe në tabelën më poshtë. Zona e Lezhës përfshin 1 bashki dhe 9 komuna, zona e Shkodrës përfshin 2 bashki dhe 8 komuna.

*Tabela 4. Ndryshimi i popullsisë sipas Regjistrit Civil dhe parashikimi i popullsisë për 2020 të llogaritura nga projekti EPTISA*

| Njësitë administrative | Viti 2003 | Viti 2005 | Projektimi për 2020 |
|---|---|---|---|
| Bashkia Shkodër | 108.994 | 110.181 | 138.433 |
| Bashkia Lezhë | 23.476 | 24.668 | 42.203 |
| Komuna Bushat | 17.087 | 17.332 | 35.542 |
| Komuna Shënkoll | 12.757 | 13.216 | 19.732 |
| Bashkia Vau i Dejës | 12.296 | 12.010 | 20.266 |
| Komuna Guri i Zi | 11.730 | 11.669 | 15.202 |
| Komuna Shëngjin | 10.120 | 10.206 | 28.767 |
| Komuna Balldre | 9.939 | 9.974 | 15.316 |
| Komuna Bërdicë | 9.123 | 9.144 | 12.911 |
| Komuna Dajç | 8.520 | 8.558 | 14.584 |
| Komuna Zejmen | 8.343 | 8.642 | 9.263 |
| Komuna Velipojë | 7.953 | 8.261 | 10.132 |
| Komuna Dajç | 7.011 | 7.075 | 14.584 |
| Komuna Kallmet | 6.614 | 6.628 | 7.596 |
| Komuna Ana e Malit | 6.301 | 6.250 | 6.128 |
| Komuna Hajmel | 6.094 | 6.122 | 4.257 |
| Komuna Kolsh | 5.827 | 6.206 | 7.997 |
| Komuna Blinisht | 5.189 | 5.220 | 5.979 |
| Komuna Barbullush | 4.759 | 4.818 | Nuk ka të dhëna |
| Komuna Mnel-Vig | 3.452 | 3.249 | 4.565 |

Siç vihet re nga të dhënat statistikore, ka një ndryshim të lartë ndërmjet viteve 2001 dhe 2004. Sipas autoriteteve vendore, të dhënat e vitit 2001 ishin paraqitur shumë të ulta. Nëse të dhënat e 2004 janë të besueshme, kjo krijon një ndryshim shumë të dukshëm ndërmjet 2001 dhe 2004. Megjithatë për dhënien e projektimit është marrë në konsideratë ndryshimi i bërë për 14 vjet (1990-2004).

Ky lloj projektimi duhet trajtuar me kujdes. Është e vështirë (në praktikë e pamundur) që të bësh një projektim të numrit të popullsisë, i cili të japë përfundime të vërteta. Këto ndryshime do të varen nga faktorë të paditur, veçanërisht a) si do të zhvillohet ekonomia (sepse popullsia do të ndjekë tregun e punës) dhe b) sa të suksesshme do të jenë qëllimet e politikave. Zakonisht ndryshimi i popullsisë varet nga mundësia për të patur tokë.

Si rezultat i mungesës së burimeve të qëndrueshme ekonomike dhe mungesës së shërbimeve të ndryshme, popullsia priret të lëvizë jashtë zonave rurale për në ato urbane. Tendenca për të migruar është e lartë në zonat malore, më e ulët në ato kodrinore dhe më e qëndrueshme në bashkinë e Shkodrës.

Përveç Bashkisë Shkodër asnjë nga njësitë e tjera nuk ka një plan rregullues. Mungesa e këtyre plan-

eve ka çuar, për pasojë, në ndërtime kaotike në të gjithë territorin dhe në një mënyrë të tillë që rrisin koston e shpërndarjes së shërbimeve (shëndetësore, edukimit, rrugëve, sistemeve të ujit të pijshëm dhe ujrave të zeza, etj.). Gjendja është e atillë sa e bën pothuajse të pamundur futjen e këtyre shërbimeve. Shpërndarja e ndërtimeve pa kontroll rrezikon fragmentarizimin e tokës bujqësore dhe dëmtimin e burimeve natyrore, si dhe të nëntokës për shkak të derdhjes së ujërave të zeza nga gropat septike. Të gjithë këto rreziqe mund të shkaktojnë probleme të mëdha për ujërat nëntokësore.

**V.5.1.1 Kërkesa për tokë**

Bazuar në rritjen e popullsisë është bërë një analizë e kërkesës për tokë bujqësore si në tabelën mëposhtë.

*Tabela 5. Kërkesa për toka (përllogaritje)*

| Zona | Rritja e popullsisë deri në 2020 | Kërkesa për tokë (Ha) |
|---|---|---|
| Qyteti Shkodër dhe zona përreth | 33647 | 70,1 |
| Komuna Bushat | 18250 | 38,0 |
| Komuna Velipojë | 19440 | 40,5 |
| Komuna Shëngjin | 18561 | 38,7 |
| Bashkia Vau Dejes | 4835 | 10,1 |
| Korridori i Lezhës* | 42825 | 89,2 |
| Qyteti Lezhë | 17535 | 36,5 |

** Në korridorin e Lezhës përfshihen komunat Balldren, Kolsh, Kallmet, Blinisht, Shënkoll, Zejmen, Laç, Milot, Mamurras, dhe Fushëkuqe*

Megjithatë disa nga këto kërkesa duhen plotësuar me rikuperimin e tokës së braktisur dhe me mbushjen e rregullt të tokave ndërmjet ndërtimeve të tanishme. Nëse bëhet një program efiçient për këtë qëllim, 5 % e kësaj kërkese mund të përmbushet në këtë mënyrë.

**V.5.1.2 Punësimi**

Bazuar në të dhënat nga autoritetet e Qarkut, struktura e punësimit në zonën e mbuluar nga studimi është si në tabelën më poshtë.

*Tabela 6. Punësimi sipas sektorëve.*
*Të vetëpunësuarit (në bujqësi ose të paregjistruar) nuk jepen në këtë tabelë.*

| Sektori i punësimit | Zona e Shkodrës | Zona e Lezhës |
|---|---|---|
| Sektori qeveritar | 70 % | 50 % |
| Sektori provat (jobujqësor) | 30 % | 50 % |

Ekzistenca e sektorit informal, e cila konsiderohet si punë e zezë, e shoqëruar nga vetëpunësimi në bujqësi, e bën të vështirë llogaritjen e shkallës së papunësisë. Vetëpunësimi në bujqësi, veçanërisht në zonat rurale, kontribuon në një rritje false të punësimit, i cili nuk ndikon në përmirësimin e cilësisë së jetës.

**V.5.1.3 Sistemi i ujit të pijshëm dhe burimet e reja të ujit**

*1.3.1 Zona e Lezhës*

Rrjedhjet ujore kryesore, që formojnë rrjetin hidrografik të Lezhës, janë: lumi Drin i Lezhës dhe lumi Gjadër (me sipërfaqe të pellgut 188 km$^2$, me lartësi deri 422 m mbi nivelin e detit, me prurje 8,00 m$^3$/

sek., si dhe përroi i Manatisë, në komunën Kolsh, Përroi i Vomës, në Kalivaç, komuna Ungrej)

Ky pellg përfshin zonën Shëngjin-Zadrimë-Bregu i Matit dhe furnizon me ujë të pijshëm qytetin e Lezhës dhe Shëngjinit, si edhe të gjithë fshatrat e fushës. Sasia e ujit të shfrytëzuar prej tij, përfshi edhe ujin teknologjik, është 400 l/sek. Ujësjellësit kryesorë janë ai i Barbullojës dhe i Rrilës. Zona e ushqimit është kryesisht bregu i lumit Mat në jug. Rezervat ujore të llogaritura janë rreth 2500 l/sek. Në këtë fushë janë shpuar shumë puse, të cilët me vetërrjedhje japin prurje nga 10-60 l/sek. Por këto ujëra përdoren edhe për vaditjen e tokës bujqësore apo për t'a përzier me ujërat e kripura (afër lagunave) për uljen e kripshmërisë, sidomos kur avullimi në laguna është shumë i madh.

Shfrytëzimi i pandërprerë e në rritje i ujërave nëntokësore, shpesh, krijon çekuilibra hidrodinamike e hidrokimike, si dhe stimulon ndotjen e ujit nga faktorë sipërfaqësorë të veprimtarisë njerëzore.

Pellgu përfshihet në depozitimet ujëmbledhëse zhavorrore me trashësi që rritet në drejtim të lumit Mat, deri në 180-200 m. Ato janë të mbuluar me një mbulesë argjilore dhe subargjilore me trashësi 45-50 m.

Risku i ndotjes sipërfaqësore është i ulët falë mbulesës së trashë ekranizuese, largësisë së zonës së ushqimit dhe karakterit artezian të shtresave ujëmbajtëse.

Nga rezultatet e monitorimit së Kombeve të Bashkuara duket se ujërat e këtij pellgu janë dy tipe, me fortësi të vogël e mineralizim të ulët dhe ujëra me mineralizim të lartë. Tipi i parë takohet në Barbullojë. Nga analizat vërehet se ka rritje graduale të mineralizimit të përgjithshëm të natriumit (Na) dhe klorit (Cl). Në bazë të analizave të kryera për mikroelementë, këto ujëra rezultojne pa përmbajtje të tyre.

Ujërat nëntokësore janë të bollshme në qarkun e Lezhës dhe të shpërndara në pellgun e Lezhës. Ato janë të një cilësie të mirë, por në disa rajone ato njihen pak. Problemet kryesore, që kanë dalë vitet e fundit, janë ato të rrezikut të depërtimit të ujërave të kripur, sidomos si rezultat i mbishfrytëzimit. Rreth 20% e ujërave nëntokësore përdoren për vaditje në bujqësi.

Ruajtja dhe monitorimi i cilësisë së ujërave nëntokësore përbën një domosdoshmëri për të siguruar furnizimin e popullatës me ujë që t'i përgjigjet kërkesave si nga pikëpamja sasiore ashtu dhe cilësore.

Furnizimi i një pjese të konsiderueshme të popullatës me ujë të pijshëm bëhet nga gurra dhe burime. Kjo kryesisht në zonën veri-lindore të Lezhës.

Në rrethin e Lezhës furnizohen me burime dy komuna, përkatësisht Kallmet e Kolsh.

Furnizimi me ujë të pijshëm, brenda dhe jashtë shtëpive, dhe cilësia bakteriologjike, që përmban ky ujë, ndikon drejtpërdrejt në parandalimin e sëmundjeve, kujdesin ndaj shëndetit dhe veprimtarinë e përditshme ekonomike. Lloji i furnizimit është me puse me ngritje mekanike dhe me rrjedhje të lirë.

Në Bashkinë e Lezhës, gjendja e furnizimit me ujë është më afër normales, ka 24 orë ujë (ndërpritet vetëm kur nuk ka energji elektrike ose për defekte në rrjet). Kështu, rreth 38,5 % e njësive ekonomike familjare të rrethit Lezhë janë me ujë brenda në banesë, ndërsa 27,4 % janë me ujë jashtë banese dhe 14,2 % furnizohen me puse ose çisternë. Në rreth 20 % njësi ekonomike familjare mungon furnizimi me ujë, nga këto 90 % njësi ekonomike familjare janë në fshat.

Në zonat urbane, numri i banesave me ujë brenda është 2 herë më i lartë se në zonat rurale, por kjo nuk do të thotë që ato furnizohen me ujë të rrjedhshëm. Numri i banesave me ujë jashtë në zonat rurale është 7 herë më i madh se në zonat urbane.

Gjithashtu, duhet theksuar se popullsia me akses në sistemin sanitar të ujit të pijshëm përbën rreth 29,62 % të popullsisë në zona urbane dhe 20 % në zonë rurale, që mbulohet nga ujësjellësit urbanë apo ruralë, pra 49.62 % e popullsisë.

Pjesa tjetër e popullsisë, që furnizohet me burime natyrore apo shpime të vogla, nuk i ka kushtuar vëmendjen e duhur aksesit në sistemin sanitar të ujit, po kështu dhe vetë institucioni që duhet të merrej me këtë problem.

*Karakteristikë për ujërat nëntokësore, në këtë zonë, janë:*

- Rezervat kryesore të ujit të pijshëm janë të përqendruara në depozitimet e shkrifta kuaternare, lehtësisht të ndotëshme;
- Ato shfrytëzohen me një shpeshtësi të madhe, ç'ka favorizon ndryshimet e shpejta të përbërjes kimike të ujit;
- Ushqimi bazë i tyre janë lumenjtë, ku shkarkohen shpesh mbetjet e veprimtarisë njerëzore.

*Tabela 7. Treguesit kryesore te ujesjellesave*

| Emërtimi i ujësjellësit | Lloji i burimit | Destinacioni | Lloji i sistemit |
|---|---|---|---|
| Bashkia Lezhë | Puse | Ujë i pijshëm | Ngritje mekanike |
| Komuna Shëngjin | Depo | Ujë i pijshëm | Rrjedhje e lirë |
| Komuna Kolsh | Burim | Ujë i pijshëm | Ngritje mekanike |
| Komuna Zejmen | Puse | Ujë i pijshëm | Ngritje mekanike |
| Komuna Shënkoll | Puse | Ujë i pijshëm | Ngritje mekanike |
| Komuna Kallmet | Burime | Ujë i pijshëm | Rrjedhje e lirë |
| Komuna Balldre | Depo | Ujë i pijshëm | Ngritje mekanike |
| Komuna Dajç | Puse | Ujë i pijshëm | Ngritje mekanike |
| Komuna Blinisht | Puse dhe Burime | Ujë i pijshëm | Ngritje mekanike+Rrjedhje e lirë |
| Komuna Ungrej | Nuk ka | Nuk ka | Nuk ka |

Në konkluzion të monitorimit të ujërave sipërfaqësore, vihet re se ato ndoten me ujëra urbane dhe rurale të patrajtuara. Për pasojë, ujërat kanë nevojë të lartë kimike dhe biologjike për oksigjen, amoniak dhe fosfate. Nitratet janë në gjendje persistente në përqëndrime të vogla. Nga ana tjetër, ujërat e monitoruar paraqiten me ngarkesë të lartë të treguesve të ndotjes fekale të ekzaminuar. Vihet re gjithashtu, një tendencë e lehtë rritjeje e të gjithë treguesve, në raport me periudhën 1999-2000.

*1.3.2 Zona e Shkodrës*

Uji për përdorim merret nga ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore. Ky ujë përdoret për ujë të pijshëm, ujitje, industri dhe përdorime të tjera. Vlerësohet se përdorimi kryhet pa kriter, sidomos kur bëhet fjalë për përdorimin e ujërave nëntokësore, gjë që do të sjellë pasoja në regjimin e ujërave në përgjithësi.

Nga informacionet, marrë pranë komunave, (në zonën e projektit, duke përjashtuar bashkinë Shkodër) rreth 10-20% e popullsisë kanë akses në ujësjellës. Kjo presupozon dhe kontrollin sanitar.

Analizat kimike dhe monitorimi i cilësisë ka treguar që lumi i Drinit ka një cilësi të mirë të ujit, me një përbërje minerale të stabilizuar dhe përqendrim të ulët të metaleve. Nuk duhet të kishte kufizime për përdorimet në ujitje ose për qëllime të tjera. Cilësia e ujërave mbitokësore është në përgjithësi e mirë në pjesën malore të basenit. Zonat e tokave të ulëta kanë disa probleme me përzierjet e ujërave të kripura, por kjo nuk është investiguar plotësisht.

Përqindja e popullsisë që ka furnizim me ujë është jo e barabartë në komuna të ndryshme të zonës së konsideruar.

Situata e shërbimit të ujësjellës, si në gjithë vendin, është në gjendje jo të mirë. Rrjeti i ujësjellësit është në gjendje jo të mirë, i vjetëruar, me ndërhyrje abuzive. Problem është përdorimi i ujit të pijshëm nga pompimi direkt në puse të veçanta familjare të cilat janë jashtë kontrollit sanitar. Në përgjithësi, uji i përdorur për konsum familjar është i pijshëm, por ka edhe raste ,si në zonën e komunës Dajç, ku uji ka probleme të prezencës së squfurit.

Duke patur parasysh edhe mungesën e kanalizimeve të ujërave të zeza, problemi është edhe më i rënduar. Pothuajse 80-90 % e nevojave në zonën rurale zgjidhen në këtë mënyrë.

*Tabela 8. Gjendja e ujësjellësve në njësitë lokale të zonës së projektit*

| Nr | Bashkia/Komuna | Nr. i ujësjellësve | Jashtë funksioni |
|---|---|---|---|
| 1 | Shkodër | 1 | Asnjë |
| 2 | Vau i Dejës | 7 | 6 |
| 5 | Bushat | 9 | 8 |
| 6 | Bërdicë | 6 | 5 |
| 7 | Guri i Zi | 3 | 2 |
| 8 | Hajmel | 4 | 1 |
| 9 | Mnel-Vig | Asnjë | Asnjë |
| 10 | Ana e Malit | 5 | 4 |
| 11 | Dajç | 9 | 6 |
| 12 | Velipojë | 1 | 1 |

### V.5.1.4. Mbetjet dhe ujërat e zeza

*V.5.1.4.1 Zona e Lezhës*

*Mbetjet Urbane*

Mbetjet urbane gjenerohen nga burime shtëpiake, administrata shtetërore, sektori i ndërtimit, fabrikat e përpunimit të peshkut apo edhe të birrës, shërbimet e ndryshme etj. Mbetjet e gjeneruara grumbullohen pa asnjë ndarje paraprake, ndërsa problemi rëndohet sa kohë që bashkë me to grumbullohen edhe mbetje të tjera të rrezikshme (p.sh. bateritë, kimikate etj.). Vetëm bashkia Lezhë dhe Komuna Shëngjin e kanë të organizuar grumbullimin dhe transportin e tyre, të paktën formalisht, nëpërmjet ndërmarrjeve të shërbimit të bashkive ose kompanive private të kontraktuara. Zonat rurale, (komunat Blinisht, Dajç, Balldre, Kallmet, Ungrej, Zejmen, Shënkoll, Kolsh) ende nuk mbulohen me asnjë lloj shërbimi për grumbullimin apo transportin e mbetjeve, çfarë është mjaft e domosdoshme për t'u ngritur dhe organizuar në të ardhmen.

Zhvillimi i turizmit është duke krijuar gjithashtu probleme, kryesisht në menaxhimin e mbetjeve të ngurta në plazhe.

Sasia e mbetjeve urbane për qytetin e Lezhës dhe të Shëngjinit llogaritet në 8760 ton/vit. Mbetjet e ngurta urbane nuk administrohen mbi bazën e kritereve mjedisore. Deri më sot nuk ka asnjë vend depozitimi të mbetjeve urbane të ndërtuar mbi bazën e kritereve mjedisore. Vetë djegia e plehrave është dukuri e zakonshme për pothuajse të gjitha vend-depozitimet e mbetjeve urbane, duke përbërë një burim potencial për lëndë helmuese tepër të rrezikshme, si dioksinat.

Gjatë muajve të verës, numri i banorëve të qytetit të Shëngjinit trefishohet nga turistët. Mbetjet urbane të ngurta për Lezhën janë 22 ton/dite, ndërsa për Shëngjinin 2 ton/ditë. Pika e hedhjes së mbetjeve, për këto dy qytete, është 1,5 km larg nga Lezha dhe është në kushte mjedisore dhe sanitare të papërshtatshme. Një pjesë e mbetjeve urbane, përfshi ato inerte nga ndërtimet dhe prishjet, hidhen përgjatë lumit Drin ose në liqenin e Knallës.

Aktivitetet ekonomike, në qytetin e Lezhës, aktiviteti bujqësor intensiv, i zhvilluar në zonën aluviale, si dhe rritja progresive e popullsisë dhe ndërtimet e ardhshme përfaqësojnë rrezik potencial për ekuilibrin natyror dhe për ruajtjen e biodiversitetit dhe ekosistemeve ujore.

Si rrjedhojë, rajoni po përballet me një situatë të pakëndshme sa i përket administrimit të mbetjeve jo vetëm në qytete, fshatra dhe rrugë, por edhe në fushat e hedhjes së tyre.

Përbërësit më të rëndësishëm të mbeturinave janë: ushqimore (që zenë mbi 45%), letra, xhama, metale, tekstile, plastmas, gurë dhe dru.

Sasi të konsiderueshme mbetjesh urbane janë depozituar në pjesët anësore të rrugëve, duke mbushur kanalet kulluese jo vetëm me to, por, në disa raste, edhe me mbetje të rrezikshme.

Problemi kryesor mjedisor i vendhedhjeve të mbetjeve urbane janë zjarret, të cilat përbëjnë një burim të fuqishëm të ndotjes së ajrit me dioksinë, etj. që është një nga kimikatet më toksike. Zjarret janë të qëllimshëm, në pjesën më të madhe për të lehtësuar procesin e marrjes së ambalazheve të aluminit, nga një numër banorësh që jetojnë me këtë aktivitet, ose për shkak të fenomenit të vetëdjegies nga mungesa e kryerjes së procesit të përpunimit të mbetjeve me mjetet e duhura, pasi nuk ka një teknologji të përcaktuar.

Hyrja në vendet e hedhjeve e mbeturinave është e mundur si për njerëzit apo bagëtitë, duke rritur artificialisht shkallën e ekspozimit të drejtpërdrejtë ndaj rrezikut për shëndetin. Në këto vende të hedhjes ka mungesa të theksuara për mjetet e nevojshme dhe fuqi punëtore, si edhe fonde të pamjaftueshme për menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane apo dhe mosmenaxhim eficent i fondeve ekzistuese.

Venddepozitimet janë teknologjia më e përshtatshme për rajonin e Lezhës për një sërë arsyesh:

- disponohet tokë e përshtatshme me përbërje gëlqerore që mund të jetë e gatshme për ndërtimin e fushave sanitare të grumbullimit.
- ndërtimi i venddepozitimeve të përshtatshme është edhe mënyra më ekologjike për përpunimin dhe menaxhimin e mbetjeve.
- tarifa e përpunimit është mjaft e ulët 23-29 USD /ton dhe kostoja e ndërtimit të një venddepozitimi është dhjetëra herë më e ulët se ndërtimi i një impianti, 10-15 milionë USD.
- ndikimi në mjedis është minimal.

- në rajonin e Lezhës mund të gjenden lehtësisht toka të shkreta për ndërtimin e vendgroposjeve të kontrolluara.

*Sistemi i ujërave të zeza*

Ujërat e ndotura urbane shkarkojnë në ujërat sipërfaqësore 98% të NBO (Nevojës Biologjike për Oksigjen) dhe të gjithë ndotësve të tjerë, përveç vajrave dhe yndyrës, që shkarkohen nga kompanitë e përpunimit të peshkut (20 $m^3$/ditë), megjithëse dy nga tre fabrikat e përpunimit kanë vendosur impiante për trajtimin e ujërave teknologjike.

Sasia e ujërave të zeza, që respektivisht derdhet nga qytetet e Lezhës dhe Shëngjinit, është 1150 $m^3$/ditë dhe 380 $m^3$/ditë. Lezha i shkarkon ujërat në Drin, ndërsa qyteti i Shëngjinit i shkarkon në liqenin e Knallës, në afërsi të Kune-Vainit.

Përbërja e ujërave të zeza të Lezhës është tipike për shkarkime të këtij lloji, por ngarkesa organike dhe lëndët ushqyese janë në nivele më të ulëta se ato të vendeve të tjera evropiane: COD = 168-240mg/l; BOD=70-118mg/l; TDS=0,36-0,77gr/l; SS=50-346 mg/l; P-total=2,4-22,5mg/l; N-total=16,04-34,2mg/l dhe Total koliform =431,000-17,900,000.

Po e njëjta gjendje është edhe për shkarkimet e qytetit të Shëngjinit: COD=160-164mg/l; BOD=66-67mg/l; TDS=0,375-0,8gr/l; SS=28-102mg/l; P-total=12,2-13,75mg/l; N-total=20,14-28,5 mg/l.

Duhet theksuar, gjithashtu, që zona natyrore e liqenit të Knallës përbëhet nga një rrjedhje natyrore e ujërave karstike, që e kanë zanafillën nga maja e kodrës dhe përfundojnë në lagunë. Kjo është një sipërfaqe ujore kalimtare, e ndotur nga shkarkimet direkte të ujërave të zeza, që vijnë nga qyteti i Shëngjinit. Si rezultat i këtyre ndotjeve është i pranishëm edhe rreziku për jetën e organizmave detare, pasi preket direkt riprodhimi i llojeve.

*Tabela 9. Ndotësit e lëngët të llogaritur për rrethin e Lezhës:*

| NBO5 t/v | Nt t/v | Pt t/v | Vaj dhe Yndyre t/v | Pb. Kg/v | Cd Kg/v | 9PAH kg/v | PAH [B(a)P] kg/v |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.529,4 | 246,3 | 27,3 | 4,73 | 30,74 | 3,42 | 0,376 | 0,00028 |

Gjatë studimit, në afërsi të grykëderdhjes së Drinit janë hasur nivele të larta të lëndëve organike (proteina 61%, karbohidrate 34%, lipide 5%) vlera këto që janë 3,5 herë më të larta se po të njëjtat parametra të matura në zona ku nuk ka aktivitet njerëzor. Gjithashtu, në këto zona janë matur vlera të larta të pigmenteve aktive fotosintetike (0,94 mg/m). Biomasa bakteriale dhe densiteti i tyre në sedimente ishin brenda normave me vlera më të larta në afërsi të qyteteve, derdhjeve të lumenjve dhe në porte.

Përsa i përket gjendjes së sistemit të ujërave të zeza në zonat rurale, duhet theksuar se ai nuk ka fare infrastrukturë dhe se në masen 90% ky sistem është me gropa septike apo në qendra të vogla, që derdhen në perrenj apo kanale, aty ku kanë mundësi.

Problem mbetet pjesa fushore, ku niveli i ujërave nëntokësore është i lartë, (sidomos pjesa afër kënetave) dhe sistemi i këtyre ujërave del në sipërfaqe pas ngopjes së tokes apo pas shirave të rënë.

Prandaj kërkohet një studim i detajuar që të jetë i aplikueshëm dhe t'i përshtatet terrenit ku zbatohet.

*V.5.1.4.1 Zona e Shkodrës*

Gjendja e kanalizimeve të ujërave të zeza është më e rënduar se ajo e furnizimit me ujë të pijshëm.

Pa përjashtim, në të gjitha komunat e përfshira nuk ka një rrjet të KUZ, përveç ndonjë rasti, si në komunat Ana e Malit dhe Dajç, ku, në masën 5-10 %, ka sistem kanalizimi të ujërave të zeza, por që, në përgjithësi, ose derdhen në kolektorë të hapur dhe pastaj në rrjedhjet më të afërta (në rastin konkret Drini e Buna) ose në gropa të mëdha të përbashkëta me pasoja në ndotjen e mjedisit.

*Tabela 10. KUZ sipas njësive lokale*
*Gjendja e KUZ në Bashkitë dhe Komunat e zonës të marrë në studim*

| Nr | Bashkia/Komuna | KUZ, km | Të parikon-struktu-ara km | Investime KUZ për vitin 2004 (000 lekë) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Shkodër | 148 | 148 | 10.283 |
| 2 | Vau i Dejës | 0 | 0 | 0 |
| 3 | Bushat | 8 | 0 | 4.000 |
| 4 | Bërdicë | 0 | 0 | 300 |
| 5 | Guri i Zi | 0 | 0 | 0 |
| 6 | Hajmel | 0 | 0 | 0 |
| 7 | Mnel-Vig | 0 | 0 | 0 |
| 8 | Ana e Malit | 7 | 7 | 0 |
| 9 | Dajç | 1,5 | 1,5 | 0 |
| 10 | Velipojë | 0 | 0 | 0 |

*Burimi: Nga informacionet e përgjithshme nga çdo njësi lokale, pranë Qarkut Skodër, Janar 2005*

Siç shihet dhe nga statistika, në shumicën e zonave rurale nuk ekzistojnë kanaliimet e ujërave të zeza. Edhe aty ku ato ekzistojnë, derdhja e tyre bëhet e papërpunuar në përrenjtë pranë vendbanimeve duke sjellë, në periudhën e sezonit të ngrohtë, problematika serioze në ndotjen e mjedisit dhe ndikim në shëndetin e komunitetit.

Si emergjencë, del që, me bërjen e planeve rregullues, të ketë zgjidhje dhe sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza.

**V.5.1.4.1.1 Për bashkinë Shkodër**

*Kanalizimi i ujërave të zeza*

*Tabela 11. Gjendja e kanalizimeve të ujrave të zeza në Bashkinë e Shkodrës*

| Emërtimi | Njësia e matjes | Vitet | | |
|---|---|---|---|---|
| | | 2001 | 2002 | 2003 |
| Kanale gjithsej | km | 248,5 | 248,5 | 248,5 |
| A Të ujërave të zeza | km | 149 | 149 | 149 |
| a. Me tuba deri në ø 300 | " | 127,4 | 127,4 | 127,4 |
| b. Me tuba më të mëdhenj se ø 300 | " | 21,6 | 21,6 | 21,6 |

Rrjeti i KUZ, në Bashkinë Shkodër, përbëhet nga 138 km kanalizime dytësore, 10,5 km kolektorë kryesorë dhe 6000 puseta. Largimi kryhet nëpërmjet pompave me kapacitet maksimal prej 650 l/sek.

Ujërat e zeza, nga sekondarët, kalojnë në kolektorët kryesorë, për t'u mbledhur në rezervuarin që ndodhet në hyrje të qytetit. Nga ky rezervuar bëhet pompimi i tyre për në lumin Drin. Problematike është mungesa e energjisë elektrike, e cila ka shkaktuar shpesh anomali duke bërë që derdhja e ujërave të zeza të bëhet në liqenin e Shkodrës, me derdhje të lirë e të papërpunuara. Ekzistojnë dy pika të tilla në liqenin e Shkodrës.

Rreth 35% e zonës përdorin gropa septike, ndërsa 65 % janë të lidhur në rrjetin e kanalizimeve, por që është shumë i amortizuar.

Dy lagjet turistike të qytetit të Shkodrës, Shiroka dhe Zogaj, nuk kanë kanalizime të ujërave të zeza.

Në përgjithësi, është zbatuar projekti i KUZ i viteve 70-80. Ndërkohë që është në fazën e përgatitjes projekti i plotë i fizibilitetit me financim të qeverisë austriake. Problematike mbeten ndërtimet abuzive dhe zgjerimi i zonave informale. Si një veprim me ndikim pozitiv shikohet edhe zgjidhja e grumbullimit dhe derdhjes se ujrave te bardha. Ndikimi i tyre negativ ndihet me bllokimin e pusetave te KUZ dhe

krijimit të presioneve në mënyrë artificiale, që shkakton daljen e ujërave të zeza deri në sipërfaqe, pa përmendur ndotjen e ujërave nëntokësore.

*Mbetjet*

*Tabela 12. Gjendja e fushave të grumbullimit në zonën e marre në studim*

| Nr | Bashkia/Komuna | Vendgrubullimi i mbetjeve |
|---|---|---|
| 1 | Shkodër | Problematik |
| 2 | Vau i Dejës | Jo |
| 5 | Bushat | Jo |
| 6 | Bërdicë | Jo |
| 7 | Guri i Zi | Jo |
| 8 | Hajmel | Jo |
| 9 | Mnel-Vig | Jo |
| 10 | Ana e Malit | Jo |
| 11 | Dajç | Jo |
| 12 | Velipojë | Jo |

Asnjë nga njësitë lokale, përveç Bashkisë Shkodër, nuk ka një vend grumbullimi për mbetjet e ngurta dhe aq më pak përpunim të tyre.

Mbetjet hidhen në shtretërit e lumenjve dhe të përrenjve në mënyrë të shpërndarë.

Tani, është në studim zona e hedhjes dhe e përpunimit të mbetjeve për Bashkinë Shkodër dhe komunën e Bushatit, në bashkëpunim dhe me financim të huaj.

*Për bashkinë Shkodër*

- Sasia ditore e mbetjeve urbane 100-110 ton/ditë;
- Mungon sheshi i kontrolluar për depozitimin e mbetjeve urbane;
- Djegia e mbetjeve përbën rrezik serioz për qytetin;
- Duhet të merren masa për sigurimin e mjeteve financiare për zbatimin e projektit të venddepozitimit të kontrolluar të mbetjeve urbane në zonën e ish repartit ushtarak, në kuadër të programit LIFE të Komunitetit Evropian;
- Nuk bëhet tërheqja e mbetjeve urbane në zonën Shirokë – Zogaj, megjithëse konsiderohen si lagje të qytetit të Shkodrës.

Zgjidhja e problemit të vendit të grumbullimit dhe përpunimit të mbetjeve për bashkinë është aksioni më emergjent. Mënyra e përpunimit dhe kohëzgjatja janë probleme që do t'i zgjidhë projekti i përmendur më lart.

Financimi i projektit dhe vazhdimësia e tij janë probleme që duhet të parashikohen nga buxhetet shtetërore, në bashkëpunim me ato të njësive vendore.

### V.5.2. Lista e problemeve

Dinamika njerëzore dhe zhvillimi hapësinor

| Problemi | Shkaku | Shkalla e ndikimit | Popullsia që preket | Ndikimi | Prioritarizimi |
|---|---|---|---|---|---|
| 1- Lëvizja e pakontrolluar dhe migrim masiv, nga zonat rurale në ato urbane | - Kushte ekonomike të vështira dhe mungesa imediate të jetës normale.<br><br>-Moszbatim i plotë i ligjit për shpërndarjen e tokës bujqësore<br><br>- Mungesë e politikave të qarta lehtësuese për zhvillimin e agrobiznesit, që do të nxiste moslargimin nga këto zona.<br><br>-Mungesa e një planifikimi urban në perspektivat e zhvillimit.<br><br>-Fragmentizim i tokës dhe pamundësia e përdorimit të saj<br><br>-Tradicionalisht zonat urbane shihen si mundësi për një nivel më të lartë jetese | E mesme (Zona e projektit, në rreth 70% të saj, i takon një zone relativisht me të ardhura më të mira se pjesa tjetër e Qarkut Shkodër) | 100%<br><br>Rreth 197000 banorë të Bashkive dhe komunave përfshirë në projekt | - Mbipopullim i zonave të veçanta të paparashikuara<br>-Infrastrukturë e pamjaftueshme (rrugore, shëndetësore, edukuese, shërbimeve të ujësjellësit e kanalizimeve etj) për ritmet e lëvizjes, gjë që sjell përshpejtimin e degradimit të tyre.<br>-Ndikim negativ në mjedis, meqënëse rriten, në mënyrë të pakontrolluar dhe të paparashikuar, ndotjet urbane, ato të ujërave të zeza, ashtu edhe ato të ngurta<br>-Rritje e papunësisë në zonat urbane<br>Rritje e abuzivitetit në ndërtime dhe probleme pronësie<br>-Çoroditje e besimit të popullatës për gjetjen e shërbimeve të duhura.<br>-Në një farë mase dhe rënie e sigurisë publike<br>- Mungesë e informacionit të saktë mbi madhësinë e popullsisë që pengon ne marrjen e masave për ndryshimin e situatës por dhe krijon mundësinë e parashikimeve të gabuara | Shumë i rëndësishëm (kërkon zgjidhje të menjëhershme |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 2- Ndërtime pa plan dhe ndryshim i destinacionit i tokës nga bujqësore në truall pa kritetre të studiuara. Nevoja për truall, për ndërtimin e banesave, ka sjellë që të shpërdorohet toka bujqësore dhe sidomos përgjatë rrugëve. | -Mungesë e planeve lokale rregullues, ku përfshihen përcaktimi i vijave të verdha<br><br>- Mungesë e planeve për zgjerimin e zonave të banuara dhe krijimin e të rejave<br><br>- Ritja e kërkesës për hapësira më të mëdha banimi dhe devijimi nga tradita për jetesën e disa brezave së bashku<br><br>-Shkaqe që kanë lidhje me kulturën e komunitetit dhe mendësinë e tyre mbi pronën private | E lartë<br><br>90 % e sipërfaqes së përfshirë në projekt, që përbëhet kryesisht nga zona rurale Është shumë problematike në Zonën turistike të Velipojës<br>- | 100 %<br>Fenomeni është prezent në të gjithë zonën | -Fragmentizim të sipërfaqeve bujqësore me pasojë pengimin e mekanizimit bujqësor<br>-Nxjerrje jashtë përdorimi i sistemit ujitës e kullues<br>- Rritje e ndërtimeve abuzive dhe shtim i zonave informale<br>-Rritje e kostos të ndërtimit dhe mirëmbajtjes të ujësjellësit, KUZ, furnizimit me energji elektike, pastrimit, etj<br>-Në shumicën e rasteve është krejtësisht e pamundur ofrimi i këtyre shërbimeve duke rritur ndikimin negativ në mjedis<br>-Rritje e shpenzimeve për banorët për të patur akses në shërbime jetësore si shëndetësore, të edukimit, e argëtimit , etj.<br>-Rrit braktisjen e shkollës<br>-Shton papunësinë e pjesës së gjinisë femërore të popullsisë<br>-Krijon probleme sociale | Shume i rëndësishëm Kërkon zgjidhje të studiuara dhe në kohë optimale |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 3- Strukturë punësimi jo e përshtatshme, me përqindje relativisht të lartë në sistemin shtetëror krahasuar me atë privat dhe ritme punësimi të ulëta | -Mungesë dhe parregullsia e furnizimit me energji elektrike<br>-Shkëmbim i pakët ekonomik me rajonin megjithëse mundësitë gjeografike ekzistojnë.<br>- Infrastrukturë rrugore e pamjaftueshme për nxitjen e biznesit<br>- Mungesë e masave nxitëse për biznesin, që për zonën duhet të jenë më specifike dhe jo të njehsuara me masat në nivel kombëtar. | E lartë | 59 %<br><br>( Rreth 120000 banorë ) | - Ritje e nivelit të varfërisë shoqëruar me uljen e të ardhurave<br><br>-Rëndim i skemës së ndihmës ekonomike.<br><br>-Fryrje artificiale e administratës publike.<br><br>-Rritje e emigracionit sidomos të forcave aktive për punë. | Shumë i rëndësishëm<br><br>(Kërkon marrjen e masave të menjëhershme) |
| 4- Menaxhim i pastudiuar me pasojë dëmtimin e rezervave ujore sidomos i ujrave nëntokësore | - Rritja e kërkesës për konsum të ujit për përdorim shtëpiak dhe për biznes<br>-Mungesë infrastrukture për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë<br>- Mungesa e studimeve në përputhje me lëvizjet e popullsisë.<br>-Trashëgimi e varfër në infrastrukturë të furnizimit me ujë<br>-Mungon sensibilizimi për pasojat që sjell përdorimi pa kriter i kësaj pasurie | E mesme<br>Pasi nuk është fenomen i përgjithshëm<br><br>Dëmtim i pariparueshëm ekologjik | 70 % e zonës së projektit | -Në shëndetin e popullatës pasi përdorimi i ujit të pijshëm me anë të shpimeve është jashtë kontrollit sanitar dhe mundësia e përpunimit të ujit në këto raste është zero<br><br>-Në mjedis, pasi prish ekuilibrat natyror | I rëndësishëm<br><br>( Në kuadrin e zhvillimit të qëndrueshëm) |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 5- Mungesa e sistemeve të organizuara të furnizimit me ujë dhe mënyra e menaxhimit të tyre. | - Tradicionalisht duke qenë vend i pasur në ujëra, domosdoshmëria e ndërtimit të sistemeve të furnizimit me ujë nuk është vlerësuar.<br><br>- Zgjerimi dhe krijimi i zonave informale si rezultat i lëvizjes së popullsisë.<br><br>- Mungesë e plotë e planeve urbane, për zonat rurale ku parashikohet edhe ndërtimi i këtyre sistemeve<br><br>- Mungesa e fondeve të nevojshme për ndërtimin e sistemeve të furnizimit me ujë.<br><br>-Decentralizimi i pamjaftueshëm i ofrimit të këtij shërbimi | I larte | 90 % e popullsisë së zonës rurale në zonën e projektit | - Rrit shpenzimet për sigurimin e ujit të pijshëm dhe për përdorim tjetër.<br><br>-Rrit mundësinë e rritjes së rrezikut të përdorimit të ujit të kontrolluar nga ana sanitare<br><br>- Probleme sociale brenda familjeve<br><br>- Ndikon në frenimin e zhvillimit të bizneseve<br><br>- Ndikon në cilësinë e ofrimit të shërbimit shëndetësor pranë qendrave shëndetësore e spitaleve | Shumë i rëndësishëm |
| 6- Mungesë kontrolli konseguent në analizimin e ujit të pijshëm | - kompetenca të paqarta në menaxhimin e problemit<br><br>-sisteme të paunifikuara dhe shpesh personale që vështirësojnë mbulimin me këtë shërbim<br><br>- Tradicionalisht uji është konsideruar i pastër | I mesëm<br>Sepse deri tani nuk ka paraqitur probleme,<br>por përbën rrezikshmëri në një të ardhme jo të largët duke patur parasysh ndotjet | 70 % e popullsisë | -Rrit probabilitetin e përhapjes së sëmundjeve me ndikim në shëndetin e komunitetit | Kërkon zgjidhje |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 7 - Stabiliteti dhe siguria të paqëndrueshme | - mungesa e stabilitetit politik<br>- mungesë e një konkurence të ndershme<br>- moszbatim korrekt i ligjit | - pasiguri në investime<br>- evazion fiskal i lartë<br>- rritje e varfërisë | E gjithë zona në studim | Ndikon në vazhdimësinë e projekteve dhe reformave<br>Ul ndjeshëm motivimin dhe angazhimin e aktorëve në nismat rajonale dhe lokale | * * * |
| 8 - Mungon një strategji për integrimin e mbrojtjes së mjedisit në programet mësimore | - mungesë koordinimi ndërdikasterial dhe mungesë e studimeve integruese | E mesme | E gjithë zona në studim | - administrim i paqëndrueshëm i mjedisit<br>- rënie e vlerave estetike<br>- ulje e mirëqenies<br>- mospjesëmarrje e publikut në trajtimin e problemeve mjedisore | * * * |

Mbetjet Urbane dhe Ujërat e Zeza

| Problemi | Shkaku | Shkalla e ndikimit | Popullsia që preket | Ndikimi | Prioritarizimi |
|---|---|---|---|---|---|
| 1- Mbetjet urbane grumbullohen në vende të hapura, të papërpunuara dhe pranë qendrave të banuara | -Rritja e dendësisë së popullsisë sidomos pranë zonës bregdetare<br><br>- Ritje e konsumit<br><br>- Mungesa e planeve të përgjithshëm për përcaktimin e vendeve.<br><br>- Probleme të pronësisë mbi tokën dhe pamundësia e shtetit për zgjidhje të drejtë me anë të kompensimit.<br><br>-Trashëgimi e varfër në menaxhimin e mbetjeve urbane.<br><br>-Kulturë relativisht e varfër e komnitetit<br><br>- Kapacitete jo të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zgjidhjen e problemit<br>- Mungesë e fondeve për studime | E Lartë | 100% e komunitetit | - Në shëndetin e komunitetit duke rritur mundësinë e rritjes së infeksioneve si rezultat i dekompozimit të mbetjeve urbane në pika të hapura , ose edhe spontane<br><br>- Në ndotjen e mjedisit me rrjedhojë ndotjen e ajrit, të ujit, etj<br><br>- Prishje të ekosistemit<br><br>- Ndikim negativ në ekonomi, në zonat turistike menaxhimi i keq i ndotjeve urbane largon turistët. | Shumë i rëndësishëm Kërkon zgjidhje urgjente |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 2- Ndotjet të shkaktuara si rezultat i dëmtimit ose mungesës së kanalizimeve të ujërave të zeza | - Dëmtim i sistemit të ekzistues ujërave të zeza<br><br>- Mungesë totale e rrjetit të kanaleve të ujërave të zeza në pothuajse të gjitha komunat<br><br>- Trashëgimi e varfër në ekzistencën e këtyre sistemeve në zonat rurale.<br><br>-Mungesë totale e fondeve për studime dhe ndërtime të këtyre rrjeteve.<br><br>- Mungesë e planeve të mirëfillta urbane ku të jenë të parashikuara dhe ndërtimi i këtyre sistemeve. | I lartë | E gjithë zona në studim | - Rrit rrezikun e ndotjes së ujërave që përdoren për t'u pirë.<br><br>- Rrit rrezikun për përhapjen e sëmundjeve ngjitëse infektive.<br>- Ndotje e mjedisit<br><br>- Ndotje e ujërave nëntokësore<br><br>- Ndikim negativ në faunë.<br><br>-Prishje pejsazhi natyror dhe ndikim negativ në turizëm | shumë e rëndësishme dhe kërkon zgjidhje sa më parë |

### V.5.3. Ndërveprimi me çështjet e tjera

Dinamika njerëzore dhe përdorimi i territorit në kushtet e sotme, në rajonin e Lezhës, ndikon negativisht në:

- përmbytjet, sepse ndërtimet pa leje mbi kolektorë, mbyllja e kanaleve nga këto ndërtime sjellin probleme serioze për sistemin e kullimit;
- turizmin, sepse e zhvillojnë atë, por ndikojnë edhe negativisht kur ato nuk janë të studiuara;
- pyjet, sepse ndikojnë në pakësimin e mjediseve të gjelbra;
- mbetjet dhe ujërat e zeza, sepse rritet sasia e mbetjeve dhe infrastruktura është e pamjaftueshme në fazën fillestare;
- bujqësinë sepse ndikon në shfrytëzimin më të mirë të tokës për produkte bujqësore ashtu siç rritet edhe kërkesë oferta por ndikon edhe negativisht duke zënë sipërfaqe toke për ndërtime.

Mbetjet dhe ujërat e zeza, në kushtet e sotme, ndikojne negativisht në:

- dinamikën njerëzore dhe përdorimin e territorit sepse një mjedis i ndotur ndikon në shëndetin e popullsisë dhe në largimin e tij;
- turizmin sepse një infrastrukturë jo e mirë sjell ndotje të mjedisit edhe rënie të turizmit;
- peshkimin dhe menaxhimin e tij sepse hedhja e këtyre mbetjeve në det, laguna apo lumenj, sjell probleme serioze me ekuilibrin e ekosistemit; hidrologjinë e rajonit sepse kur vend depozitimet apo hedhja e tyre është e pastudiuar sjell ndotje të ujërave mbitokësore dhe nëntokësore.

### V.5.4. Tendenca e faktorëve kryesorë

Dinamika njerëzore dhe përdorimi i territorit

a. Dinamika njerëzore dhe përdorimi i territorit duket të jetë e qëndrueshme në zonat urbane, ndërkohë vërehet një përkeqësim i shpejtë në zonat rurale;
b. Situata demografike duket e qëndrueshme
c. Migrimi është i qëndrueshëm
d. Në vijën e qeverisjes vendore, punësimi në sektorin shtetëror po ulet, ndërkohë, që ka rritje në atë privat
e. Sistemet e ujit të pijshëm dhe burimet e ujit janë në përkeqësim.

Mbetjet dhe ujërat e zeza

a. Gjendja e sistemit të grumbullimit të mbetjeve (aty ku ka një të tillë) në të gjitha njësitë administrative është në përkeqësim
b. Sistemet e ujërave të zeza janë në përkeqësim
c. Situata e ndarjes së tokës dhe pronësisë mbi të është e qëndrueshme (nuk është bërë akoma progres për zgjidhjen përfundimtare)

### V.5.5. Çfarë po bëhet

Me gjithë ndërgjegjësimin e specialistëve se kjo situatë nuk duhet lënë në këtë gjendje, pasi sjell ndotjen e mjedisit dhe ndikon në zhvillimin e këtij rajoni, përsëri ajo çfarë po bëhet është minimale.

Kështu, vazhdon përsëri lëvizja e pastudiuar e popullsisë, vazhdojnë ndërtimet pa leje dhe në vende të papërshtatshme, mungojnë masterplanet e zhvillimit.

Eshtë në proces një studim për ujërat e zeza të qytetit të Shëngjinit dhe të Lezhës, ndërsa për zonat e tjera rurale as që bëhet fjalë për studime të këtij lloji. Ndërkohë, që ka përpjekje për gjetjen e zonave rajonale të mbetjeve urbane (studimi për zonën e Bushatit).

# V.6. Turizmi

## V.6.1. Analizë e përgjithshme e gjendjes

Turizmi duhet zhvilluar si një sektor prioritar për faktin se ai buron nga vetë pozita gjeografike e rajonit, por gjithashtu edhe pse sjell përparimin ekonomik të këtij rajoni, duke u lidhur ngushtë me zhvillimin edhe të sektorëve të tjerë të ekonomisë si bujqësia, transporti, tregëtia dhe industria.

Aktualisht, produkti turistik konsumohet vetëm nga vendasit, duke mos u bërë fjalë për turistë të huaj, që dhe aq pak sa janë, vijnë në rajon kryesisht për qëllime biznesi.

Aktorët kryesorë, që duhet të marrin pjesë në zhvillimin e turizmit në rajon, janë komunat, bashkitë, prefekturat, qarqet, universiteti i Shkodrës, biznesi privat dhe komuniteti. Nga këto aktorë është e domosdoshme, përveç të tjerave, të hartohet një strategji e zhvillimit të turizmit për rajonin.

Përsa i përket ofertës natyrore, në rajon mund të zhvillohen katër llojet kryesore të turizmit: turizmi malor, duke qenë pranë Alpeve të Shqipërisë; turizmi bregdetar, duke pasur një vijë bregdetare të mrekullueshme përgjatë të gjithë zonës; turizmin liqenor, duke pasur pasurinë më të madhe të Ballkanit, atë të Shkodrës; turizmin qytetar, duke patur një numër shumë të madh shtëpish karakteristike dhe mjaft objekte kulti dhe historike.

Në këtë rajon është e mundshme që turizmi të mbështetet edhe nga zhvillimi i bujqësisë e blegtorisë në funksion të tij, pasi fshatrat e zonës kanë patur rendimentet më të larta në Republikë para viteve ’90 në shumë produkte bujqësore e blegtorale.

Po kështu, potencialet njerëzore, në sasi dhe cilësi, favorizojnë zhvillimin e turistëve dhe mikpritjen e të huajve.

Nismat private mbizotërojnë në turizmin e rajonit, ku të gjitha strukturat akomoduese dhe agjencitë turistike janë krijuar si rezultat e këtyre nismave.

### V.6.1.1. Disa nga mundësitë turistike të zonës:

**Bashkia Shkodër:**

- Objekt i turizmit kulturoro-historik (kalaja e Rozafës), liqenor e lumor. Në këtë qytet ndërthuren shumë hijshëm në hyrje të tij Drini, Buna dhe Liqeni i Shkodrës krahas vlerave historike.
- Biznese të industrisë së lehtë dhe ushqimore, industrisë së tekstileve, këpucëve, farmaceutike, përpunimit të drurit.

**Bashkia Vau i Dejës:**

- Zonë me vlera tëveçanta turistike malore, liqenore, lumore dhe rigjeneruese.

**Komuna Ana e Malit:**

- Turizëm historik, përveç atij natyror. Vlen për t’u përmendur një kishë në Oblikë, ku shkojnë bashkë e falen katolikë e myslimanë.

**Komuna Bushat-Barbullush.**

- Nuk ka veçori turistike, përveç kalimit të rrugës kombëtare.

**Komuna Dajç.**

- Objekt i turizmit natyror për bukuritë natyrore të bregut të Bunes së kësaj zone; turizmit historik me qytetërimet e lashta të shkallës së Belnit/Pentar; kisha e Shirqit e shek. të III/IV, e cila u rindërtua në shek. XIII nga Helena e Madhe (gruaja e Krajlit të Serbisë); porti i Shirqit që ka pritur anije në shekujt IX-XVII; porti i Pulajt, që nga kadastrat e Venedikut rezulton aktiv që në vitet 1416-1417, duke u përmendur, me pas, në 1485, nga defterët turq, pati një ndërprerje midis 1485 dhe 1560 kur riaftësohet prapë;

**KomunaVelipojë.**

- Turizëm bregdetar dhe zhvillim i industrisë turistike. Nga një punim informativ, i realizuar nga një projekt i GTZ, mbi kapacitetet e Velipojës për pushuesit, rezultojnë rreth 124 struktura akomoduese (hotele 93 me kapacitet nga 4 deri në 120 shtretër, 12 vila dhe shtëpi, 1 motel dhe 18 kabina). Çmimi mesatar për person është 3 euro, ndërsa për dhomë 12 euro (dhomë me katër persona).
- Turizëm natyror- shfrytëzimi i pyjeve, gjuetia në rezervat apo kënetat përreth saj; peshkimin në Lagunën e Vilunit ashtu si në këneta;

**Komuna Guri i Zi.**

- Turizëm natyror me shpellat e famshme të Gajtanit-unikale në Evropë, Jubanit, ishullin e Sardës apo Shurdhah, liqenin e Vaut të Dejës me sipërfaqe 24,7 $km^2$.
- Turizmi historik me kalanë e Gajtanit-qytetërim që në periudhën e Ilirëve, rrënojat e qytetit tipik mesjetar në Sardë. Vendosje karakteristike përreth liqenit e një numër kështjellash të vjetra, si ajo e Darjes, Drishtit, Sardës, Dalmacës dhe Sapas, dikur të pozicionuara në hyrje të Drinit.
- Vetëm në Sardë, në 2004, ka patur rreth 1.900 turistë, ndërsa në 2005 (deri tani) 1.200 turistë. (ka përkeqësim të transportit si rezultat i prishjes së skafit)

**Fshati Velë**

- Turizëm pejsazhi

Lagunat e Kune dhe Vainit, përbëjnë një vlerë të jashtëzakonshme turizmi ekologjik dhe ecje në natyrë.
Segmenti Shëngjin Velipojë, rruga përgjatë vijës bregdetare Shëngjin – Velipojë (rrugë këmbësorësh) paraqet një vlerë turistike rajonale me tërheqje të lartë pejsazhore dhe rekreacioni për pushuesit.

Një dukuri shumë shqetësuese është edhe fakti i ndërtimeve dhe nismave që nuk marrin parasysh Vlerësimet e Ndikimit në Mjedis dhe aq më pak ato të Vlerësimit Strategjik Mjedisor, duke çuar në një ndikim shumë të lartë mbi natyrën dhe mjedisin.

Duke qenë se ndodhet në një stad zhvillimi shumë të ulët dhe me një mori të madhe problemesh, rajoni në shqyrtim konsiderohet si një destinacion kryesisht turizmin vendas dhe me synimin e thithjes së turistëve nga Kosova dhe nga Maqedonia, që mbeten fluksi kryesor i turistëve të përtej kufirit. Vlerat më të mëdha turistike, në këtë rajon, janë vlerat natyrore mjedisore dhe vendet e virgjëra që ofron si zonë, të cilat përsëri kërkojnë investime të mëdha dhe mënyrë të konceptuari shumëdimensionale dhe në përputhje me standardet ekomike, sociale, mjedisore dhe njerëzore.

Burimet natyrore dhe pejsazhet e mrekullueshme janë vlerat më të mëdha të zonës për tërheqjen turistike. Për rritjen e turizmit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonës nga ana mjedisore dhe ekonomike kërkohet një angazhim dhe punë e madhe nga autoritetet dhe nga vetë përfituesit e këtij turizmi.

### V.6.2. Analiza e faktorëve kryesorë

*Pikat e forta*

- Pasuria e ofertës natyrore dhe diversiteti i madh i saj
- Traditat në mikpritje
- Fuqia punëtore e kualifikuar (është marrë parasysh edhe hapja e degës së turizmit në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Shkodrës, me një numër studentësh rreth 90 vetë në vit)
- Përqendrimi i disa llojeve të klimave

*Pikat e dobëta:*

- Mungesa e infrastrukturës dhe superstrukturës (shërbimi hotelier në ato ekzistueset s'është në nivelin e duhur)
- Mungesa e ligjit për pronat në bregdet - Problemi i pronësisë së tokave në bregdet ku Velipoja dhe Shëngjini janë problemi më imediat për t'u zgjidhur: ndërtimi pa leje pa asnjë lloj plani (pronarë që bëhen titullarë të tokës sipas dëshirës së tyre duke dëmtuar të ardhmen e këtyre zonave).

### V.6.3. Tendenca e faktorëve kryesorë

Përsa i përket zhvillimit të turizmit në të ardhmen, faktorët e përmendur më sipër po përparojnë me ritme shumë të ngadalta. Këtu mund të përfshihen si faktorët pozitivë ashtu edhe ato negativë. Vihet re një mungesë totale e ndërhyrjes së shtetit. Si rrjedhim, po përkeqësohet degradimi natyror, problemi i pronësisë sjell efekte tepër negative mbi ndërtimet e reja, që shtohen përditë pa asnjë lloj plani. Më

poshtë janë detajuar secili prej faktorëve:

- Pasuria e ofertës natyrore dhe diversiteti i madh i saj - E qëndrueshme (relativisht)
- Traditat në mikpritje - E qëndrueshme
- Fuqia punëtore e kualifikuar - E qëndrueshme
- Mungesa e infrastrukturës dhe superstrukturës (shërbimi hotelier në ato ekzistueset s'është në nivelin e duhur) - Përmirësim (relativisht)
- Mungesa e planeve rregulluese - në përkeqësim
- Mungesa e ligjit për pronat në bregdet – në përkeqësim

### V.6.4. Lista e problemeve

| Problemi | Shkaku | Ndikimi | Popullsia që preket | Shkalla e ndikimit | Prioritarizimi |
|---|---|---|---|---|---|
| Infrastuktura e dobët turistike si dhe mungesa e studimeve urbanistike për zhvillimin e turizmit. | Mungesa e vëmendjes nga institucionet qendrore e vendore për t'i paraprirë me studime në zonën turistike. Mungesë investimesh për rehabilitim dhe investime të reja. | Ndërtime të paligjshme, jashtë kritereve teknike, jo bashkëkohore. Dëmtimin e objekteve natyrore, arkeologjike e historike. | E gjithë zona | E lartë | Shumë i rëndësishëm |
| Erozioni bregdetar | Zvogëlimi i prurjeve ujore nga ana e Lumit Drin | Hyrjen e detit në brendësi të rërës e duke kthyer atë në pjesë ujore, | E gjithë zona bregdetare | E lartë | Shumë i rëndësishëm |
| Prodhim bujqësor me cikël të mbyllur (Vetëm për vete dhe pak për treg). | Pamundësia për të dalë në treg nga kostoja e lartë e prodhimeve bujqësore. Mos ndjekja e një politike të qartë për grumbullimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale.<br><br>Infrastruktura e dobët rrugore dhe largësia nga qyteti. | Pasiguri në mbjelljen e kulturave bujqësore dhe mbarështrimin e blegtorisë. | E gjithë zona | E lartë | * * *<br>Shumë i rëndësishëm |

### V.6.5. Çfarë po bëhet

Ajo çfarë po bëhet aktualisht konsiston vetëm në disa investime të pjesshme shtetërore në rrugën Shkodër-Razëm dhe Shkodër-Velipojë. Të gjitha nismat e tjera të investimeve në strukturat akomoduese janë nisma private dhe që kryhen pa asnjë lloj plani rregullues. Ndërsa në Bashkinë Shkodër, për herë të parë, në strategjinë e zhvillimit ekonomik të qytetit është përfshirë edhe turizmi si sektor prioritar.

Në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Shkodrës, është hapur, që më Shtator 2002, dega e Turizmit, që pritet të nxjerrë kuadrot e parë të kualifikuar në këtë fushë. Gjithashtu, këtë vit kanë dalë kuadrot e parë të degës Marketing- Turizëm. Ky fakultet kontribuon edhe me studime serioze të fushës së turizmit.

GTZ ka bërë disa përpjekje në krijimin e një logoje për Velipojën, në themelimin e Shoqatës së Hotelerive në Velipojë, në disa publikime informative për strukturat akomoduese në Velipojë dhe në realizimin e disa studimeve në këtë fushë.

Gjithashtu, shoqatat Sarda dhe PZHR (Përpjekje për Zhvillim Rural) veprojnë me aktivitete (rreth 8 për 2004-2005) në tërheqjen e turistëve, kryesisht të huaj, duke promovuar resurset dhe vlerat e rralla të komunës së Gurit të Zi.

# VI. Rekomandime



## VI.1. Gjeologjia dhe energjia

1. Bazuar në tendencën për lëvizje gjeologjike të përhershme, pranisë së dy çarjeve të mëdha sizmike, rrëshqitjeve aktive në të gjithë territorin, tendencës së detit për të "marrë" tokë, futjes së ujërave të kripura, lodhjes së shkëmbinjve, PRVM rekomandon: a) fillimin e investimeve për prita malore për frenimin e prurjeve të ngurta në lumenjtë Gjadër dhe Kir; b) bllokimin e investimeve (të paktën ato madhore), të cilat nuk kanë marrë në konsideratë intensitetin e lartë sizmik të rajonit, deri në 7-8 ballë dhe praninë e dy çarjeve tektonike, që priten në këtë rajon. c) mbajtjen nën kontroll të vlerave muzeale të rrezikuara nga fenomenet gjeologjike (shembulli i Kalasë së Lezhës, që ndodhet në një mal që konsiderohet "i lodhur"); d) kryerjen e studimeve paraprake për ndërhyrje për rrugë apo ndërtime përgjatë brezit Mërqie – Kallmet, ku rrëshqitjet janë të theksuara në ballin e mbihypjes, të shoqëruara me planin rrëshqitës dhe rrëshqitje aktive; e) monitorimin e vazhdueshëm të gjendjes së vlerave muzeale, që rrezikohen të rrënohen (rasti i kalasë së Lezhës, ku shkëmbi që mban këtë kala konsiderohet i lodhur dhe paraqet rrezik serioz si për vetë kalanë ashtu dhe për qytetin); f) ndalimin e të gjitha ndërtimeve të përhershme përgjatë vijës bregdetare, nga lumi Mat deri në derdhjen e lumit Buna, si dhe rehabilitimin e brezave pyjorë në Shëngjin dhe Ishullin e Franc Jozefit, për shkak të rrezikshmërisë së madhe që paraqet erozioni në zonë; g) konsultimi me kujdes i rekomandimeve të dhëna nga plani pilot për gjirin e Drinit (plan i hartuar nga ELPA), ku kërkohet zgjerimi i zonës buferike për lagunat, si parandalim për ndërtime dhe aktivitete pranë zonës së rrezikuar.

## VI.2. Hidrologjia

1. Duke parë shkallën e dëmtimit të brigjeve të lumit Gjadër, nga fshati Kalivaç e deri në bashkimin e tij me lumin e Drinit, në Vaun e Dejës, si rezultat i dëmtimit të pritave dhe pjerrësisë së madhe nga burimi i lumit deri në zbritjen në fushë, PRVM rekomandon: a) marrjen e masave riparuese të shpateve të lumit Gjadër me pyllëzime dhe ngritje pritash, pasi përbëjnë rrezik për fshatrat përgjatë tij; b) mbështetjen e nismës së Bankës Botërore për riparimin e pritës së lumit Gjadër në pjesën fushore, ku rrezikohet dalja e tij dhe përmbytja e zonës së Lezhës.
2. Për shkak të dëmtimit të rëndë të brigjeve të lumit Kir, shkallës së lartë të erozionit të tij, rrezikut të madh që i paraqitet qytetit të Shkodrës, sasisë së madhe të sedimenteve që përcjell për në lumin Buna (duke rritur nivelin e shtratit të tij) dhe përmbytjes së madhe të shkaktuar prej tij në fshatrat përgjatë brigjeve të tij, PRVM rekomandon: a) ndërhyrjen e shpejtë në argjinaturat e lumit Kir; b) liçensimin dhe monitorimin e kujdesshëm të firmave që shfrytëzojnë zhavorret (në zonat ku nuk rrezikohet rritja e shpejtësisë së lumit për shkak thellimi), për të ulur sasinë e sedimenteve që sjell ky lumë.
3. Duke marrë në konsideratë shkallën e madhe të erozionit në liqenin e Hidrocentralit të Vaut të Dejës dhe sedimenteve që shkarkohen në të nga përrenjtë që e rrethojnë, duke synuar parandalimin e një problemi që pritet të shfaqet në të ardhmen, PRVM rekomandon: a) studimin e veçuar të këtij liqeni, për të parë mundësinë e pastrimit të tij; b) parandalimin e sedimenteve nga lumenjtë që zbresin në liqen; c) pyllëzimin e zonave me shkallë të lartë erozioni dhe zonave të shpyllëzuara.
4. Duke parë situatën hidrologjike të rënduar në të gjithë zonën, „atrofizimin" e Drinit të Lezhës, rrjedhën kaotike të Drinit të Shkodrës, tejmbushjen me sedimente të lumit të Bunës, përmbytjet e zonës për shkak të mungesës ose nivelit të ulët të aftësisë së ulët përcjellëse të lumenjve Drin dhe Buna, humbjen e biodiversitetit, dëmtimin e vlerave turistike për shkak të mungesës së një lumi të rrjedhshëm në zonën e Lezhës, PRVM, bazuar edhe në studimet e tjera për këtë çështje, rekomandon: a) kthimin afërsisht në gjendjen e mëparshme të shtratit i vjetër të lumit Drini i Lezhës, duke e pastruar atë nga lëndët e ngurta dhe dherat, që janë depozituar

gjatë gjithë këtyre viteve, duke bërë njëkohësisht korrigjime dhe rregullimet e mundshme për t'i shkurtuar gjatësinë dhe rritur pjerrësinë gjeodezike dhe hidraulike. Në këtë shtrat të sistemuar e të rregulluar, të futet një pjesë e ujërave të lumit Drin, pjesa e prurjes themelore të tij, e cila është mjaft e qëndrueshme në madhësi dhe luhatet në kufij shumë të ngushtë, brenda kapacitetit normal ujëheqës të këtij shtrati. Këto ndryshime do të rivendosin dhe përmirësojnë funksionin kullues të Drinit të Lezhës për zonën e fushës. Gjithashtu, jetësimi i Drinit të Lezhës do të mbrojë tokat nga rritja e nivelit të kripëzimit si rezultat i futjes së ujërave detare më në thellësi të territorit.

5. Duke parë problematikën e madhe që shoqëron lumin Buna, mbimbushjen e tij me sedimente, bërrylat e fortë të krijuar që shkaktojnë dalje nga shtrati me pasoja të mëdha ekonomike dhe sociale, shkallën e lartë të erozionit në brigjet e tij, në zbatim të ligjeve në fuqi për zonat e mbrojtura, PRVM rekomandon: a) studimin dhe dhënien për shfrytëzim të zonave më të ngushta të rrjedhës (veçanërisht në lumin Buna), si dhe bërrylave të krijuar gjatë rrjedhës. Planifikimi i shfrytëzimit të tyre të bëhet për periudhën më të thatë të vitit. Kjo veprimtari mund të udhëhiqet nga Agjencia e Basenit Ujëmbledhës Drin – Bunë, përmes projekteve që hartohen nga subjektet private që kërkojnë të liçensohen nga Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Drin - Bunë. Kjo agjenci rekomandohet të kërkojë nga projektuesit marrjen në konsideratë të kërkesave të mësipërme. b) displinimin e aktiviteteve të marrjes së zhavorreve në lumin Drin të Shkodrës, bazuar në dispozitat ligjore.

6. Si rezultat i rritjes së presionit të ndërtimeve pa leje dhe problematikës së pronësisë së tokës, ndërhyrjeve me rrezikshmëri për sistemin ujor dhe i shfrytëzimit të lumit si "pastrues" i mbetjeve të komuniteteve, PRVM rekomandon: a) zgjidhjen e çështjes së pronësisë dhe vënien në zbatim të ligjit të baseneve ujore për respektimin e distancës nga brigjet ujore, në të mirë të sistemit ujor, komunitetit dhe respektimit të vlerave mjedisore.

7. Duke parë problemin e madh të shkaktuar nga përroi i Manatisë në hyrje të qytetit të Lezhës, PRVM, bazuar edhe në gjetjet e studimeve të mëparshme[1], rekomandon: a) marrjen e masave për disiplinimin e ndërtimeve pa leje përgjatë këtij përroi, në mënyrë që të shpëtohet nga përmbytja zona poshtë qytetit të Lezhës.

## VI.3. Bujqësia dhe Peshkimi

1. Duke parë shkallën e madhe të përmbytjeve në tokat bujqësore në të gjithë rajonin si rezultat i çrregullimit hidrologjik të lumenjve Drin, Gjadër dhe Bunë, humbjes së Drinit të Lezhës, dëmtimit të sistemit të kanalizimeve kulluese, keqfunksionimit të hidrovoreve, PRVM rekomandon: a) zbatimin e pikave të përmendura në pjesën e Hidrologjisë në këtë dokument, si një nga zgjidhjet më kryesore të problemit; b) zgjidhjen e shkarkimit të ujërave nga KUL Zadrimë në Lumin Drin nëpërmjet mundësisë së derdhjeve të këtij të fundit në dy ose më shumë pika; c) sigurimin e një linje mbështetëse, të veçantë energjie për këto hidrovore (si rasti i atij të Balldrenit) dhe prioritet t'i kushtohet hidrovorit të Tales, pasi kullon një sipërfaqe të madhe toke.

2. Duke respektuar investimet dhe vullnetin e Bankës Botërore për pastrimin e kanaleve kulluese në të gjithë zonën, PRVM rekomandon: a) mbështetjen dhe angazhimin e strukturave vendore për të rritur efektivitetin e përdorimit të këtyre investimeve; b) ndërgjegjësimin e banorëve për t'u bërë pjesë e zgjidhjes, nëpërmjet kontributit që kërkohet për përfitimin e këtyre projekteve.

3. Si rezultat i rritjes së shkallës së erozionit të tokës bujqësore në të gjithë rajonin në studim, për shkak të vaditjeve jo të përshtatshme me rrjedhje, PRVM rekomandon: a) kalimin

*1 Sipas një studimi të Akademisë së Shkencave, lidhur me përmbytjet në zonën e Lezhës, përroi i Manatisë, konsiderohet si shumë problematik dhe duhen marrë masa drastike për ndërtimet përgjatë tij.*

gradual, shkallë-shkallë, në vaditjen në formë shiu[2] të sipërfaqeve bujqësore të kësaj lugine, për të zvogëluar në maksimum erozionin e tokës dhe varfërimin e saj, për të pakësuar sasinë e nevojshme të ujit për vaditje dhe për të rritur rendimentet e prodhimeve bujqësore në këtë zonë.

4. Duke parë problematikën e krijuar prej keqpërdorimit të tokës, keqadministrimit të fermave, shfrytëzimit të shkëputur dhe me efikasitet të ulët të prodhimeve bujqësore, PRVM rekomandon: a) përfundimin e projektit të regjistrimit të pasurisë së paluajtëshme (toka) dhe dorëzimi i dokumentacionit në zyrën RRPP; b) të nxitet zhvillimi i tregut të tokës, duke stimuluar edhe kooperimin e fermerëve në shoqata e ferma private, të cilat japin garanci mirëpërdorimi të tokës, respektim të mjedisit dhe janë më frytdhënëse përsa i përket produkteve bujqësore.

5. Duke analizuar situatën e peshkimit në rajon, si rezultat i së cilës ushtrohet peshkim i pakontrolluar, në çdo sezon, me mjete shfarosëse dhe në zona të ndjeshme, PRVM rekomandon: a) ndalimin e aktivitetit të peshkimit intensiv në zonat e mbrojtura (lagunat Kune e Vain, Vilunit dhe lumin Buna, kënetën e Domnit) dhe rishikim i vendeve ku peshkimi do të respektojë rregullat për rritjen e tij (bazuar në ligjet e peshkimit dhe zonave të mbrojtura); b) krijimin e rezervave të peshkut pranë Hidrocentralit të Vaut të Dejës; c) rritje të kapaciteteve formuese nëpërmjet asistencës tekniko-profesionale në fushën e peshkimit dhe akuakulturës (nëpërmjet projekteve), si dhe kreditimin në aplikimin e akuakulturës rurale, familjare dhe të përqendruar; d) rritja e kontrollit nga inspektoriati i peshkimit në Shkodër dhe përgatitja e grafikëve për peshkim atëherë kur do të lejohet një aktivitet i tillë duke u vendosur në vende publike dhe/ose të shoqërojnë liçensat e dhëna.

## VI.4. Biodiversiteti dhe zonat e mbrojtura

1. Duke marrë në konsideratë vlerat e mëdha pejsazhore të zonës, dëmin e madh që po shkaktohet në të gjithë territorin, sidomos nga guroret, PRVM rekomandon: a) rivlerësimin e të gjitha lejeve të dhëna ose aktiviteteve të paligjshme për gurore, si masë e menjëhershme, për këtë lloj aktiviteti, që po shkakton probleme thelbësore, sidomos për malin e Rrencit, Kakarriqit dhe në hyrje të qytetit të Shkodrës; b) bllokimin e dhënies së licensave të tjera për gurore në të gjithë zonën.

2. Duke konsideruar si një zhvillim shumë pozitiv futjen në kategorinë e zonave të mbrojtura dhe të Konventës së Ramsarit të kompleksit Liqeni i Shkodrës, Lumi Buna, mali i Rrencit dhe zona e kufizuar prej tyre, PRVM rekomandon: a) respektimin e ligjeve në fuqi për këto zona, duke filluar, hap pas hapi, me largimin e aktiviteteve të tilla si guroret në malin e Rrencit, aktivitetit të peshkimit në lagunën e Vilunit, sistemimin e kanalizimeve të ujërave të zeza për fshatrat e zonës së mbrojtur, rishikimin dhe zbatimin e studimit urbanistik për Velipojën, studimin e një zone tjetër për derdhjen e ujërave të zeza të qytetit të Shkodrës, etj; b) forcimin e mëtejshëm dhe kualifikimin e vazhduar të Agjencive Rajonale të Mjedisit në Shkodër dhe Lezhë; c) fillimin e fushatave ndërgjegjësuese dhe takimeve në të gjithë zonën, për statusin dhe të drejtat e kufizimet që komuniteti ka si pjesë e zhvillimit të zonës.

3. Duke parë aktivitetin e madh që ushtrohet çdo ditë e më shumë në të gjithë zonën, ndërtimet e reja lokale, por dhe ato me rëndësi strategjike, PRVM rekomandon: a) respektimin e ligjeve për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Vlerësimin Strategjik Mjedisor, për të gjithë aktivitetet dhe ndërhyrjet në zonë si dhe respektimin e të gjitha konventave që Shqipëria është

2 *me vaditje ne forme shiu kuptohet vaditja me sisteme tubacionesh, por, në rradhë të parë, ate me hedheësa të fuqishëm uji në formë shiu, që sot përdoren gjerësisht në të gjitha vendet me bujqësi të zhvilluar. Fermerët nuk do të kenë më nevojë të merren me hapjen e mbylljen e kanaleve të dyta e të treta vaditës dhe të zenë jo pak tokë bujqësore me ta. Për të bërë një vaditje të tillë të të gjitha sipërfaqeve bujqësore, sigurisht që duhet të përdoret energji elektrike në sasira jo të vogla. Këtë sasi energjie, e më shume se kaq, është në gjendje ta prodhojë vetë Drini i Lezhës. Ai disponon një rënie diçka më të madhe se ajo e hidrocentralit të Bushatit. Do të varet nga sasia e ujit që do të futet në Drinin e Lezhës fuqia dhe energjia që ai mund të prodhojë.*

palë (shembulli i konventës Espoo për ndotjet në largësi të mëdha); b) bllokimin e të gjitha aktiviteteve apo nismave të cilat akoma nuk kanë marrë këtë leje

4. Duke vlerësuar pasojat negative që kanë pësuar lagunat e Kune – Vainit dhe Liqeni i Kënallës, PRVM rekomandon: a) kalimin plotësisht në pronësi të shtetit të lagunave të Kune Vainit, anullimin e të gjitha pronësive të kundërligjshme dhe të punohet me pronarët[3] për vendosjen e kritereve dhe hartimin e marrëveshjeve për mirëmenaxhim; b) largimin e ndërtimeve pa leje brenda territorit të këtyre lagunave; c) mbështetjen e planit pilot të projektit ELPA për rritjen e shkallës së mbrojtjes për këto laguna (nga IV në II) dhe rritjen e sipërfaqes së zonës nën mbrojtje; d) mbështetjen e projektit të Bankës Botërore për ujërat e zeza, sidomos zgjidhjen e problemit të këtyre ujërave për qytetin e Lezhës; e) frenimin e prerjeve të pishave dhe realizimin e ndërhyrjeve për rivitalizimin e brezit pyjor përgjatë vijës bregdetare, si e vetmja mbrojtje momentale nga erozioni detar; f) zbatimin rigoroz të ligjit për VNM për ndërtimin e fshatrave turistikë dhe për çdo lloj ndërtimi në zonë, si dhe hartimin e një plani rregullues për komunën e Shëngjinit.

5. Duke parë rëndësinë e madhe në gjallërimin e faunës dhe florës, uljen e erozionit dhe mbrojtjes së ujërave të ëmbla, PRVM rekomandon: a) jetësimin e lumit të Drinit, (referoju rekomandimeve për Hidrologjinë);

6. Duke parë situatën e rritur të erozionit, dëmtimit të pejsazhit dhe dëmtimit të fondit pyjor, PRVM rekomandon: a) ndalimin e çdo aktiviteti për prerje drurësh në të gjithë zonën; b) mbështetjen e nismës për projektin e sekuestrimit të karbonit.

7. Bazuar në faktin që një bujqësi e “copëtuar” rrit rrezikun e ndotjes dhe pamundësinë e zbatimit të politikave dhe masave për përdorimin masiv të qëndrueshëm, PRVM rekomandon: a) zgjidhjen e problemit të tokës dhe nxitjen e fermave të mëdha dhe e grupimit të fermerëve si rruga e vetme për një punë efikase në ndërgjegjësim dhe zbatimin e teknikave bujqësore që respektojnë natyrën; b) mbështetjen e teknikës së vaditjes në formë shiu, pasi mbron tokat nga erozioni dhe nga varfërimi i elementëve kimikë dhe organikë në të.

8. Duke marrë parasysh vlerat e mëdha mjedisore dhe pejsazhore, PRVM rekomandon: a) futjen e zonës së Velës në kategorinë V të zonave të mbrojtura.

9. Bazuar në vlerat e jashtëzakonshme natyrore të maleve të Rrencit dhe të Kakarriqit, për bimët mjekësore, veçanërisht për bimën e sherbelës (Salvia officinalis), PRVM rekomandon: a) inventarizimin e të gjithë zonës ku kjo bimë rritet; b) vendosjen e kritereve të shfrytëzimit të saj dhe nxitjen e kultivimit për të siguruar një shfrytëzim të qëndrueshëm; c) përdorimin e kësaj bime si një vlerë e jashtëzakonshme për mbjellje në shpatet e eroduara ose me bimësi të reduktuar.

10. Duke marrë parasysh nevojën e madhe për energji të vendit në tërësi dhe faktin që zona paraqet një nga rajonet më të pasura për ditët me erë dhe diell, PRVM rekomandon: a) aplikimin e teknologjisë paneleve diellore, nisur nga fakti që rajoni Shkodër – Lezhë bën pjesë në klimë mesdhetare dhe ka rreth 226 ditë diell në vit, që mund të shfrytëzohet normalisht; b) përdorimin e energjisë se erës[4]. Këtë e favorizojnë kushtet e relievit me kodra të buta dhe me erëra lokale të bollshme, deri në 120 ditë në vit (shih hartën për zonën me prioritet).

*3 Shih ligjin “Për zonat e mbrojtura”, nr. 8906, nenet 18 dhe 19*

*4 Nga një vlerësim, i bërë nga Drejtoria e Gjeologjisë Shkodër, del që vënia në punë e disa turbinave me erë në rajonin Shkodër – Lezhë, do të lehtësonte shumë sistemin energjetik dhe shlyerja do të ishte shumë e shpejtë. Një turbinë me erë, kushton 1 milion dollarë dhe mban rreth 35.000 banorë, shlyen veten për 2 - 3 vjet).*

## VI.5. Dinamika Njerëzore dhe Përdorimi i Territorit

1. Duke marrë parasysh mungesën e planeve të rregullimit të territorit në të gjithë zonën e marrë në shqyrtim, humbjen ose transformimin e tokës, ndërtimet e pakontrolluara, nevojën në rritje për shërbime lokale dhe rajonale, fluksin ende në rritje të imigrimit të popullsisë në këtë zonë, nevojës për mbrojtjen e vlerave natyrore si dhe zhvillimit të integruar të zonës, PRVM rekomandon: a) zhvillimin e qëndrueshëm të territorit – ndërtimet dhe zhvillimi urban kërkojnë kujdes në zgjedhjen e materialeve për ndërtim dhe që ato të jenë efiçiente ndaj ruajtjes së energjisë dhe të mos dëmtojnë mjedisin për shkak të nevojave për t'u prodhuar apo kur të jetë e nevojshme për depozitimin e tyre pas shkatërrimit; b) minimizimin e ndërtimeve të rrugëve për zona të veçanta apo aktivitete të veçanta, pasi kjo do të ndikonte shumë negativisht në natyrë. c) hartimin e një plani të përgjithshëm zhvillimi urban, duke patur parasysh tendencat e deritanishme të lëvizjes së popullsisë dhe tendencat e zhvillimit në përgjithësi, me synim moskrijimin e zonave informale; d) hartimin e planeve rregullues me të gjithë infrastrukturën përkatëse për çdo zonë të banuar, të integruar në planin rajonal dhe në konformitet me tendencat e zonës (turistike, bujqësore, të tregtisë ndërajonale, etj). Këto plane të marrin parasysh tendencat e rritjes së popullsisë duke parashikuar zgjerimin e vendeve të banimit dhe tendencat e zhvillimit ekonomik, duke parashikuar krijimin e zonave industriale, të tregëtisë, etj; e) përcaktimin e fondeve jo sipas skemave standarde, por duke i dhënë përparësi çdo zone sipas tendencës së zhvillimit.

2. Bazuar në konfliktet e shumta "shtet" - "pronar", "pronar" - "pronar" dhe "pronarë informalë" - "pronar i ligjshëm", pafuqisë në zbatimin e ligjeve, frikës për investime të sigurta, "plaçkitjen" e pasurive natyrore, mosadministrimin dhe/ose keqadministrimin e pasurive të zonës, PRVM rekomandon: a) zgjidhjen përfundimtare të ndarjes së tokës dhe krijimin e kushteve të favorshme për të përdorur efektivisht tokën bujqësore, sidomos marrjen e masave kundër fragmentizimit të saj; b) shoqërimin e planeve të zhvillimit me projekte zbatimi reale, të besueshme dhe të bashkërenduara me politika lehtësuese për të nxitur zhvillimin e bizneseve në zonat urbane e rurale dhe uljen e lëvizjes së popullsisë për shkaqe ekonomike; c) krijimin e lehtësirave, me anë të politikave të veçanta, të investimeve të huaja dhe vendase për rritjen e punësimit në përshtatje me tendencat e zhvillimit të zonës; ngritjen e kapaciteteve të grupeve të ndryshme me anë të kualifikimeve të organizuara sipas kërkesës së tregut të punës dhe perspektivave të zhvillimit të tij; d) rritjen e shkallës së decentralizimit lidhur me shërbimet e ndryshme, duke garantuar edhe një zbatim dhe monitorim më të fortë të këtyre veprimtarive.

3. Bazuar në shkallën e madhe të rrezikshmërisë sizmike që paraqet rajoni (shih rekomandimet për çështjet e gjeologjisë), PRVM rekomandon: a) mosdhënien e lejeve të ndërtimit për objekte private apo shtetëtore, rrugë apo kanalizime, pa shqyrtimin dhe miratimin prej Drejtorisë së Gjeologjisë në rajon; b) trajtimin me kujdes të veçantë të ndërtimeve në zonat e Malit të Rrencit, Kakarriqit dhe përreth qytetit të Shkodrës, pasi paraqesin sizmicitet shumë të lartë deri në shkallën 8 ballë të shkallës Rihter; c) trajtimin me kujdes të veçantë të investimeve për rrugë në segmentin Mërqie – Kallmet, si rezultat i rrëshqitjeve aktive.

4. Duke marrë parasysh situatën e pakontrolluar lidhur me grumbullimin dhe depozitimin e mbetjeve, venddepozitimet shumë problematike të qytetit të Shkodrës dhe të Lezhës, grumbujve me plehra të krijuara në të gjithë zonën, presionit të madh në sistemin ujor të zonës, si dhe duke shqyrtuar alternativat e zgjidhjes së këtij problemi, PRVM rekomandon: a) mbylljen e fushave ekzistuese në të gjithë rajonin, sidomos asaj të Shkodrës dhe asaj të Shëngjinit; b) ndërtimin e një fushe rajonale mbetjesh si zgjidhja më e përshtatshme për këtë problem; c) përjashtimin e zonës së Lezhës si mundësi për krijimin e fushave të grumbullimit të mbetjeve për shkak të nivelit shumë të lartë të ujërave nëntokësore (shembull mund të merret zbatimi të një projekti të ngjashëm me Qarkun e Korçës, financuar nga qeveria suedeze); d) ndërtimin e fushës rajonale të mbetjeve në komunën e Bushatit (në kodrat e Plezhës (siç është treguar në hartën 1), e

vlerësuar për një kapacitet funksional deri në 50 vjet, për të gjithë rajonin, dhe që përmbush kriteret për mbrojtjen e ujërave nëntokësore dhe pejsazhit e) ushtrimin e një kontrolli më i rreptë mbi firmat e pastrimit të dy qyteteve dhe zbatimin e politikave më të rrepta për grumbullimin e mbetjeve, kryesisht në qendrat e mëdha si dhe në zonën e mbrojtur (siç është treguar në hartën 2).

5. Duke marrë parasysh mungesën totale të sistemeve të ujërave të zeza, në të gjitha njësitë administrative të zonës, rrezikut të ndotjes së ujërave nëntokësore në të gjithë zonën, ndotjen e lartë të Liqenit të Shkodrës dhe Lumit të Bunës (pranë qytetit të Shkodrës si rezultat i derdhjes së ujërave të zeza të qytetit në to), Lumit të Drinit nga qyteti i Lezhës, deri në derdhje në Detin Adriatik, nga ujërat e zeza të qytetit të Lezhës, ndotjen e detit Adriatik (porti i Shëngjinit) dhe Liqenit të Kënallës nga ujërat e zeza të komunës Shëngjin (80% e ujërave derdhen në Adriatik dhe 20% në liqenin e Kënallës), dëmtimin e lagunave të Kune - Vain dhe biodiversitetit në to nga këto ujëra, PRVM rekomandon: a) angazhim të administratave të qytetit të Lezhës dhe komunës së Shëngjinit për të kontribuar në mënyrë të frutshme në zgjidhjen e problemit të ujërave të zeza, në kuadër të projektit të Bankës Botërore për impiantin e ujërave të zeza (sistemi i ligatinave), që do të ndërtohet pranë Shëngjinit; b) ndërtimin e një sistemi të pastrimit të ujërave të zeza të qytetit të Shkodrës dhe mënjanimi i derdhjes në Liqenin e Shkodrës; c) duke pasur parasysh problematikën dhe mundësitë financiare e kufizuara të zonës për ndërtimin e impianteve të ujërave të zeza për të gjitha njësitë administrative, të mbështetet ideja e ndërtimit të gropave septike sipas sistemeve filtruese për komunat dhe fshatrat, të cilat nuk mund të jenë pjesë e një sistemi më të gjerë.

6. Bazuar në pasuritë e mëdha ujore nëntokësore të të gjithë zonës në shqyrtim, mbi përdorimit të ujërave nëntokësore në fshatin Barbullojë, për shkak të numrit të madh të shpimeve të pakontrolluara dhe rritjes së kripëzimit dhe nivelit të $NO_2$ në këtë fshat dhe pranë Hotelit të Gjuetisë, PRVM rekomandon: a) ngritjen e sistemeve të kontrolluara të ujit të pijshëm për të gjitha komunat e rajonit dhe përmirësimin e rrjetit të ujit të pijshëm në qytetet Lezhë e Shkodër; b) punime specifike gjeodezike për zonën turistike Velipojë - Shëngjin (fusha karstike Pentar Lezhë)[5]; c) mbrojtjen e ujërave dytësore nga ndotja prej ujërave të zeza (ujërat dytësore të dala pas ngritjes së digës së hidrocentralit të Vaut të Dejës në kuotën 73 m, në Laç, kryesisht ujëra të kanaleve karstike, çarjeve të ndryshme, ngopjet e hinkave karstike, të tektonikave mbihypëse. Këto ujëra kanë përmirësuar shumë prurjet në burimet ujore te zonës Laç - Vaut - Dejës, sidomos për vaditje (shembull mund të përmendet burimi ende i pashfrytëzuar mirë i Shelqetit me 4 –6 $m^3$/sek); d) evidentimin e shpimeve të pakontrolluara dhe rrezikun që paraqesin ujërat nëntokësore të furnizuara prej lumenjve të zonës, të cilat mbartin shumë ndotje.

7. Duke parë mos respektimin e hapësirave të gjelbëra në të gjitha njësitë administrative si dhe ndërtimet urbane konsiderata mjedisore, PRVM rekomandon: a) rritjen e sipërfaqeve të gjelbra, kryesisht në qytetet e Shkodër dhe Lezhë dhe në qendrat komunare me numër të madh banorësh; b) krijimin e parqeve masive në qytetet Lezhë dhe Shkodër; c) vendosjen e standardeve dhe gjelbërimin e sipërfaqeve përreth industrive të ndryshme në rajon, sidomos ato me ndikim më të madh mjedisor dhe shëndetësor si gurore, qendra të gjera industriale, stacione përpunimi të lëndëve të para, etj.

## VI.6. Turizmi

1. Duke marrë parasysh se turizmi në zonë ndodhet nën një presion të jashtëzakonshëm njerëzor dhe keqadministrim si nga autoritetet vendore dhe privatët, PRVM rekomandon: a) si modelin e turizmit të suksesshëm atë të ndjekjes së hapave të vegjël, duke u mbështetur së

*5 Rezultatet e marra këto vitet e fundit në Velipojë (për një shtresë produktive ujëmbajtëse në thellesinë 7 deri 12 ml, rëra kokërrtrashë ujëmbajtëse me ujëra të ëmbla të vazhdohet në drejtim të Shëngjinit dhe kjo shtresë të ruhet nga ndotjet.*

pari në turizmin familjar dhe zhvillimin e mesëm të turizmit. Në të ardhmen, zhvillimi gradual i sektorëve të tjerë të ekonomisë, në funksion të zhvillimit të turizmit, do të mbështesë edhe zgjerimin e ofertës turistike; b) hartimi sa më i shpejtë i masterplaneve për zhvillimin e turizmit, të harmonizuara këto me të gjithë treguesit mjedisorë; c) investime në infrastrukturë dhe superstrukturë (mbetet në fuqi ideja e lidhjes së korridorit Lezhë – Shkodër me Ulqinin); d) investime për ruajtjen dhe rritjen e vlerave kulturore dhe historike. Ndërhyrjet e tjera strategjike të përmendura më sipër si studimi për kthimin e Lumit Drin në një lumë të rrjedhshëm gjatë gjithë vitit, ngritja e vendgrumbullimit dhe përpunimit të mbetjeve për të gjithë zonën, nismat për edukimin e njerëzve për rëndësinë e mjedisit të qëndrueshëm do të ndihmojnë në zhvillimin e mëtejshëm të turizmit në zonë.

2. Bazuar në faktin që kemi të bëjmë një zonë me burime turistike të shumëllojshme, PRVM rekomandon: a) investimin në njohjen e zonave të tjera turistike të rajonit, duke marrë në konsideratë dhe strategjinë e qeverisë për një turizëm kulturoro-historik; b) marrjen e masave për mbrojtjen e Kalasë së Lezhës dhe Shkodrës si vlera të papërsëritshme historiko-kulturoro-turistike; c) futjen në listën e zonave turistike të liqenit të Vaut të Dejës si një vlerë pejsazhore, pushimi, kulture dhe plazhi dielli; d) futjen në listën e zonave me vlera të rëndësishme kulturoro-turistike të zonës së lumit të Gjadrit, pranë fshatit Vig.

# VII. Plani i Veprimeve



## VII.1. Gjeologjia

| Problemi | Veprimet | Prioriteti dhe afati kohor | Aktoret përgjegjës dhe bashkëpunëtorët e mundshëm | Efekti |
|---|---|---|---|---|
| Rreziku gjeologjik, përmbytjet, erozioni, mbetjet urbane, zhvillimet urbane, infrastruktura. | a. Forcimi i kompetencave të drejtorisë gjeologjike për të çertifikuar ndërtimet në zonë<br>b. Hartimi i projekteve gjeologo – inxhinierike, mjedisore, turistike, studime urbane.<br>c. Investime direkte për prita malore dhe prita detare me pyllëzime dhe ndërhyrje inxhinerike për mbrojtjen nga erozioni i lartë dhe rrëshqitja natyrale e shpateve | * * *<br><br>a. Brenda 3 vjetëve<br>b. Brenda 5 vjetëve (të paktën të niset puna me përgatitjen e tyre)<br>c. Brenda 5 vjetëve | Institucionet e pushtetit lokal të Qarqeve Shkodër - Lezhë,<br>Qeveria Shqiptare nëpërmjet ministrive të linjës | - Mbron vlerat natyrore të të gjithë zonës në shqyrtim.<br>- Do t'i jepte një zhvillim të vrullshëm këtij rajoni, duke ndikuar për mirë në të gjithë Shqipërinë e Veriut dhe deri në Tiranë.<br>- Niveli i të ardhurave për frymë do të rritej, mundësia e shfrytëzimit të zonave malore dhe pasurive minerare, thithjen e shumë turistëve dhe më vonë rajon të sigurtë për të investuar të huajt. |

## VII.2. Hidrologjia

| Problemi | Veprimet | Prioriteti | Aktorët përgjegjës e bashkëpunëtorët e mundshëm | Efekti |
|---|---|---|---|---|
| Kaos hidrologjik në të gjithë zonën. Lumenjtë Drin, Bunë, Kir e Gjadër si dhe Liqeni i Shkodrës kanë krijuar një komunikim kaotik, i cili tenton drejt përkeqësimit | a. Analiza në detaje e gjendjes ekzistuese e deltës Drin.<br>b. Hartimi i studimeve dhe i projekteve për zgjidhjen e plotë të kaosit hidraulik të deltës së Drinit e më gjerë | * * *<br>a. Brenda 3 vjetëve<br>b. 5 vjet | Institucionet kërkimore të specializuara<br>Donatorët | - Nga zgjidhja e problemit do të krijohen përmirësime hidrike në tërësi të liqenit të Shkodrës, lumenjve Buna dhe Drin.<br>- Përmirësohen ujërat dhe cilësia e ujit nëntokësore. |
| Dëmtimi i brigjeve të lumenjve Drin, Bunë, Kir dhe Gjadër si rezultat i erozionit të lartë të shkaktuar nga vetë këto lumenj. | a. Licensimi i firmave që marrin zhavorre në pikat problematike përgjatë këtyre lumenjve për t'i thelluar shtratin lumit Buna dhe Gjadër dhe për të sistemuar rrjedhjen e vrullshme, sidomos të lumit Kir.<br>b. Ndërtimi i pritave mbrojtëse përgjatë lumit Kir, Gjadër, Bunë dhe Drin.<br>c. Ndërtimi i pritave malore në të gjithë zonën për të penguar mbingarkesën e lumenjve me aluvione si dhe mbushjen e Liqenit të Vaut të Dejës.<br>d. Mbjellja e pemëve përgjatë brigjeve | * * *<br>a. Brenda 3 vjetëve<br>b. Brenda 3 vjetëve<br>c. Brenda 5 vjetëve<br>d. Brenda 3 vjetëve | Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.<br>Autoritetet vendore | - Rregullon, në të gjithë zonën, sistemin e ujërave, që është përgjegjës për zhvillimet mjedisore, bujqësore dhe njerëzore në të. |
| Zona të tëra të përmbytura dhe të rrezikuara në zonë. | a. Jetësimi i Drinit të Lezhës, duke bërë thellimin e tij.<br>b. Studim i vecuar për lehtësimin e sistemit Lumi Drin – Liqeni i Shkodrës – Lumi Buna, me anë të ndërtimit të një porte komanduese pranë digës së Spatharit, duke zbritur një pjesë të ujit në Drinin e Lezhës. | * * *<br>10 vjet | Qeveria Shqipetare<br>Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.<br>Autoritetet vendore | Parandalim i përmbytjeve<br>Rregullimi i të gjithë ekosistemit në të gjithë zonën |

## VII.3. Bujqësia dhe Peshkimi

| Problemi | Veprimet | Prioriteti dhe afati kohor | Aktorët përgjegjës dhe bashkëpunëtorët e mundshëm | Efekti |
|---|---|---|---|---|
| Mungesa e sistemit të kullimit. | a. Nxitja e komunitetit për bashkëfinancim<br>b. Pastrimi i kanaleve I e II për çdo 3 - 4 vjet, ndërsa kanalet e III, duhet të pastrohen çdo vit nga vetë fermerët .<br>c. Studime për venien në eficiencë të plotë të këtij sistemi.<br>d. Hartimi i projekteve e preventivave për rehabilitimin e plotë të sistemit kullues | * * *<br>a. Duke filluar që nga viti 2006<br>b. Duke filluar që nga viti 2006<br>c. Brenda 2 vjetëve<br>d. Brenda 3 vjetëve | Bordi i kullimit, pushteti qendror e vendor, donatorë, shoqata e përdoruesve të ujit (SHPU) projekti i BB (PMU) | Përmirësohet struktura dhe pjelloria e tokës, lejohen mbjellje të hershme, rritet prodhimtaria, rriten të ardhurat e, për rrjedhojë, rritet mirëqenia e fermerëve. |
| Funksionimi jo normal i sistemit të ujitjes. | a. Identifikimi i veprave prioritare<br>b. Vazhdimi i Projektit të Tretë BB.<br>c. Grumbullimi i kontributit prej 300, lek/dyn nga fermerët<br>d. Funksionimi më i mirë i SHPU | * * *<br>a, b, c, d, duke filluar nga 2006 | Pushteti vendor,<br>Shoqata e përdoruesve të ujit<br>( SHPU),<br>Projekti BB,<br>Donatorë . | Rritet prodhimi bujqësor e cilësia e tij, ulet kostoja e prodhimit, shtohen të ardhurat e fermerëve, ndikim në uljen e varfërisë |
| Fragmentarizimi i tokave bujqësore. | a. Takim me fermerët e zonës për krijimin e bindjeve për domosdoshmërinë e krijimit të fermave private. Organizimi i fermave jo më të vogla se 10- 50 ha ha tokë<br>b. Nxitja e tregut të tokës dhe konsolidimi i saj .<br>c. Zgjidhja e problemeve të pronësisë mbi tokën<br>d. Regjistrimi i tokës në ZRRPP | * * *<br>a. Duke filluar që nga viti 2006<br>b. Duke filluar që nga viti 2006<br>c. Brenda 3 vjetëve<br>d. Brenda 4 vjetëve | Pushteti vendor,<br>Komuniteti i fermerëve<br>Donatorë, OJF,<br>DRBU. | Rritet prodhimi dhe cilësia e tij.<br>Duke punuar në grup:<br>-ulen shpenzimet e prodhimit sepse punimet mekanike, inputet janë me shpenzime më të lira.<br>Zbatohen teknologjitë e reja bashkëkohore, sigurohet kreditim me lehtësi, sigurohen tregjet e shitjes, përballohet më mirë konkurenca e tregut, rritet çmimi i shitjes e, për pasojë, rriten të ardhurat e fermerëve dhe mirëqenia e tyre |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Mungesa e aftësive organizuese për krijimin e shoqatave të peshkimit legal. | a. Takime me pushtetin lokal dhe peshkatarët.<br>b. Ngritja i subjekteve të liçensuara.<br>c. Ngritja e shoqatave të peshkatarëve. | * * *<br>a. Brenda vitit 2006<br>b,c. Brenda 3 vjetëve. | Inspektoriati i peshkimit.<br>Pushteti lokal.<br>Komuniteti i peshkatarëve. | Menaxhim i qëndrueshëm i resurseve peshkore. |
| Deri tani, në këtë zonë, nuk ekziston rritja e peshkut në kushte artficiale. | a. Përgatitje projekteve që inkurajojnë ngritjen e fermave të peshkut (p.sh. fermat e troftës)<br>b. Ngritja e fermave për kultivimin e krapit | * *<br>a. Brenda 2 vjetëve<br>b. Brenda 2 vjetëve | Inspektoriati i peshkimit.<br>Specialistë peshkimi.<br>DRBU.<br>ARM.<br>Komuniteti përfitues. | Punësim.<br>Rikrijim.<br>Prodhim.<br>Stabilizim ekologjike. |

## VII.4. Biodiversiteti dhe Zonat e mbrojtura

| Problemi | Veprimet | Prioriteti dhe afati kohor | Aktorët përgjegjës dhe bashkëpunëtorët e mundshëm | Efekti |
|---|---|---|---|---|
| Varfërimi i biodiversitetit, degradimi i zonave të mbrojtura Kune-Vain | a. Ndalimi i gjuetisë për 5 vjet në zonën e mbrojtur Kune-Vain.<br>b. Prishja e ndërtimeve në Kune -Vain<br>c. Rritja e kapaciteteve të fuqisë vepruese të stafit të Kune-Vainit<br>d. Ngritja e qendrave për vizitorët<br>e. Rritja e kapaciteteve të organeve përgjegjëse në zbatimin e ligjit dhe në mbrojtjen e faunës dhe administrimin e fondit të gjuetisë.<br>f. Fushata e iniciativa ndërgjegjësuese për komunitetin e fshatrave Ishull Lezhë e Shëngjin, si dhe të Barbullojës e Tales për mbrojtjen e Kune-Vainit. | * * *<br><br>a. Duke filluar nga viti 2006<br>b. Brenda 2 vjetëve<br>c. Brenda 2 vjetave<br>d. Brenda 3 vjetave<br>e. vazhdimisht<br>f. Brenda 2 vjetëve | Drejtoria e Ruajtjes së Natyrës (MM)<br>Stafi i Kune –Vainit,<br>Policia ndërtimore<br>Komunat Shëngjin, Shënkoll.<br>ARM Lezhë, | Rritja e popullatave, veçanërisht të shpendëve në përgjithësi, i kolonisë së shpendëve në Kune-Vain, rritja e llojshmërisë faunistike, rritja e mbrojtjes së llojeve të rrezikuara. |
| Rritja e ndotjes së ujërave të lumenjve Drin, Bunë, Kir dhe Gjadër, i Liqeneve të Shkodrës dhe Knallës, i lagunave të Kune Vainit, për pasojë uljen e larmisë biologjike në to. | a. Ndërtimi i rrjetit të largimit të ujërave të zeza për qytetin e Shkodrës larg liqenit (të shikohet mundësia për ndërtimin e një sistemi si ai i Shëngjinit)<br>b. Ndërtimi, në kuadër të planeve rregulluese, i sistemeve të ujërave të zeza dhe mbetjeve në të gjitha fshatrat e zonës, sidomos atyre pranë pasurive ujore (të zbatohen praktika moderne të gropave septike).<br>c. Kontroll i rreptë periodik dhe sigurimi i teknologjive me standarde të larta për aktivitetet që shkarkojnë ujëra të patrajtuara në lumenj e liqene. | * * *<br><br>a. 5 vjet<br>b. 5-10 vjet<br>c. vazhdimisht | Qarqet e Lezhës dhe Shkodrës<br>Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.<br>Bashkitë dhe komunat e zonës në projekt<br>Drejtoritë Rajonale të Ujërave e Kanalizimeve<br>Komuniteti i zonës | Mbrojtja e një nga sistemeve hidrike më të pasura në Shqipëri dhe në Ballkan nga degradimi i shkaktuar nga dora e njeriut dhe rritja e vlerave mjedisore, turistike dhe njerëzore në zonë |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Dëmtimi i formacioneve të drurëve pyjorë dhe përkeqësimi i habitateve. | a. Pyllëzime të reja mbrojtëse e ripërtëritëse në shpatet e eroduara, kryesisht përgjatë lumit Gjadër dhe shpateve që rrethojnë basenin (të shikohet me prioritet brezi Mërqi-Troshan, ekonomia pyjore Kakarriq).<br>b. Përcaktimi i zonave mbrojtëse në të dy anët e lumenjve Drin, Bunë, Kir dhe Gjadër (50-100 m) e krijimi i brezave të gjelbër në të dy anët e këtyre lumenjve me drurë pyjorë.<br>c. Përmirësim habitati me pyllëzime në zonën e mbrojtur Kune –Vain. | * * *<br>a. Brenda 3 vjetëve<br>b. Brenda 5 vjetëve<br>c. Brenda 5 vjetëve | Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave ( Drejtoritë e Pyjeve e Drejtoria e Konservimit të Natyrës),<br><br>Qarqet Lezhë dhe Shkodër | Rritja e vegjetacionit, përmirsimi i habitateve, krijimi i brezave pyjor si bazë për fuqizimin e biodiversitetit.<br>Përmirsimi i pejsazhit dhe i mbrojtjes së lumit Drin nga daljet nga shtrati. |
| Shkallë e lartë e erozionit bregdetar | a. Ndërtimi i veprave të reja mbrojtëse në ekonomitë pyjore dhe rehabilitimi i pendave e digave ekzistuese<br>b. Ndërtimi i veprave mbrojtëse ndaj erozionit bregdetar në Kune e Vain dhe mbrojtja e brezave pyjore në Shëngjin e Velipojë<br>c. Pastrimi i lumit Buna nga mbushjet e lumit Kir | * * *<br>a. Brenda 3 vjetëve<br>b. Brenda 5 vjetëve<br>c. Brenda 10 vjetëve | Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave<br>Komunat e Shëngjinit dhe të Velipojës. | Mbrojtja e brigjeve detare nga avancimi i detit<br>Mbrojtja e tokave nga rritja e kripëzimit |

## VII.5. Dinamika njerëzore dhe përdorimi i territorit

| Problemi | Veprimet | Prioriteti<br>Afati kohor | Aktorët përgjegjës e bashkëpunëtorët e mundshëm | Efekti |
|---|---|---|---|---|
| Mungesa e masterplaneve të zhvillimit urban në të gjithë zonën në studim (Velipoja dhe Shkodra po punojnë në këtë drejtim). | a. Hartimi i masterplaneve urbane të Bashkisë dhe Komunave duke e bazuar në gjendjen aktuale dhe të perspektivës (të merren në konsideratë rekomandimet e projektit EPTISA për një zhvillim të integruar si dhe të zbatohen të gjitha praktikat e kërkuara për Leje mjedisore dhe Vlerësim të Ndikimit në Mjedis) | * * *<br><br>Për komunat e Velipojës dhe Shëngjinit Brenda vitit 2006<br>Për bashkinë e Lezhës dhe Shkodrës Brenda 2 vjetëve | Këshillat e Qarqeve Lezhë dhe Shkodër<br>Bashkitë<br>Komunat | -cilësi më e lartë në shërbimet publike<br>-administrim i qëndrueshëm i mjedisit<br>-pakësim i potencialit ndotës<br>-zvogëlimi i imigrimit të brendshëm<br>-përmirësimi i cilësisë së jetesës<br>-zhvillimi i bujqësisë dhe blegtorisë |
| Mbishfrytëzimi i ujërave nëntokësore. | a. Inventarizimi i burimeve ujore<br>b. Hartimi dhe zbatimi i një programi serioz dhe të pandërprerë monitorimi e administrimi të burimeve ujore,veçanërisht të ujërave nëntokësore.<br>c. Studim fizibiliteti dhe plan menaxhimi për pellgun ujëmbledhës të lumit Drin | * * *<br><br>a. Brenda 3 vjetëve<br>b. Brenda 3 vjetëve<br>c. Brenda 5 vjetëve | Ministritë e linjës<br>DUK,<br>Bashkitë<br>Komunat<br>Komuniteti<br>Donatorët | -përtëritja dhe ruajtja e burimeve ujore<br>-sigurimi i vazhdimësisë dhe mosndotjes së ujit<br>-eleminimi i përmbytjeve<br>-përmirësimi i shëndetit<br>-zhvillimi i turizmit<br>-zhvillimi i agrobiznesit |
| Mungesa e fushave sanitare të grumbullimit të mbetjeve në të gjithë territorin.<br>Probleme të rënda mjedisore dhe shëndetësore, të krijuara nga fushat e pakontrolluara në Shkodër dhe Lezhë si dhe në të gjitha komunat e zonës | a. ndërtimi i fushës rajonale të mbetjeve për të gjithë zonën në studim (fusha e Bushatit)<br>b. Mbyllja e fushave ekzistuese të Shkodrës, Lezhës, dhe Shëngjinit si fusha me rrezik shumë të lartë. | * * *<br>5 vjet | Qarqet e Lezhës dhe Shkodrës | - mbrojtje e të gjithë aseteve mjedisore të zonës<br>- cilësi më e lartë jetese<br>- përmirësim i imazhit turistik të zonës |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Mungesa e stabilitetit në administratat lokale.<br>Lëvizje e vazhdueshme e specialistëve nëpër drejtori dhe zyra shërbimesh, duke penguar vazhdimësinë e punës. | a. Zbatimi i kritereve për marrjen në punë dhe në kontrollin institucional.<br>b. Mbrojtja e stafeve nga ndikimet partiake dhe ndryshimet politike. | * * *<br>3 vjet | Qeveria Shqiptare<br>Qeverisja vendore<br>Partitë Politike, | - Administrim më i sigurtë i punëve dhe projekteve<br>- Inkurajim i specialistëve për ndërmarrjen dhe përmbushjen me sukses të nismave vendore<br>- Rritja e kualifikimit të stafeve vendore |
| Ndërgjegjësimi i publikut dhe i administratave vendore është në një shkallë mjaft të ulët | a. Ndërgjegjësimi i publikut lidhur me mirëmenaxhimin e burimeve natyrore<br>b. Programe trajnimi me përfaqësues të pushtetit qendror, vendor, të subjekteve të interesuara dhe të shoqërisë civile, lidhur me pjesëmarrjen e publikut në hartimin e politikave, të planeve të zhvillimit, në kryerjen e monitorimit dhe në VNM etj. | * * *<br>a. vazhdimisht<br>b. Duke filluar që nga viti 2006 | Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave<br>Bashkitë, Komunat,<br>O.J.F.<br>Media | -zhvillimi i burimeve njerëzore<br>-rritet pjesëmarrja e komunitetit në administrimin e qëndrueshëm të mjedisit<br>-parandalimi dhe zbutja e problemeve mjedisore<br>-rritje e vlerave estetike |
| OJF-të janë ende të pakonsoliduara, kurse niveli i masmedias në trajtimin e problemeve mjedisore është relativisht i dobët | a. Ndërtimi i kapaciteteve për përfshirjen e publikut në procesin e vlerësimit mjedisor dhe në vendimmarrje<br>b. Trajnimi dhe kualifikimi i gazetarëve lidhur me trajtimin e problemeve mjedisore.<br>c. Mbështetje financiare për OJF-të me qëllim që të rritet veprimtaria dhe niveli i punës së tyre | * * *<br>3 vjet | REC<br>Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave<br>M.Fin.<br>Donatorët | -zhvillimi i burimeve njerëzore<br>- ndërgjegjësim i publikut<br>-rritje e kapaciteteve intelektuale në fushën mjedisore<br>-trajtim profesional nga ana e medias për problemet mjedisore |
| Mungojnë praktikat, mjetet dhe programet mësimore në mbrojtje të natyrës | a. Integrimi i edukimit mjedisor në programet shkollore të të gjithë niveleve<br>b. Aplikimi i ekskursioneve në natyrë për fëmijët e shkollave<br>c. Aktivitete konkrete me fëmijët e shkollave për ngritjen e qendrave mjedisore përreth zonave të mbrojtura | * * *<br>2 vjet | Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave<br>Ministria e Arsimit dhe Shkencës.<br>Komuniteti | -zhvillimi i burimeve njerëzore<br>-rritje e pjesëmarrjes së publikut për mbrojtjen e mjedisit<br>-administrim i qëndrueshëm i mjedisit |

## VII.6. Turizmi

| Problemi | Veprimet | Prioriteti dhe afati kohor | Aktorët përgjegjës dhe bashkëpunëtorët e mundshëm | Efekti |
|---|---|---|---|---|
| Rreziku i humbjes së të ardhurave nga zhvillimi i turizmit, degradimi natyror dhe i territorit në zonat turistike, prishja e imazhit të destinacionit turistik dhe humbja e turistëve në të ardhmen. | a. Zbatimi i planit rregullues të zonës Velipojës (të rishikuar sipas kritereve mjedisore), Razëm-Theth-Vermosh, investime për mbështetjen e komponentit institucional në krijimin e politikës dhe mjedisit legal përmes vjeljes së taksave e detyrimeve që do kenë përdoruesit për pagimin e kërkesave dhe lejeve të reja, investime në ndërtimin e zonave pilote turistike, ndërtimi i infrastrukturës lidhëse me zonat e tjera të Shqipërisë dhe me vendet e tjera fqinje<br>b. Zgjidhja e problemit mbi pronësinë në bregdet,<br>c. Përgatitja e guidave cilësore (guida për vizitorët dhe veçanërisht për ndërtuesit dhe zhvilluesit) për të gjithë zonën. | * * *<br>a. Brenda 1 viti<br>b. Brenda 2 vjetëve<br>c. Brenda 2 vjetëve | Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë, dhe Sporteve dhe Rregullimit të Territorit, Bashkia Shkodër e Malësi e Madhe, Prefektura Shkodër, Universiteti i Shkodrës, Qarku Shkodër, Komuna Velipojë, OJF- të, komunitetet e zonave turistike, biznesi privat. | Do t'i jepte një zhvillim të madh ekonomisë së këti rajoni, duke ndikuar në uljen e varfërisë, të numrit të të papunëve në gjithë Shqipërinë e Veriut. Kështu p.sh. Ministria e Turizmit vlerëson se nga ndërtimi i 2500 shtretërve hapen 1000 vende të reja punë direkte dhe 1000 vende të tjera si rezultat i efektit të shumëfishimit zinxhir.<br>Do të rriste nivelin e të ardhurave për frymë dhe do të sillte zhvillimin e degëve të tjera të ekonomisë si bujqësinë, tregtinë, artizantin, ndërtimin etj. |
| Dëmtimi i vlerave historike-kulturore të zonës | a. Rikonstruksioni sipas parametrave të kërkuara të kalave të Lezhës dhe të Shkodrës<br>b. Përgatitja e guidave turistike duke përfshirë asetet e njohura turistike dhe ato të Gjadrit, dhe liqenit të Vaut të Dejës si vlera të veçanta multituristike | * * *<br>Brenda 5 vjetëve | Qarqet Shkodër dhe Lezhë Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve | Mbrojtja e vlerave unikale të kësaj zone në turizmin historik dhe hapja e mundësive për shfrytëzimin e disa llojeve të tij. |

# Ndikimi ndërmjet baseneve

## Lumi Mat dhe Baseni i Fushë Kuqes



# 1. Analizë e përgjithshme e gjendjes

## 1.1 Popullsia dhe kushtet e jetesës

Komuna e Fushë Kuqes ka pesë fshatra: Adriatik, Patok, Gorre, Gurrëz dhe Fushë Kuqe. Gjithsëj, popullsia e komunës përbëhet prej rreth 7600 banorësh. Më shumë banorë kanë fshati Gurrëz dhe Adriatik, ndërsa më pak Patoku. 60 % e kësaj popullsie të ardhur prej Malësisë së Madhe, verilindjes, Kurbinit, Kosovës si dhe Rom janë të vendosur këtu që prej më shume se një shekulli. Dendësia e popullsisë para një dekade ka qenë rreth 50 banorë për km2. Pas vitit 1990 ka patur lëvizje të fuqishme demografike, me mbizotërim ardhjesh të reja. Sigurisht që këto ndryshime kanë sjellur edhe probleme të reja ekonomiko-shoqërore, por veçanërisht theksojmë ato që lidhen me tokën.

Komuna e Fushë Kuqes ka sipërfaqe prej rreth 3300 ha. Bujqësia dhe blegtoria janë sektorë prioritarë ekonomike të banorëve të komunës. Sipërfaqet kryesore të tokave bujqësore mbillen më shumë me drithëra, fasule, patate, e sidomos jonxhë.

Ekziston gjithashtu një traditë e vjetër në mbarështimin e bagëtive, veçanërisht të deleve dhe kuajve. Peshkimi është një tjetër përparësi për zhvillimin e zonës. Bregdeti, laguna dhe 2 lumenjtë krijojnë kushte të përshtatshme natyrore për zhvillimin e peshkimit me interes të madh ekonomik. Kompleksi i Patokut karakterizohet nga një shumëllojshmëri e peshqve. Pozicioni gjeografik i kësaj zone lehtëson komunikimin me tregjet e shitjes, gjë që përbën një tjetër faktor për perspektivën e mirë të zvillimit të peshkimit. Turizmi ekologjik është një nga potencialet më të rëndësishme për zhvillimin e zonës. Karakteristikat e saj natyrore me llojshmërine e lartë të habitateve (det, lagunë, pyll, lumenj, tokë bujqësore), biodiversitetin e pasur me shumë grupe të florës dhe faunës, ekzistencën e bujqësisë dhe peshkimit tradicional janë faktorë kryesorë për zhvillimin e eko-turizmit. Pozicioni i kësaj zone pranë Tiranës dhe rrugëve nacionale e lehtëson ardhjen e turistëve, nëse do të përmiresohej infrastruktura e kësaj zone në një të ardhme të afërt.

Një prirje zhvillimi vihet re edhe në familjet e kësaj komune. Po konsolidohet gjithnjë e më tepër familja prej 4-5 anëtarësh, e më 2-3 fëmijë.

| | Vit/njësi | Komuna e Fushë-Kuqes |
|---|---|---|
| Popullsia sipas INSTAT | 2001 | 6129 |
| Femra sipas INSTAT | 2001 | 3214 |
| Popullsia sipas Gjendjes Civile | Dhjetor 2003 | 7737 |
| Femra sipas Gjendjes Civile | 2003 | 3885 |
| Toka bujqësore e ndarë tek banorët | Hektarë | 2447 |

*Tabela 1 – Rritja e popullsisë dhe shpërndarja e tokës*

## 1.2 Faktorët kërcënues

*Prishja e regjimit ujor*

Këtu eshte fjala për prishjen e regjimit ujor të lagunës dhe krejt rrjetit hidrologjik të zonës. Në këtë proces dinamik mpleksen faktorët natyrorë me ato antropogjenë. Siç dihet, laguna dhe baseni i saj, madje edhe më gjerë janë në proces tektonik uljeje, çka kupton ndryshime të regjimit ujor. Mirëpo në këtë proces ndikojnë prurjet jo të vogla të ujit dhe aluvioneve nga lumi Ishëm dhe Mat. Ky proces dinamik hidromorfologjik është ndikuar dhe ndikohet nga veprimi i njeriut. Ndërtimi i hidrocentraleve mbi lumin Mat ka ndryshuar regjimin e prurjeve. Ndërtimi dhe dëmtimi i digave, bonifikimi, drenazhimi dhe prishja e sistemit të kanaleve, marrja e lëndëve inerte, gjithashtu kanë ndikuar dhe ndikojnë fort në regjimin ujor të zonës dhe lagunës së Patokut në veçanti. Këtu duhet shtuar se çrregullimi i regjimit ujor prej ndërtimit ose prishjes së kanaleve dhe hidrovorit ka çrregulluar edhe kimikisht ujin e lagunës dhe strukturën llojore të organizmave.

Çrregullime të tilla të regjimit ujor kanë çuar në dëmtim pylli, sidomos të pishës, pamundësi të investimeve për turizëm e tjerë.

*Dëmtimi i pyjeve*

Shpyllëzimi për hapje tokash për bukë, i realizuar para disa dekadash, ka qenë faktori kryesor i dëmtimit të biodiversitetit. Ky proces ka rifilluar dekadën e fundit, ku prerjet e paligjshme, kryesisht për lëndë ndërtimi dhe dru zjarri, kanë çuar në dëmtimin dhe zhdukjen e sipërfaqeve jo të vogla. Veçanërisht dëm i madh konsiderohet zhdukja e pyllit në grykëderdhje të Matit, dëmtimi i madh i rrënjës (Quercus robur) në Patok, dëmtimi i vidhit (Alnus) dhe i frashërit (Fraxinus) etj:

Menaxhimi i zonës nëpërmjet introduktimit të drurëve pyjorë-dekorativë dhe foragjereve për kullotë është një veprim me pasoja në zhvillimet spontane të ekosistemeve pyjore. Kjo sjell konkurencë, shtim grabitqarësh etj.

Zjarri është faktor rrezikues për pyjet, i cili, ndonëse jo shumë problematik për zonën, ka patur ndikimin e vet. Ai përbën një rrezik të madh potencial për këtë zonë.

Edhe kullotja në pyje ka ndikimin e vet në dëmtimin e drejtpërdrejtë të pyllit, por edhe në shqetësimin dhe prishjen e reflekseve të shpendëve, shtimin e sëmundjeve etj.

Dëmet janë shtuar edhe për shkak të mos zgjidhjes së problmeve të pronësisë. Shumë familje kanë pretendime për tokë. Ardhjet e reja të popullsisë e kanë komplikuar problemin. Papërgjegjshmëria dhe vetëgjyqësia ka çuar edhe në dëmtime të sipërfaqeve me vlera natyrore të mëdha.

*Ndotja prej lëndëve bujqësore, industriale, komunale*

Prej dekadash kjo zonë ka qenë nën ndikimin e lëndëve ndotëse. Për vite me radhë ka patur një përdorim të madh të pesticideve dhe lëndëve të tjera kimike në bujqësi. Pas një pauzë të vogël, me riaktivizimin e bujqësisë, kohët e fundit edhe në këtë zonë përdoren përsëri këto lëndë. Është e nevojshme që përdorimi i këtyrë lëndëve të vihet nën kontroll dhe në mjediset kryesore, e veçanërisht në lagunë të monitorohet përmbajtja e tyre.

Zhvillimi i industrisë kimike në Laç ka qenë jo pa ndikim. Mbeturinat e ngurta, lënda e parë minerale e depozituar, tymrat etj., patjetër që kanë penetruar jo vetëm drejtpërsëdrejti në rrugë nëntokësore, mbitokësore dhe ajrore, por edhe nëpërmjet rrugëve të transferimit biologjik të lëndëve.

Edhe ndotjet komunale janë një problem jo i vogël. Problemet e derdhjeve urbane duhen studiuar dhe zgjidhur në funksion të pastërtisë së mjedisit e veçanërisht ujit. Problemi merr vlerë më të madhe sot, pasi siç dihet popullsia përdor sasira të mëdha detergjentësh të cilët në rrugë të ndryshme drenojne poshtë, ndoshta edhe në lagunë.

*Peshkimi i jashtligjshëm*

Këtu është fjala për peshkim kryesisht në lagunë. Laguna ka popullata peshku, kapaciteti i të cilave ka një farë limiti. Ihtiofauna e lagunës furnizohet nga deti, komunikimi me të cilin është i kufizuar. Për këtë arsye edhe "zëvëndësimi" i ihtiofaunës së dëmtuar në lagunë është shumë më i ngadalshëm se në det. Prandaj dëmtimi i burimeve peshkore në lagunë përbën një rrezik, qoftë edhe të përkohshëm për të mos patur peshk. Kohët e fundit në lagunë dhe brigjet e cekta të detit është zhvilluar një peshkim spontan. Ka patur përdorim të lëndëve plasëse, helmuese, agregateve elektrike e tjerë që shfarosin peshkun dhe gjithë botën e gjallë shoqëruese. Edhe peshkimi me anije në ujëra të cekta përsëri ka ndikuar negativisht në dëmtimin e bentosit dhe gjeneratave të reja të peshqve. Duke qenë prej vitesh jashtë kontrollit, mbipeshkimi në lagunë ka varfëruar rezervat e peshkut.

Veprimi në kompleks i këtyre faktorëve ka dhënë ndikime të dukshme negative tek kjo degë e rëndësishme e ekonomise së komunës.

*Gjuetia e jashtëligjshme*

Veçanërisht gjuetia me çifte ka dhënë ndikimin e vet negativ në natyrë. Megjithëse janë liçensuar 180 gjuetarë për gjueti sportive në këtë komunë, në fakt thuhet se përdoren 1700 çifte. Kështu, numri i çifteve të gjuetisë përkon me numrin e familjeve të komunës dhe është gati sa gjysma e numrit të meshkujve të kësaj komune. Pra, në çdo dy meshkuj, njëri përdor çifte. Kjo gjendje paradoksale është shqetësuese, ndërkohë që popullsia e komunës duhet të ruajë e të administrojë me kursim pasurinë e vet natyrore.

*Ndërtimet*

Çdo ndërtim në breg të lagunës dhe afër pyllit përbën një problem më vehte. Këto ndërtime tërheqin njerëz, automjete, krijojnë zhurma dhe mbeturina. Ndërtimet varfërojnë dhe çpopullojnë këto mjedise

prej shpendëve e gjitarëve e për rrjedhim shndërrojnë krejtesisht natyrën. Natyra kthehet thjesht në një "lulishte" lokali, parking, rrugë, shesh. Çdo gjë dalëngadalë varfërohet e degradohet. Në kushtet e sipërfaqeve me laguna e pyje, degradimi mund të rrjedhë drejt gjendjeve të parikthyeshme.

*Prania e njeriut*

Prania e njeriut në rezervate ka efekte negative. Lëvizja e vizitorëve, turistëve, gjuetarëve, punëtorëve, zhurmat e njerëzve, të automjeteve, karrocave, armëve të gjahut, e tjerë, shqetësojnë këto ekosisteme. Ky ndikim negativ mund të jetë i drejtpërdrejtë, me dëmtim, prerje, gjueti etj., por mund të jetë edhe shqetësim, trembje, prishje refleksesh të gjallesave shtazore që jetojnë, riprodhohen ose kalojnë në këto mjedise. Kjo prani disiplinohet nëpërmjet lejeve, kontrolleve, ndërgjegjësimit etj.

## 1.3 Perspektiva

*Bujqësia*

Bujqësia do të jetë në të ardhmen sektori prioritar.

Komuna e Fushë Kuqes ka një fond të pasur toke me kapacitet prodhues të kënaqshëm. Kjo zonë ka kushte natyrore të favorshme për zhvillimin e bujqësisë. Ka potencial të lartë energjetik dhe temperaturë të përshtatshme për shumë kultura bujqësore.

Kjo zonë është e pasur me ujë, veçnërisht ujëra nëntokësore. Edhe reshjet plotësojnë disa kërkesa të pjesëshme për bujqësinë.

Natyra e kësaj zone ka një fond të pasur gjenetik. Edhe bujqësia e zonës ka fondin e vet gjenetik të pasur.

Popullsia e kësaj komune ka përvoje në prodhimin e drithit, patates, fasules, në vreshtari etj. Ekziston gjithashtu një traditë e hershme në mbarështrimin e bagëtive e sidomos deleve dhe kuajve. Edhe tradita e mbarështrimit dhe shfrytëzimit të pyjeve është e hershme.

Vitet e fundit popullsia e komunës është shtuar, çka rregullon edhe nevojat për krahë pune në bujqësi dhe në sektorë të tjerë.

Pra, bujqësia është sektori më fitimprurës në këtë komunë, prandaj duhet vlerësuar si sektori prioritarar i zhvillimit.

*Turizmi*

Turizmi e veçanërisht turizmi ekologjik është një prej perspektivave të zonës.

Komuna e Fushë Kuqes konsiderohet si një zonë buferike. Ajo ka një sipërfaqe jo të vogël me vlera rezervati biosfere. Këtu gjejmë një pasuri floristike e veçanërisht një vegjetacion pyjor interesant, një larmi të madhe të kafshëve, e sidomos të peshqve dhe shpendëve.

Kjo larmi gjallesash gjendet në një larmi të madhe habitatesh: lagunë, kënetë, det, lum, pyll, tokë bujqësore etj. Të gjitha këto i japin objekt dhe orientim ekologjik zhvillimit të turizmit në zonë.

Pozicioni i Fushë Kuqes është mjaft i favorshëm: 50 km larg Tiranës, 40 km larg Krujës, 8 km larg Laçit, afër autostratës, hekurudhës, detit, lumenjve e maleve.

Fshatrat e komunës janë tradicionale, me popullsi jo të dendur, me njerëz punëtorë.

Komuna ka traditë dhe potencial bujqësor, çka perbën një kusht dhe prioritet për turizmin.

*Peshkimi*

Peshkimi do të jetë sektor perspektiv i zhvillimit ekonomik të zonës, por jo kryesor ose i barazvlefshëm me bujqësinë. Komuna ka një bregdet jo të vogël dhe dy grykëderdhje lumenjsh, që shquhen për sasi dhe larmi llojore të peshkut.

Komuna ka lagunën e cila përbën një rezervë tjetër të rëndesishme peshku.

Janë rritur mundësitë për të përsosur tekniken e zënies së peshkut e gjithashtu edhe mundësitë e komunikimit me tregjet. Edhe këto janë faktorë për një perspektivë më të mirë të sektorit të peshkimit.

## 2. Baseni i Fushë Kuqes dhe Patokut

Gjatë bregut shqiptar të Adriatikut, Kompleksi Ligatinor i Patokut përfaqëson një nga bukuritë natyrore me interesante të këtij bregu. I ndodhur ndërmjet Lumit Mat në Veri dhe Lumit Ishëm në Jug, ky kompleks përfshin një llojshmëri të lartë habitatesh: laguna e brendeshme dhe e jashtme (480 ha), pylli (200ha), tokat bujqësore (450ha) dhe blegtorale (150ha). Kjo është ajo çfarë ka mbetur nga një zonë e mëparshme prej 4200 ha që ka kaluar një proces interesant zhvillimi, për shkak të faktorëve natyrorë dhe aktiviteteve njerëzore.

E krijuar gjatë periudhës së Holocenit, kjo zonë karakterizohej nga një dinamizëm i lartë gjeomorfologjik. Zhvillimi i tij ka kaluar 4 faza, të cilat korrespondojnë me formimin e 4 lagunave, të ndara nga kordone litorale. Laguna e katërt është Laguna aktuale e Patokut. Një lagunë e pestë (laguna e jashtme aktuale) është në një proces formimi aktiv, e influencuar edhe nga një zhvillim i shpejtë i kordonit litoral në pjesën perëndimore. E gjithë zona është e rrafshët dhe karakterizohet nga një proces intensiv tektonik dhe ujra të shumtë nëntokësore. Procesi natyror i zhvillimit të lagunës i detyrohet 3 faktorëve kryesore: regjimit të Lumit Ishëm, regjimit të Lumit Mat dhe regjimit talasografik. Deri në vitet 50 të shekullit XX kanë dominuar zhvillimet spontane dhe në të gjithë zonën kanë mbizotëruar elementët natyrore të habitateve. Gjatë gjysmës së dytë të shekullit të kaluar, aktivitetet njerëzore kanë luajtur një rol të rëndësishëm në ndryshimet e këtij ekosistemi nëpërmjet drenazhimeve, ndërtimit të digave, shpyllëzimeve etj. Karakteristikat fiziko-gjeografike të kësaj zone janë faktor kryesor për potencialet e zhvillimit të saj dhe e bëjnë atë mjaft tërheqëse në shumë aspekte. Dimri relativisht i butë dhe vera e freskët, 2479 orë me diell në vit, temperatura mesatare vjetore 15,5$^0$ C dhe sasia mesatare vjetore e reshjeve 1463 mm, tregojnë një potencial të lartë klimatik, që ushtron një ndikim të madh në zhvillimin intensiv të ekosistemit.

### 2.1 Hidrologjia

Procesi natyror i zhvillimit të lagunës së Patokut vlerësohet nga tre faktorë: regjimi i lumit Ishëm, regjimi i lumit Mat dhe regjimi talasografik.

Lumi Ishëm derdhet në jug të lagunës, në gjirin detar të Rodonit. Prurja mesatare vjetore e tij është 20,9 m3/sek, por që ka një maksimum prej 1980 m3/sek. Prurjet e ngurta të tij janë 2,1 X $10^6$ ton/vit.

Lumi Mat derdhet në veri të lagunës. Prurja mesatare është 101 m3/sek, kurse maksimumi është 3400 m3/sek. Prurjet e ngurta maten me 1,9 x $10^6$ ton/vit.

Hapësira bregdetare e Adriatikut, të paktën deri të izobatit - 6m, është pjesë përbërëse e ekosistemit të Patokut. Ndikimi direkt i detit në lagunë realizohet nëpërmjet kanalit që i lidh këto të dy.

Regjimi talasografik ka disa elementë. Nivell i detit këtu shkon 0,59 m deri 1,75 m. Valëzimi karakterizohet nga valë me lartësi maksimale 3,75 m dhe gjatësi maksimale 56 m.

Temperatura mesatare vjetore e ujit është 17, 7°C, me një minimum prej 6,8°C dhe maksimum 28,6°C. Kripshmëria e ujit luhatet prej 35,5%0 deri 39,1%0. Rrjedhja mesatare detare është 0,25 m/sek, me maksimum prej 1,1 m/sek.

## 3. Vlerat natyrore dhe larmia biologjike

Karakteristikat dhe shumëllojshmëria e habitateve janë të lidhur ngushtë me biodiversitetin e lartë të Kompleksit Ligatinor të Patokut. Shumllojshmëria e bimësisë është një nga karakteristikat me spikatëse të këtij kompleksi. Nga bimët detare, në pjesën perëndimore, më të zakonshmet janë livadhet nënujore të Fucus virsoides dhe Posidonia oceanica. Bimësia ujore e lagunës karakterizohen nga sasi e madhe e mikroalgave, sepse ka rritje të shpeshtë të trofisë si rrjedhojë e rritjes së azotit dhe fosforit. Një nga treguesit e kësaj gjendjeje është edhe sasia e lartë e diatomeve. Makroalgat e lagunës i përkasin algave të gjelbra (*Chlorophyta*) dhe algave të murrme (*Pheophyta)*. Livadhet e fanerogameve mbulojnë rreth 40% të fundit të lagunës. Ato përbëhen nga Zostera noltii, por në ujra të cekët dhe të qetë gjendet gjithashtu Ruppia spiralis. Kjo fitocenoze ka një rol shumë të rëndësishëm në lagune. Bimësia higro dhe hidrofile mbulon një zonë të konsiderueshme të pjesëve periferike të lagunës. Ato dominohen nga 3 shoqërime kryesore të kallamishtes *(Phragmites*), shavarit (*Thypha*) dhe shqirres (*Scirpus*). Bimesia halofile është

më e pranishme në pjesën veriore dhe jugore të lagunës. Kjo bimësi i përket disa shoqërimeve, nga të cilat më të rëndësishme janë ato me Arthrocnemum dhe Juncus. Bimësia e dunave gjendet kryesisht në pjesën perëndimore, me një numër të lartë llojesh. Shkurret në brigjet e lagunës dominohen nga marina (*Tamarix*), konopica (*Vitex*) dhe manaferra (Rubus).

Sipërfaqja pyjore më e rëndësishme i përket pyllit të Fushë-Kuqes, në pjesën lindore të lagunës. Aktualisht ka mbetur vetëm gjysma e sipërfaqjes së pyllit dikur të famshëm, ku mbizotërojnë verri (*Alnus glutinosa*), frashëri (*Fraxinus angustifoli*a) dhe më pak vidhi (*Ulmus campestre*), rrënja (Quercus robur), plepi i bardhë (*Populus alba*), pisha e butë (*Pinus pinea*) dhe pisha e egër (*Pinus halepensis*). Sipërfaqe të vogla me plep dhe akacie janë pyllëzuar artificialisht prej disa dhjetëra vitesh.

Fauna invertebrorë e Kompleksit Ligatinor të Patokut dhe pellgut ujëmbledhës të tij, duke përfshirë ujrat e ëmbla, kanalet, kënetat, estuaret dhe bregun rreth lagunës, karakterizohet nga një shumëllojshmëri e grupeve dhe llojeve, nga molusqet (midhjet dhe kërmijtë) deri tek gaforret dhe insektet.

Iktiofauna përbën një nga vlerat më të çmuara të lagunës, me shumë lloje peshqish me interes ekonomik, siç janë qefujt (*Mugil cephalus, Liza ramada, Liza saliens*), ngjala (*Anguilla anguilla*), barbuni (*Mullus barbatus*), gjuhëza (Solea vulgaris), koca (*Sparus auratus*), levreku (Dicentrarcus labrax) etj.

Amfibët dhe zvarranikët (Herpetofauna) gjenden më shumë në pyje, këneta dhe kanalet rreth lagunës. Është interesante të theksohet sasia e madhe e breshkave të ujit (*Caretta caretta*) në brigjet e detit afër lagunës dhe prania e breshkave të gjelbra (*Chelonia mydas*).

Pozicioni i favorshëm dhe shumëllojshmëria e habitateve rreth lagunës kanë krijuar kushte të përshtatshme për ornitofaunën. Inventarizimi i shpendëve ka regjistruar numër të lartë llojesh, që i përkasin shpendëve të ujit, shkurretave, pyjeve, kullotave, dunave dhe tokave bujqësore. Në Kompleksin Ligatinor të Patokut është regjistruar numër i madh llojesh të shpendëve të kërcënuar në shkallë botërore si *Pelecanus crispus, Phalacrocorax pygmaeus, Ciconia ciconia, Platalea leucorodia* dhe *Numenius tenuirostris.*

Mamalofauna e Kompleksit të Patokut karakterizohet nga një numër i vogël llojesh dhe një degradim i strukturës së komunitetit. Kjo është më tepër e lidhur me tharjen e kënetave dhe shpyllëzimin e zonës. Mishngrënësit më të zakonshëm janë çakalli (*Canis aureus*), dhelpra (*Vulpes vulpes*), lundërza (*Lutra lutra*), baldosa (*Meles meles*), nuselala (*Mustela nivalis*) dhe qelbësi (*Mustela putorius*).

*Tab.2 – Gjitarët e rrezikuar në zonën bregdetare të përfshira në monitorimin e vitit 2002 (Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhë 2004)*

*Tab.3 – Zogjtë e dimërues të ujit dhe folezuesit në lagunat e Shqipërisë, krahasuar me lagunen e Patokut (Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhë 2004)*

| Kategoria | Kunë-Vaini | Patoku |
|---|---|---|
| Gjitarët bioindikatorë të rrezikuar | 7 | 8 |
| Gjitarët bioindikatorë të rvëzhguar | 11 | 13 |
| Shkalla ndërmjet tyre në % | 63,6 | 61,5 |

| Laguna | Numri i llojeve të zogjve dimëror të ujit | Nr. i individëve të zogjve dimëror të ujit | Nr. i zogjve folezues |
|---|---|---|---|
| Velipoja | 35 | 3,788 | 12 |
| Kune- Vain | 32 | 2,318 | 12 |
| **Patoku** | **24** | **3,178** | **5** |
| Karavasta | 52 | 35,670 | 22 |
| Butrint | 40 | 14,103 | 9 |

## 4. Rekomandime

1. Përmirësimi i infrastrukturës përmes përmirësimit të sistemit rrugor, rehabilitimi i sistemit të ujit të pijshëm, rehabilitimi i sistemit vaditës në bujqësi. Duhet ti kushtohet hsumë kujdes përpjekjeve për të përgjysmuar numrin e banorëve që jetojnë pa ujë të pijshëm të rrjedhshëm si dhe marrja e masave drastike për mbrojtjen nga përmbytjet.

2. Promovimi dhe zhvillimi i ndërmarrjeve dhe nismave të biznesit të mesëm dhe atij të vogël, e shoqëruar kjo me rritjen e prodhimit vendas, krijimit të kushteve të përshtashme si për banorët ashtu dhe vizitorët. Aktivizimi dhe inkurajimi, sidomos i të rinjve për ndërmarrjen e investimeve dhe bizneseve me qëllim gjallërimin e jetës dhe rritjen e vlerave të zonës për banim.

3. Një vendndërtim i vogël propozohet të ndërtohet përgjatë rrugës që shkon për në lagunë (para hyrjes në të), me të gjitha lehtësirat për parkim makinash, pikniqe dhe zona të përkohëshme qëndrimi, pushimi dhe licensimi i nismave të cilat ndihmojnë vizitorët të shijojnë natyrën e zonës.

4. Si rezultat i analizave të bëra zona nga Shëngjini deri në derdhjen e lumit Ishëm është propozuar të kthehet në Rezervat Natyror të Menaxhuar (Kategoria IV e zonave të mbrojtura).

5. Zona duhet të pajiset me shërbimet e nevojshme të orientuara drejt konceptit të "portës turistike). Disa facilitate të tilla si kabina të përkohëshme për vizitorë të përkohshëm, të cilët duan të kalojnë disa orë ose një natë në këtë zonë, do të ishin zgjidhja më e përshtashme. Gjithashtu, mund të ndërkohen hotele të vegjël, ose villa të bukura që jepen me qera të shoqëruara me bare, restorante, dyqane suveniresh, etj.

6. Duhet të merren masa të menjëhreshme për ndërtimin e një sistemi funksional për grumbullimin e mbetjeve si dhe të zgjidhet cështja e ujrave të zeza.

8. Tradidat locale për muzikën popullore, kërcimin, gatimin dhe punën me dorë duhet të ruhen, zhvillohen dhe "shiten" tek vizitorët. Këto aktivitete do të ndihmojnë në sigurimin e të ardhurave shtesë dhe mundësive për punësim. Fermerët duhet të mbajnë traditën e tyre bujqësore dhe blegtorale. Vetëm metodat e reja që rrespektojnë natyrën mund të nxiten.

9. Për zonën e mbrojtur dhe vlerat natyrore:
(i) Pezullimi në mënyrë të diferencuar i gjuetisë në zonat ligatinore bregdetare për një afat kohor prej 3-5 vjetësh, me qëllim që t'i jepet mundësi faunës së egër që të rimarrë veten dhe më pas të kalohet në një gjueti të kontrolluar dhe racionale brenda mundësive reale të vjeljes së gjahut; (ii) Hartimi i planeve të menaxhimit për zonat e mbrojtura; (iii) Rritja e kontrollit nga Inspektoriatet e ndryshme mbi aktivitetet që ushtrohen brenda këtyre zonave, me qëllim rregullimin e tyre dhe minimizimin e ndikimit të tyre në faunë. Si të tilla përmendim kullotjen, gjuetinë, peshkimin, rigjenerimin; (iv) Në zonat e njohura si zona të riprodhimit ose shtimit nuk duhet lejuar asnjë lloj shqetësimi nga prania dhe veprimtaria e njeriut. Çdo shqetësim gjatë riprodhimit do të sillte dështimin ose rritje të vdekshmërisë, e për pasojë ulje të efektivave të popullatave të llojeve; (v) Të vendosen tabela për mbrojtjen e shpendëve dhe parandalimin e shqetësimit; (vi) Të rritet shkalla e edukimit mjedisor për rëndësinë ekoturistike të llojeve të shpendëve; (vii) Duhen marrë masa për ndalimin e peshkimit në ujërat e ceketa bregdetare, peshkim i cili paraqitet me pasoja të rënda edhe mbi gjitarët e ujit si, delfinët. Janë jo të pakta rastet e delfineve të rënë në rrjetat e peshkimit të këtyre ujërave, e që më pas kanë ngordhur e dalë në breg; (viii) Duhet të ndërmerren masa dhe fushata ndërgjegjësuese për peshkatarët për rolin dhe rëndësinë e gjitarëve detare për vetë ekonominë dhe jetën detare. Të punohet për ndërgjegjësimin e popullatës për rëndësinë e breshkave të ujit si kafshë globalisht të rrezikuara nëpërmjet emisioneve televizive, botime etj si dhe puna me peshkatarët për t'i lëshuar përsëri në det breshkat e rëna në rrjetat e tyre. Gjitarët dhe breshkat detare duhet të jenë simbole të pasurisë dhe bukurisë detare; (ix) Ndalimin e peshkimit me lëndë plasëse; (x) Ndalimin e grumbullimit masiv të pakontrolluar të molusqeve në të gjitha mjediset, sidomos në përiudhën e riprodhimit.



# Harta




*Hartë 2: Paraqitje e llojeve kryesore të erozionit në zonë*




*Hartë 3: Paraqitje e zonave me rrezik të lartë sizmik*



Lumi Buna dhe Laguna e Vilunit



Lumi Gjader dhe Liqeni i Vaut te Dejes



Lumi Drin i Lezhes, Liqeni i Kenalles dhe Lagunat e Kune-Vain



Lumi Kir dhe Liqeni i Shkodres

***Hartë 4: Paraqitje e zonave hidrike në rajon***




***Hartë 5: Paraqitje e zonave që përmbyten ose rrezikojnë përmbytje***




***Hartë 6: Paraqitje e zonave të mbrojtura, sipas kategorive të mbrojtjes***




*Hartë 7: Paraqitje e zonave mr problematike të ndryshme*
*Harta e plotë e analizës*



*Harta 8: Historia e tërmeteve të ndodhura në rajon në vite dhe shkallën e tyre, ku tregohen dhe zonat që kanë rrezikshmëri më të lartë (të dhënat fillestare marrë nga Google)*



*Harta 9. Lumi Kir dhe zona me erozion të lartë të shpateve, e cila rrezikon seriozisht qytetin e Shkodrës*



*Harta 11. Rrathët e kuq, në hartë, tregojnë vendet ku rrezikohet dalja e ujërave të lumit Buna, në të cilat kërkohet ndërhyrje e menjëhershme*



*Harta 12. Rrathët e kuq në hartë tregojnë vendosjen e zhavorrishteve në lumë, të cilat duhet të monitorohen dhe për të cila duhet të kryhet një VNM për ndikimin e tyre në lumë.*



*Harta 13. Me vijë të kuqe tregohet përroi i Manatisë, i cili është i ngarkuar me ndërtime pa leje përgjatë brigjeve të tij, duke shkaktuar probleme me përmbytjet në zonë.*



*Harta 14. Kodrat ku mund të vendosen turbinat e erës*




*Harta. 1 – Pozicioni gjeografik i komunës*



*Harta 2. Zona bregdetare nga Kepi i Rodonit deri në derdhjen e Lumit Mat (linja e kuqe tregon zonën turistike nën autoritetin e qeverisjes qendrore).*







# Plani Rajonal i Veprimit në Mjedis

*Delta e lumit Drin, Shkodër - Lezhë*